



KOLEGJI UNIVERSITAR “WISDOM”

REVISTË SHKENCORE PERIODIKE

Nr. 4

12 Maj 2016



**Bordi Shkencor i Revistes Shkencore Periodike
“Wisdom”, botim i “Wisdom University”, përbëhet:**

1. Prof. Dr. Lush Perpali
2. Prof.Dr. Shamet Shabani
3. Prof.Dr. Ali Bajgora
4. Prof.Asoc.Dr.Naim Mëçalla
5. Prof. Asoc.Dr. Shefqet Muçi
6. Prof. Asoc.Dr. Kosta Gazeli
7. Msc Brunilda Paskali
8. Dr. Enriko Ceko
9. Prof.Asoc.Dr.Elisabeta Imeraj
10. Prof.Asoc.Dr.Iljaz Mehmeti
11. Prof.Asoc.Dr. Arjana Muça
12. Doc. Valentina Kondili
13. Dr.Valbona Softa
14. Dr. Alma Shehu
15. Dr. Elmaz Sherifi
16. Dr. Valentina Memini
17. Dr. Lediana Beshaj
18. Msc. Ketrina Paskali
19. Dr. Laurant Bica
20. Msc. Fatmira Laska
21. Dr. Edo Sherifi
22. Dr. Spiro Budo
23. Dr. Edit Bregu
24. Dr. Adela Kakia
25. Dr. Ludmilla Shkurti

Kryeredaktor

Prof.As.Dr. Naim Mëçalla

Redaktor shkencor

Dr. Valbona Softa

Dr. Edit Bregu

Msc. Uarda Roshi

KOLEGJI UNIVERSITAR “WISDOM”

Rruga “Medar Shtylla”, (Komuna e Parisit), Tiranë,
www.wisdom.al. tel: 042200063; cel: 0676022736

Kolegji Universitar “Wisdom”, ish Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” është krijuar nga shoqëria “Wisdom” sh.p.k. mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.672, datë 27.09.2006. Ndërsa me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.254, datë 27.02.2008, është dhënë leja për zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë dhe atë të Psikologjisë. Me Urdhër Nr.412 datë 25.08.2011 të Ministrit të MASH është miratuar riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” me dy fakultete, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike e Shoqërore. Me Urdhër Nr.355, datë 25.10.2015 të Ministrit të MAS është bërë Akreditimi Institucional i saj.

Mbështetur në nenin 20, 33 dhe 129 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik me Vendimin Nr. 6, datë 03.02.2017 vendosi riorganizimin e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University”. Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” u kthye në Kolegj Universitar, me emërtimin **KOLEGJI UNIVERSITAR “WISDOM”**, miratuar me Urdhër Nr.145, date 31.03.2017 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Kolegji Universitar “Wisdom” përbëhet nga dy njësi kryesore. Njësitë përbërëse të Kolegjit

Universitar “Wisdom” janë strukturuar sipas nenit 22, të Ligjit Nr.80/2015, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave

Ekonomike dhe Shoqërore me njësitë bazë. Struktura akademike e Kolegjit Universitar "Wisdom", është:

- a) Senati Akademik
- b) Rektori
- c) Rektorati
- d) Këshilli i Etikës
- e) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- f) Komisioni për garantimin e standartëve të cilësisë
- g) Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe kurrikulën
- h) Komisioni për marrëdhëniet me studentët, publikun dhe kordinimin.

3. Fakulteti i Drejtësisë me tre njësi bazë,

- a) Departamenti i të Drejtës Publike
- b) Departamenti i të Drejtës Private
- c) Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Mardhënieve me Jashtë.

4. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, me tre njësi bazë,

- a. Departamenti i Ekonomisë
- b. Departamenti i Psikologjisë
- c. Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Mardhënieve me Jashtë.

Vlen të theksohet se Shoqëria "Wisdom" sh.p.k. ka më shumë se 17 vjet që operon në fushën e mësimdhënies dhe në atë të aftësisimit profesional nëpërmjet organizimit të kurseve të gjuhëve të huaja. Në këtë kuadër, Qendra e Kurseve të Gjuhëve "Wisdom", zotëron të drejtën dhe organizon rregullisht provimin ndërkombëtar të TOEFL. Që prej vitit 2016 është e licencuar për dhënien e provimit ndërkombëtar të TOEFL-it BT (Internet Based) në Shqipëri.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Kufizimi i konkurrencës në ekonomi nga integrimet në linjë të drejtë-vertikale.

Prof. Dr. Lush Përpali 7

Parimet dhe baza juridike e së drejtës së votimit.

Docente Valentina Kondili

Doktorante Jonida Kondili..... 19

Rëndësia e informacionit për menaxhimin e cilësisë.

Dr. MBA. MSc. Enriko Ceko

Prof. As. Dr. Naim Mëçella..... 33

Vështrim mbi modelin e suksesshëm të USKOK-ut në Kroaci dhe rasti i Shqipërisë.

Dr. Mark Ndreca..... 47

Dhuna në familje, roli i legjislacionit dhe policisë së shtetit në parandalimin dhe reduktimin e saj në vitin 2015.

MSc. Arben Ibro

MSc. Fran Kaçorri

MSc. Bora Selmani..... 65

Ngjarjet traumatike dhe somatizimi në fëmijëri

Dr. Eneida Frashëri

MSc. Eva Janaqi 89

Tipare dhe veçori të urbanizimit.

Erjona Fusha 99

Shpëtimi i hebrnjve gjatë periudhës së monarkisë.

Dokt. Meri Kraja

MSc. Flutura Shabani 111

Mësimdhënia e gjuhës së huaj në klasat multikulturore.

MSc. Julvina Gjermani 127

Manaxhimi i cikleve të biznesit për periudhën 1993-2017. Rasti i Shqipërisë.

Dr. MBA. MSc. Enriko Ceko..... 133

Monitorimi i komunikimit të Bankës Qendrore - Rasti i Bankës së Shqipërisë.

MSc. Enri Herri 157

Siguria mjedisore dhe interpretimet nga shkollat e ndryshme të mendimit.

MSc. Flavia Kenaj 175

Kongresi i Vjenës1815, diplomacia e paqes së qëndrueshme në sistemin evropian dhe ballkanik të ekuilibrit të forcave.

Dr. Edit Bregu 189



Prof. Dr. Lush PERPALI



KUFIZIMI I KONKURRENCËS NË EKONOMI NGA INTEGRIMET NË LINJË TË DREJTË-VERTIKALE

Hyrje

Subjektet ekonomike në përgjithësi angazhohen në veprimtari të ndryshme, çdo njëra prej të cilave mund të realizohet nga një ndërmarrje e veçantë. P.sh. një fabrikë birre përveçese prodhon birre, ajo mundet gjithashtu të ketë pub-et (lokalet) e veta për të shitur birren direkt tek konsumatori. Në këtë rast, pra kur fabrika e berrës ka edhe dyqanet e veta të shitjes tek konsumatori, përveç prodhimit të birres nga ana e saj, atehere kjo quhet integrim vertikal. Kjo do të thotë që fabrika e birres siguron produktin e vet që është birra në një tjetër proces që është shitja me pakice e berrës. Në qoftese fabrika e birres shet birren e saj vetem tek pub-et (lokalet), atehere ajo mund të imponoje kufizime vertikale tek pub-et. P.sh. fabrika e birres mund të përcaktojë çmimin e shitjes me pakice të birres së saj, ose mund të kërkojë që pub-et të cilat shesin berrën e saj të mos pranojnë për shitje produkte birre të markave të tjera.

Firmat e biznesit mund të përdorin kufizime vertikale për një numer të ndryshëm arsyesh. Ato zakonisht mund të shtojnë kooordinimin midis niveleve të ndryshme të prodhimit apo shpërndarjes. Ato mundet gjithashtu të rishpërndajnë riskun midis ndërmarrjeve furnizuese dhe atyre që realizojnë shitjen e produkteve, drejtperdrejte tek konsumatori. Nga ana tjetër, pengesat vertikale mund të përdoren në mënyrë antikonkurrese për të reduktuar direkt ose indirekt konkurrencën, duke shtuar barrierat për hyrjet e konkurreseve të rinje.

Efektet e kufizimeve vertikale mbi konkurrencën janë komplekse dhe të vështira për tu identifikuar. Për shkak të kësaj nuk ka rregulla të thjeshta për të vlerësuar efektet konkurrese të tyre. Kështu çdo rast mund të ekzaminohet në kontekstin e vet.

Integrimi Vertikal

Një kompani biznesi quhet e integruar vertikalisht në qoftese ajo zotëron në të njëjtën kohë si procesin e prodhimit (upstream), ashtu edhe atë të shitjes me pakice, ose thënë ndryshe të shitjes direkt tek konsumatori (downstream). P.sh. një prodhues këpucesh që zotëron një fabrike këpucesh dhe në të njëjtën kohë i shet po vete në dyqanet e kepuceve, atëhere ky proces mund të quhet *integrim vertikal*. Një tjetër shëmbull i një inetgrimi vertikal është rasti fabrikave të prodhimit të bulmetrave (bulmetoret) që zotëron feramat e produktit të qumeshtit. Feramat prodhojnë qumësht të fresket (të papërpunuar), dhe fabrika e bulmetrave e përdore këtë produkt si lëndë të pare në procesin e prodhimit duke nxjerre : qumësht të përpunuar, gjalp, djathe, kose etj.

Në një treg ekonomik , lidhja vertikale e proceseve mund të jenë:

- Transaksione tregtare midis firmave të veçanta.
- Kontrata midis firmave të vecanta.
- Integrimi vertikal në një kompani të vetme.

Subjektet e biznesit bëjnë integrim vertikal për të evituar ineficencat që mund të rriten nga kontratat ose transaksionet tregtare. Nëqoftese kontratat nuk mund të specifikojne në mënyre adekuate (të sakte) obligimet e firmave, atehere frmat mundet të zëvendsojne pronesine nga kontartat. Për shembull, nëqoftëse një firme dësheronte të shkruente një kontrate që permban pengesa vertikale të cilat ishin ilegale sipas ligjit të mbrojtjes së konkurrences , qëkurse kontrata nuk hyn në fuqi, firma mund të zëvendsoje integrimin vertikal. Edhe ketu e rendesishme eshte matja e strukturës së tregut qe zene kompanite per te pare fuqine qe kane ne realizimin e kufizimeve ne treg. Për këtë mund të përdoret kjo formule:

$$\text{Str.} = A1 + A2 + A3 + \dots + Ai$$

Ku Ai = përqindja në treg e firmës se i-te.

Nëqoftëse Str. tenton drejt zeros, kjo tregon që konkurueshmeria është e mirë pasi asnjë nga firmat nuk ka përqindje të madhe në treg,

dhe prandaj edhe kufizimet qe mund te vendosin firmat kane efekte me te paketa.

Disa nga problemet e pergjithshme me kontratat mund te specifikohen:

Kufizimet (limitimet) e kontratave.

Në kontrata specifikohen obligimet midis kontaktuesve. Megjithatë kontratat mund të jenë joadekuate për disa arsye ku mund të permendim:

- Produkti/ shërbimi, nuk mund të specifikohet në menyre të qarte.
- Obligimet nuk mund të specifikohen në të gjitha rrethanat e mundeshme.
- Sistemi ligjor mund të mos detyroje apo të imponoje zbatimin e kontratave.

Nga njehere është shumë e veshtire ose e pamundur për të pershkruar produktin, kështuqe me një arbiter të pavarur sic është gjykata, mund të përcaktoje kur termat e kontrates jane plotesuar. Nëqoftese kompania është e integruar në mënyre vertikale, menaxheret e saj duhet të kenë inisiativën dhe aftësine për të provuar në se produkti është korrekt me parametrat e tije.

Eshtë e vështirë që kontratat të përshkruhen në mënyre të tillë për të mbuluar gjithë kushtet e mundeshme. Nëqoftese ndodh një gjë e papritur dhe kontrata nuk ka përshkruar gjithë anët oblikative në këtë rast , atehere kontrata mund të kushtoje ose të behet e pamundur për tu zbatuar.

Nëqoftese një kontratë përmban kufizime vertikale që janë të ndaluara nga ligji i konkurrences, atehere kjo kontrate është e pazbatueshme. Për më teper në periudha kur në vend ndodhin ndryshime të mëdha të struktures së legjislacionit , kur ligjet mund të bëhen të paqarta , kontratat mund të bëhen pjeserisht të kushtueshme, të veshtira për tu zbatuar ose të pamundura.

Zbatimi i kontartave kërkon koordinimin e mire midis kompanive ose brënda kompanise.

Koordinimi i aseteve mund të jete me i lehte nëse ato jane në të njëjten firme, nën drejtimin dhe menaxhimin e përbashket, se sa kur ato jane në kompani të ndryshme. Le të marrim si shembull lidhjen midis fabrikes për prodim buke dhe fabrikes së miellit. Materiali nga fabrika e miellit tek ajo e bukes duhet të dërgohet jo vetem në kohen e duhur por edhe me disa specifkime kimike të caktuara. Prishja e procesit të furnizimit (downstream) është e kushtueshme. Kështu nëqoftëse aktivite e mesiperme zotërohen nga kompani të ndryshme, atëhere kontratat midis tyre duhet të pershkruhen në mënyrë të tillë që të parashikojnë detyrimet e paleve në cdo rrethane të mundëshme.

Një firme mund të bëjë investim të pariparueshem në rastet kur për të realizuar investimin përdor produkte (lende të pare) nga një firmë tjetër dhe në kontraten midis tyre nuk është parashikuar saktesisht cdo gjë në cfardo rrethane, pra detyrimet reciproke të paleve në rrethana të caktuara që mund të ndodhin në të ardhmen në prcesin e realizimit të kontrates. Për shembull një miniere mund të ndërtoje një degzim hekurudhore duke ja kerkuar këtë një kompanie specifike që merret me hekurudhat. Pas ndërtimit të këtij degzimi hekurudhor ,kalimi tek një tjetër ndertues hekurudhash bëhet më i kushtueshem. Në këtë rast ndërtuesi i hekurudhes paraqitet efektivisht në pozitën e monopolistit. Cmimi i afruar nga ai mund të mos jete konkurrues. Prandaj miniera realizon me pak shërbime. Në të kundërt nëqoftese si miniera ashtu edhe ndertuesi i hekurudhave do të ishin pronar të përbashket do të luftonin për maksimum fitimi ; cmimi i brëndeshem i transportit me këtë degzim hekurudhor do të ishte i përbërë nga kostoja e transportit dhe do të përdorej maksimumi i kapacitetit transportues të hekurudhes. Integrimi vertikal në këtë rast do të ishte zgjidhje më e mire se sa kompanite të qëndrojnë të ndara.

Integrimi vertikal , me drejtim dhe menaxhim të përbashket mund të kapërcejë disa probleme si ato që u përmënden më larte. Megjithate integrimi vertikal mund të reduktojë konkurrencen nëqoftese ai është rezultat i përjashtimit të subjekteve të tjera ekonomike ose

rezultat i barrierave të larta në hyrje. Gjithashtu nëqoftese kompanite e pintepruara janë subjekt të sjelljeve antikonkurrese, atehere integrimi vertikal i tyre mund të rrisë barrierat e hyrjes. Hyrjet potenciale mund të përcaktojnë që nëqoftese ato duan të hyjnë në një treg, atehere ata duhet të futen në të dy tregjet së bashku. Si rezultat i hyrjes së një numri të kufizuar firmash reduktohet konkurrenca dhe vetë tregu. Më mire se integrimi vertikal, firmat mund të imponojne një larmi pengesash vertikale si kompani të ndara ose independente.

Arsyet që një kompani mund të përdore pengesat vertikale kanë të bëjnë me faktin që të limitohen mundësite që firma të tjera të përfitojnë nga veprimet e një tjetre pa paguar ose ndare koston për këtë përfitim. P.sh. një dyqan reklamon një produkt i cili shitet një heresh në dy dyqane. Në këtë rast dyqani i dytë është përfitues falas i reklames së paguar nga dyqani i parë. Problemi në këtë "përfitim Falas" ka të bëjë me faktin që firma e cila bën shpenzimet mund të mos përfitojë sa duhen nga kjo, sepse të tjera kompani kanë përfituar, sidomos kur "përfitimi falas" është sinjifikant. Mund të ndodhë rasti që firma që paguan për aktivitetin nuk përfiton për vetvete në mënyre të kënaqeshme, kështu që ajo mund të pushojë aktivitetin në këtë fushë. Në rastin e mesipërme, nese dyqani që ka bërë reklamen është i vetmi që vepron në një zonë të caktuar, atehere ai mund të realizojë përfitimet e reklames së paguar, pra shpenzimet për reklamen rezultojnë efektive. Por nëse një tjetër dyqan realizon gjithashtu shumë përfitime nga kjo reklame duke marrë konsumator nga firma reklamuese, atëhere kjo e fundit mund të konsiderojë këtë si jofitimpruese dhe e nderpret atë.

Në mardhënjet "shit-bleje", paraqiten raste nga më të ndryshmet të situatave monopol ose jo.

Furnizuesi monopolist (upstream monopoly), i furnizuari (downstream) gjithashtu monopolist. Le të konsiderojmë një rast kur

një fabrike është në pozita monopol, dhe e shet produktin e tij tek një shites me pakice me cmimet e shumicës. Ndërsa kuptohet që shitesi me pakice do ta shese produktin me cmim pakice, duke qënë edhe ky në pozita monopol.

Meqënëse shitesi me pakice është monopolist duke e shitur produktin me cmime pakice, cmimi është më i lartë se kostoje e tij. Prandaj ai gjen një cmim shitje me shumicë që të jetë më i lartë se kostoja e produktit. Cdo kompani maksimizon fitimet e saja duke pefitur nga fitimi i firmave të tjera. Vecanërisht, shitësi me pakice nuk fut në llogarinë e tij fitimin minimal (cmim me shumice – coston e produktit), nga cdo sasi e shitur kur ai bën shitje me pakice. Si rezultat i cmimit të fabrikës ku e blen dhe shtitjes me pakice, çmimi i fundit (pra me pakice) është relativisht shumë më i lartë se kostoje e produktit. Një integrim vertikal monopolist realizon cmim shitje me pakice duke përfitur më shumë.

Prodhuesi mund të imponojnë disa kufizime vertikale tek shitesi me pakice në mënyrë që të bindë atë për fitim maksimal nga cmimi i shitjes me pakicë.

Prodhuesi mund ti jape ekskluzivitetin e shtitjes duke vendosur edhe tarifë ekskluzive për shitjen. Prodhuesi mundet gjithashtu ti imponojë shitësit edhe cmimin me pakicë.

Mirepo mund të ndodhe rasti që shitësi mundet të mos dëshërojë të sigurojë aq shume shërbime sa që kërkon prodhuesi ose aq sa prodhuesi dëshëron, synon të realizojë. Kjo ndodhë në rastin kur shitesi nuk përfiton për cdo sasi të shitura apo shërbime të afruara sic përfiton prodhuesi. Për më tepër shitësi përpiqet të sigurojë aq sasi shërbimesh apo produktesh sa të përfitojë maksimalisht për vete. Pranohet se është shumë e vështirë për prodhuesin të monitorojë shitësin për të mësuar se si ai i realizon këto shërbime shtesë. Gjithashtu prodhuesi nuk mund të parashikojë një kontrate specifike për të të gjitha rastet e shërbimeve të shitësit. Kështu që për prodhuesin është më mirë të mëndojë një sistem se si te nxisë shitësin për të shtuar shërbimet.

- Prodhuesi munde të shtyhet për të vendosur një çmim të

barabarte me koston e prodhimit duke e ngarkuar bleresin edhe me një tarifë ekskluzive.

- Kjo sepse vetem cmimi i rishitjes nuk mund të zgjidh synimin e shitësit (të furnizuarit nga prodhuesi) për të realizuar sa me shumë fitime nga shtimi i shërbimeve. Ai siguron vetëm aq shërbime sa maksimalizojnë fitimin e tijë. Vetëm nëoftëse prodhuesi shton edhe një tarifë ekskluzive dhe vendose një çmim shumice duke synuar koston e produktit; atëhere ai mund të mxisë shitesin të sigurojë sa më shumë shërbime ose shitje për njësi produkti.

Çfarë ndodhë në rastin kur prodhuesi (furnizuesi) është në pozita monopol dhe shitësi (i furnizuari) është në pozita jo monopol por vepron në një treg konkures. Le të supozojme se kompania siguron shërbime të tilla tek konsumatorët si: reklama informative, informacion para shitjeve, ose produkte me asortimente të shumeta. Kur konsumatorët shohin cmime të larta, të produkteve apo shërbimeve, atëhere ata kalojnë tek rastet ku si produktet apo shërbimet kanë cmime më të uleta. Kjo sepse egziston kjo mundësi pasi sic suposiam kompania punon në kushtet e konkurrences pra tregu është konurrues ku veprojnë edhe subjekte të tjera me po keto produktet apo shërbime. Përfundimisht këto produkte apo shërbime nuk përfundojnë tek konsumatori gjë që përbën edhe qëllimin final po kompania është e detyruar të dal nga tregu me to ose të ndryshojë subjektin e veprimtarisë.

Është e kuptueshme që prodhuesi nuk e dësheron këtë situatë, sepse shitjet e tijë kanë qënë të larta kur produkti ka qënë i përshtatshëm për konsumatorin, prandaj ai do të luftojë që të reduktoje daljen nga tregu (free riding) të produkteve apo shërbimeve që ofron. Për këtë prodhuesi mundet:

- Prodhuesi mund të vendosë një çmim minimal të shitjes me pakice. Konsumatorët e blejnë produktein apo shërbimin sepse ata e dinë që nuk mund të gjejnë një çmim më të ulët për të njëjtat produkte.

- Prodhuesi mund të japë ekskluzivitet territorial, duke zgjedhur nga një shitës në cdo teritor ose treg që realizon i vetëm shitjen e këtij produkti ose shërbimi. Në këtë rast shitësi është i interesuar të kryejë sa më shumë shitje të këtij produkti, përderisa konsumatorët nuk mund të gjëjnë të njëjtin produkt apo shërbim tek një shitës tjetër. Për më tepër shitësit me pakice janë direkt të varur nga shërbimi që ata ofrojnë apo produktet që shesin. (Këtu fjala teritore nuk ka vetëm kuptim gjeografik por më gjërë; prodhuesi mund të caktojë shitës edhe sipas tipeve të vecanta të konsumatoreve sic mund të jenë qeveritare (publike), biznese apo konsumator individual.

Është e qartë se këto veprime mund të shtojnë përfitimet e prodhuesit. Por duhet theksuar se cdo njeri nga këto veprime mund të ketë edhe efekte negative mbi konkurrueshmërinë. Nëqoftese prodhuesi imponon fitim maksimal, atëherë shitësi nuk mund të konkurojë duke ofruar cmime të ulëta. Ndoshta ai mund të konkurrojë duke ofruar shërbime më të mira. Por nëse konsumatorët nuk i vlersojnë shërbimet ekstra (me të mira), atëherë konkurrenca nuk i përfiton ato. Në mënyrë alternative, nëse shitësi nuk mund të konkurojë në cmim, sepse prodhuesi ka imponuar cmime maksimale, atëherë shitësi nuk mund të konkurrojë gjithsesi. Nëqoftese prodhuesi cakton teritore ekskluzive, atëherë cdo shitës do të jetë një shitës monopolist i këtij produkti (marke) në teritorin e vet. Si rezultat humbje në konkurrencën e shitjes mund të jetë më e keqe se humbja në shërbimet joadekuate. (non-appropriable)

Prandaj, për të zhvilluar efektet konkurruese të kufizimeve vertikale në këtë rast, është e rëndësishme për të mesuar nëse ka një shërbim të realizuar nga shitësi dhe për të cilin nuk paguan në menyrë të ndarë. Shërbimi mund të ketë efekt substancial në kërkesën e konsumatorit. Nëqoftese nuk ka një shërbim të tillë atëherë ka arsye esenciale që ky kufizim vertikal të përdoret për të reduktuar konkurrueshmërinë.

Refuzimi për të furnizuar dhe kufizimi vertikal

Një prodhues mund të refuzojë për të furnizuar një blerës (shitës), sepse ai mund të ketë nënshkruar një marrveshje me të tjerë blerës duke u dhënë atyre ekskluzivitetin territorial të shitjes. Nëse një shitës kërkon të shesë produktet e një fabrike, ky i fundit pra prodhuesi mundet të refuzojë të furnizojë atë, bile duke prishur edhe marrveshjet e mëprshme kontraktuale të lidhura. Kjo ndodhe sepse prodhuesi praktikon rishitjen duke ruajtur cmimet ndërsa blerësi – shitës ka biseduar me parë për ndryshimin e cmimeve. *Në këtë mënyrë refuzimi për të furnizuar mund të perdoret si një mjet për të detyruar një tjetër kufizim vertikal.* Ka edhe arsye biznesi që prodhuesi mund të mos furnizojë blerësit sic mund të jone: gjëndje jo mire likujduese e blereseve, blerësit mund të dëmtojnë reputacionin e shitësit nga mos menaxhimi apo sherbimi i mirë i produktit etj.

Refuzimi për të furnizuar pa shkaqe të arsyeshme për prodhuesin, ka efekte antikonkurrese sidomos kur mohon një faktor apo hyrje të re në treg.

Detyrimi për të blere produkte të tjera

Mund të ndodhë që furnizuesi të detyrojë blerësin që pervec produktit sipas kontratës, të blejë edhe një produkt tjetër. Përgjithësisht kjo ka efekte antikonkurrese dhe ndodhë në ato raste kur në depot e furnizuesit ka produkte që nuk shiten. Atehere shitësi ju vë kusht blerësve që krahas produktit që ata deshërojnë të blejnë edhe sasira nga stoqet, në të kundërt nuk u shet as produktin e kërkuar. Vetem në rastet kur mund të ketë arsye teknike për shitjen e perbashket të të dy produkteve (ose më shumë), atehere efekti i këtij detyrimi mund të mos jetë antikonkurrese. P.sh. mund të ndodhë që performanca e një produkti është substencialisht e reduktuar nëqoftese produkti tjetër që lidhet me të është me cilesi të dobët, dhe konsumatorët nuk mund të dallojne arsyen e performances së dobët. Gjithashtu mundet që shitja e perbashket e produkteve të ulë ndjeshëm koston. Nga ana tjetër nëse nuk ka arsye teknike për këtë shitje "te lidhur", "lidhja"

mund të përdoret për të shtrirë fuqine monopolistike nga një treg tek tjetri, ose për të evituar kontrollin e cmimit në një treg të dhënë, pra për të vendosur cmim monopol.

Literatura

- Carlton, Perloff. "Modern Industrial Organization". 3 rd ED. 2000
- Marvin Price. "Cartels Investigation and Enforcemanet"
- J.W. Friedman. "On experimental Reserch in Oligopoly" 1989
- Armanitier, Richard. "Entry and exchanges of costs information". 2002
- Ray , R. "Tacit Collusion. Oxford Review of Economic Policy". 1993
- Dick. K "Knowing your rivals price. 2002
- J. Kwoka, L.White. "The Antitrust Revolutin". Oxford University - 2004
- Elliott, David. "Evidences in Cartel Cases" Vienna. 2005.
- Carlton, Perloff. "Modern Industrial Organization". 3 rd ED. 2000.
- Green and Porter. "Non co-operative collusion under imperfect price information" 1984.
- Lush Perpali "Çeshtje te Konkurrences ne Ekonomi", monografi, Tirane 2006

Abstract

The effects on competition of vertical restraints are complex. Because of this, there are no simple rules for evaluating their competitive effect. Each instance must be examined in its context. However, some very broad guidelines can be provided.

Companies use vertical restraints for a variety reasons. They can used to increase co-ordination between different levels of production or distribution. They can also be used to allocate risk between the upstream and downstream firm and to protect intellectual property. On other hand, vertical restraints

can be used anti-competitively to reduce competition directly, or indirectly by raising barriers to the entry of new competitors.

May happen that vertical restraints increase efficiency because they may reduce the externalities generated by decision by upstream and downstream firms. These externalities can reduce profits and increase costs. But this need a carefully study.



Docente Valentina KONDILI



Doktorante Jonida KONDILI



PARIMET DHE BAZA JURIDIKE E SË DREJTËS SË VOTIMIT

Organizimi i zgjedhjeve të drejta, të ndershme brenda standardeve kërkon dhe njohjen e parimeve dhe rregullimin ligjor, tregues të cilët lidhur dhe me trashëgiminë përkatëse, përbëjnë bazat juridike mbi të cilat duhet të mbështet çdo sistem votimi, me synimin që të mund të realizohet demokracia e dëshiruar.

Abstrakt:

Zgjedhjet parlamentare të Qershorit 2017, konsiderohen gjerësisht si një test i rëndësishëm për zhvillimin demokratik të Shqipërisë dhe aspiratat e saj drejt Bashkimit Evropian. Përgjithësisht, kuadri ligjor ofron një bazë të shëndoshë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Ndryshimet në kuadrin ligjor do të mund të krijojnë kushte ligjore më të mira lidhur me zgjedhjet, por pavarësisht kuadrit ligjor konkret ka disa institute ligjore, të cilat janë themelore lidhur me zgjedhjet sikurse janë parimet dhe baza juridike e votimit. Trajtimi i parimeve kryesore, bazuar në trashëgiminë elektorale Evropiane ndikon në formimin e ndërgjegjes juridike të votuesve, prandaj dhe në këtë shkrim janë trajtuar parimet sipas kuadrit tonë ligjor, bazuar dhe në Kodin e Praktikës së Mirë në çështjet zgjedhore, sipas të cilit parimet e votimit konsiderohen si një aspekt shumë i rëndësishëm që lidhet me procesin e votimit

Fjalë Kyçe:

Votim i përgjithshëm, votim i lirë, votim i barabartë, votim i fshehtë, votim vetjak, votim periodik.

1. Rregullimi ligjor i zgjedhjeve me Kodin zgjedhor të vitit 2008 (me ndryshimet e bëra)

Në Kodin zgjedhor të miratuar në vitin 2008, u konsolidua trashëgimia elektorale Evropiane, por dhe e legjislacionit të brendshëm, lidhur me përcaktimin e parimeve të përgjithshme, të cilat përbëjnë bazën juridike për zhvillimin e zgjedhjeve. Në Kod

u rregullua mënyra e organizimit dhe funksionimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nevojë që u përcaktua pas ndryshimeve kushtetuese, sepse para ndryshimeve KQZ-ja konsiderohej organ kushtetues.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod. Në Kod u rregullua organizimi i zgjedhjeve lidhur me kuvendin si dhe zgjedhjet vendore, duke u bazuar në sistemin zgjedhor të përcaktuar me ndryshimet kushtetuese, që ishte ai proporcional rajonal. Sistemi proporcional u zgjodh për arsye të përparësive që ai siguron duke menduar se siguron përfaqësim të drejtë dhe qeverisje të qëndrueshme.

Pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare të Qershorit 2009 e 2013 si dhe pas përfundimit të zgjedhjeve vendore të Majit 2011, si dhe në ato të Qershorit 2015, kanë lindur debate për nevojën e ndryshimeve, duke synuar përmirësime lidhur me këtë Kod. Qëndrimi kontestues lidhur me rezultatet e zgjedhjeve vazhdon, megjithëse gjatë kësaj periudhe ndryshimesh rreth 26 vjeçare ka pasur arritje si juridikisht ashtu dhe praktikisht. Evidentimi i problematikës sidomos këto dy vjetët e fundit shtron nevojën e ndryshimeve bazuar në problematikën e lindur, por njëkohësisht dhe në rekomandimet e OSBE-ODIHR-rit. Megjithatë evident mbetet përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me administrimin e zgjedhjeve sidomos lidhur me numërimin e fletëve të votimit dhe përllogaritjen e mandateve të subjekteve zgjedhore. Por për të pasur zgjedhje të lira është gjithashtu shumë e rëndësishme njohja me parimet e përgjithshme të së drejtës zgjedhore, zbatimi me rigorozitet i të cilave ndikon dhe në rritjen e cilësisë së procesit të votimit e për rrjedhojë dhe në rezultatin e votimit.

2. Parimet e përgjithshme të së drejtës së zgjedhjeve

Për të pasur zgjedhje të lira të ndershme dhe brenda standardeve evropiane është e nevojshme të njihen dhe të zbatohen pesë parimet e rëndësishme, të cilat përbëjnë dhe bazën e trashëgimisë elektorale, të

përcaktuara dhe në Kodin e Praktikës së Mirë në çështjet zgjedhore¹. Këto parime janë parashikuar në ligjin themelor, në Kushtetutë, por njëkohësisht janë parashikuar drejtpërdrejt dhe në Kodin zgjedhor. Konsiderohen bazë juridike pesë parime të rëndësishme që janë: votimi i përgjithshëm, i barabartë, i lirë, i fshehtë dhe i drejtpërdrejt. Përveç kësaj zgjedhjet duhet të zhvillohen dhe në intervale të rregullta kohe.

2.1. Votim i përgjithshëm

Votim i përgjithshëm do të thotë se në parim kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen të gjithë njerëzit. Megjithatë kjo e drejtë mund dhe në fakt duhet t'i nënshtrohet disa kushteve. E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur duhet t'i nënshtrohet kushtit për një moshë të caktuar minimale.

Në kushtetutë përcaktohet se çdo shtetas që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë dhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet². E drejta për t'u zgjedhur zakonisht përfitohet në të njëjtën kohë me të drejtën për të zgjedhur, por sikurse rekomandohet në Kodin e Praktikës së Mirë jo më vonë se moshë 25 vjeç. Në raste të veçanta janë vendosur kufij specifikë lidhur me moshën për t'u zgjedhur në disa funksione të caktuara³ Sipas rastit mund të zbatohet kushti i kombësisë ose i vend banimit si p.sh. në rastin e zgjedhjes në këshillat vendore ose si kryetar bashkie ose i komunës⁴. Me ndryshimet e bëra

-
- 1 Kodi i Praktikës së Mirë është përmbledhës dhe raport shpjegues i nxjerrë nga Komisioni Evropian Për Demokracinë përmes ligjit (Komisioni i, opinionin nr. 190/2002, i Këshillit të Evropës.)
 - 2 Neni 3/3 i Kodit Zgjedhor përcakton: Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë dhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë kod.
 - 3 Neni 86/2 i Kushtetutës: "President mund të zgjidhet vetëm shtetasi shqiptar që nga lindja, me qëndrim jo më pak se 10 vjetet e fundit në Shqipëri dhe që ka mbushur moshën 40 vjeç".
 - 4 Neni 109/3 i Kushtetutës sipas të cilit: "Të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendore dhe si kryetar bashkie ose komune e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse"... (Lidhur me këtë problem ka praktikë të Gjykatës Kushtetuese).

në Kushtetutë në muajin Korrik 2016 është parashikuar gjithashtu se u njihet e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, edhe shtetasve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara në ligj.

Kodi zgjedhor aktual ka dhe rregullim të veçantë lidhur me zgjedhësit e veçantë si p.sh. rregullimi i bërë sipas neneve 58, 59, 60, 61 dhe 62 të tij. Kështu institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra votimi në këto institucione ngrihen kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës.

KQZ-ja mbikëqyr procesin e hartimit të listave, duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të gjendjes civile dhe njësisve të qeverisjes vendore për procesin e caktimit të zonave të qendrave të votimit dhe numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi, në përputhje me rregullat e Kodit zgjedhor dhe ligjit të gjendjes civile⁵

Përrjashtimi nga e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur duhet të parashikohet me ligj, duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit, heqja e të drejtave politike ose përcaktimi i paaftësisë mendore mund të aplikohet vetëm me vendim të posaçëm gjykatë⁶. Në këtë drejtim rëndësi ka plotësimi dhe respektimi i procedurave lidhur me listat e zgjedhësve si dhe për paraqitjen e kandidatëve individualë ose të listave të kandidatëve mund të kushtëzohet me mbledhjen e një numri të caktuar firmash⁷.

2.2. Votim i barabartë

Çdo votues ka në parim një votë. Në rastet kur një sistem zgjedhor i akordon zgjedhësve më tepër se një votë, çdo zgjedhës duhet të ketë të njëjtin numër votash. Në këtë drejtim duhet të kihet parasysh fuqia e barabartë e votës, e cila duhet të ndahet në mënyrë të barabarta midis zonave zgjedhore. Kërkesa kryesore e këtij parimi është një njeri një votë. Në rastin e zonave zgjedhore me sistem proporcional do të

5 Neni 61 i Kodit Zgjedhor (sipas ndryshimeve të vitit 2012).

6 Neni 45 i Kushtetutës.

7 Nenet 58 dhe 69 të Kodit Zgjedhor.

ishte preferuese që mandatet të rishpërndahen pa bërë ri përcaktim të kufijve të zonave zgjedhore, të cilat ku është e mundur duhet të kenë përputhje me kufijtë administrativë.

Votim i barabartë nënkupton barazi dhe shanse. Shanset e barabarta duhet të garantohen si për partitë ashtu dhe për kandidatët. Kjo lidhet me një qëndrim asnjans nga ana e autoriteteve shtetërore sidomos lidhur me fushatën zgjedhore, mbulimin nga media sidomos ajo publike, si dhe financimet publike të partive dhe fushatave. Ky parim konsiston dhe në barazinë për pakicat kombëtare si dhe përfaqësimi i barabartë midis gjinive. Në këtë drejtim është përcaktuar se rregullat ligjore, të cilat kërkojnë një përqindje minimale të personave të secilës gjini në numrin e përgjithshëm të kandidatëve, nuk duhen konsideruar si shkelje të parimit për votim të barabartë, nëqoftëse kanë një bazë kushtetuese⁸.

2.3. Votim i lirë

Parimi i zgjedhjeve të lira ka kërkesë kryesore sigurimin e kushteve dhe garancive për të bërë të mundur shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve⁹. Me votim të lira kuptohen dy drejtime kryesore të kushteve të nevojshme për të krijuar mundësinë e realizimit të kësaj lirie si:

- liria e zgjedhësve për të formuar opinionin e tyre si dhe
- liria e zgjedhësve për të shprehur vullnetin e tyre dhe masat kundër mashtrimit zgjedhor.

Sipas Kodit të Praktikës së Mirë lidhur me çështjet zgjedhore për realizimin e votimit të lirë kërkohet që autoritetet shtetërore të jenë të paanshëm, gjë që lidhet me median, me vendosjen e posterave, me të drejtën për të manifestuar në vende publike si dhe me financimin e partive dhe të kandidatëve.

Në këtë drejtim autoritetet publike duhet t'u paraqesim zgjedhësve kandidaturat e regjistruara, duhet t'u krijojnë mundësi zgjedhësve

8 Neni 67/5 i Kodit Zgjedhor.

9 Anastasi A., E Drejta Kushtetuese, Tiranë, 2003, f. 126.

për njohjen me listat dhe kandidatët për zgjedhje. Ky informacion duhet të afrohet gjithashtu në gjuhët e pakicave kombëtare.

Liria e zgjedhësve për të shprehur vullnetin e tyre dhe masat kundër mashtrimit zgjedhor ka të bëjë kryesisht me procedurat e votimit, të cilat duhet të jenë të thjeshta. Votuesit si rregull duhet të kenë gjithmonë mundësinë për të votuar në një qendër votimi. Në rastin e votimit elektronik ai duhet të përdoret vetëm në qoftëse është i sigurt dhe i besueshëm. Në mënyrë të veçantë, zgjedhësit duhet të kenë mundësi për të bërë konfirmimin e votës së tyre dhe ta korrigjojnë atë në rast se është e nevojshme, duke respektuar votimin e fshehtë. Sistemi duhet të jetë transparent.

Në këtë drejtim krahas kriterëve të tjera të cilat janë të rekomandueshme, është e nevojshme të evidentohen dhe mund të zbatohen rast pas rasti të paktën dy kriterë që duhet të përdoren për të vlerësuar saktësinë e rezultateve të votimit:

- numri i zgjedhësve pjesëmarrës në votim dhe
- numri i fletëve të votimit të hedhura në kutitë e votimit¹⁰.

2.4. Votim i fshehtë

Zgjedhësit mund ta shprehin vullnetin e tyre në dy forma me votim të hapur dhe me votim të fshehtë. Votimi i hapur është formë e lashtë

10 Pika 3/2 e Kodit të Praktikës së Mirënë çështjeve zgjedhore. Në sqarimi i këtij parimi në pika 32 e këtij Kodi parashtrohet se: Objektiviteti i votës duhet të gjykohet vetëm mbi bazën e dy kriterëve kryesore: numri i zgjedhësve që kanë hedhur votën e tyre, në krahasim me numrin e fletëve të votimit në kutitë e votimit. Masa e parë mund të përcaktohet nga numri i firmave në regjistrin zgjedhor. Duke pasur parasysh se njerëzit gabojnë dhe pa dashje (pra jo me qëllim për të mashtruar), është vështirë të arrihet përputhje e plotë midis këtyre dy masave, dhe verifikimet e mëtejshme, siç është numri i fletëve të votimit ose krahasimi i përgjithshëm të fletëve të votimit të gjetura në kutitë e votimit, plus ato të anuluar dhe të papërdorura, me numrin e fletëve të votimit të lëshuara nga qendra e votimit mund të japë ndonjë ide të përgjithshme.

Por nuk duhet pasur iluzion se rezultatet e këtyre masave do të përputhen plotësisht. Rreziqet kanë të bëjnë më shumë me shumëfishimin e mospërputhjeve të tërësi dhe parregullsitë reale të mos merren parasysh. Është më mirë të ushtrohet kontroll rigoroz ndaj dy masave se sa të ushtrohet kontroll jo rigoroz dhe, prandaj, është jo i efektshëm ndaj një numri më të madh të rezultateve. (Parashtrimi ka ngjashmëri me problematikën e konstatuar tek ne pas përfundimit të zgjedhjeve të 8 majit 2011, lidhur me votimin për kryetarin e Bashkisë së Tiranës).

dhe konsiderohet primitive. Megjithëse në pamje të parë ky lloj votimi duket si demokratik në fakt nuk mund të konsiderohet i tillë sepse i le zgjedhësit të pambrojtur përpara presioneve të ndryshme, prandaj thuhet se nuk lejon shprehjen e lirë të vullnetit të tyre.

Për këtë arsye të gjitha Kushtetutat bashkëkohore i kanë dhënë përparësi votimit të fshehtë¹¹. Edhe sipas Kushtetutës sonë votimi është i fshehtë^{12, 13}. Fshehtësia e votimit nuk është vetëm një e drejtë, por dhe detyrë, mos përmbushja e së cilës duhet të ndëshkohet me skualifikimin e çdo flete votimi, kur zbulohet përmbajtja e saj. Votimi duhet të jetë mbi baza individuale, lista e personave që kanë votuar nuk duhet të botohet si dhe shkelja e fshehtësisë së votës duhet të ndëshkohet.

2.5. Votim i drejtpërdrejtë

Për t'u realizuar demokracia organe përkatëse si ato ligjvënëse apo këshillat vendore duhet të zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë.

Sipas Kushtetutës si dhe Kodit zgjedhor midis parimeve të pranuarra për zgjedhjet është dhe ai i votimit të drejtpërdrejtë.

2.6. Votim periodik

Votimi periodik konsiston në zhvillimin e zgjedhjeve në periudha të rregullta kohe. Zhvillimi i zgjedhjeve bën realitet pjesëmarrjen e popullit në qeverisje dhe për rrjedhojë konsiderohet kusht i domosdoshëm për demokracinë në një vend. Sipas Kushtetutës sonë në realizim të këtij parimi Kuvendi zgjidhet çdo 4 vjet¹⁴, si dhe organet përfaqësuese të qeverisjes vendore këshillat si dhe kryetari bashkisë ose i komunës po ashtu zgjidhen çdo katër vjet¹⁵.

11 Anastasi A., E drejta Kushtetuese, Tiranë 2003, f. 126.

12 Neni 45/4 i Kushtetutës: "Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë".

13 Neni 3/2 i Kodit zgjedhor: "Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod. Zgjedhësit e ushtrojnë lirisht të drejtën e votës".

14 Neni 65/1 i Kushtetutës.

15 Neni 109 i Kushtetutës.

3. Kushtet dhe zbatimi i parimeve

Sistemi zgjedhor mbështetet kryesisht mbi parimet që u trajtuan, por dhe mbi parime të tjera kushtetuese si dhe mbi drejtat themelore të njeriut, me qëllim që të garantohen kërkesat e parimit të shtetit të së drejtës.

3.1. Respektimi i të drejtave themelore

Zgjedhjet demokratike konsiderohen të tilla kur respektohen të drejtat e njeriut, sidomos liria e shprehjes dhe e shtypit, liria e qarkullimit brenda vendit, liria e grumbullimit dhe liritë e bashkimit dhe organizimit për qëllime politike. Kufizimet e këtyre lirive duhet të mbështeten në ligj, duhet të jenë në interesin publik si dhe duhet të jenë në përputhje me parimin e përpjesëtueshmërisë.

Për të pasur garanci në respektimin e të drejtave të njeriut lidhur me të drejtën zgjedhore sipas Kodit të Praktikës së Mirë lidhur me çështjet zgjedhore duhet që rregullat lidhur me të drejtën zgjedhore të nxirren të paktën në nivel ligji, kriter i cili në vendin tonë është vlerësuar drejt. Elementët thelbësore lidhur me të drejtën zgjedhore nuk duhet të ndryshohen më pak se një vit përpara zgjedhjeve ose duhet të shkruhen në Kushtetutë. Në kushtet e sotme politike në vendin tonë është e nevojshme që reforma zgjedhore në përshtatje me problematikën e shtruar për zgjidhje të ndërmerret dhe të përfundojë sa më shpejt, sepse në rast se zgjedhjet e përgjithshme bëhen në kohën e përcaktuar rregullisht, periudha e pranueshme në dispozicion për këtë reformë në situatën konkrete nuk është e realizueshme.

3.2. Garancitë procedurale

Lidhur me garancitë procedurale është i nevojshëm organizimi i zgjedhjeve nga një organ i paanshëm. Në këtë mënyrë realizohet transparenca, paanshmëria dhe pavarësia me qëllim që të sigurohet administrimi i rregullt i procesit zgjedhor, nga periudha para-zgjedhore deri në fund të përpunimit të rezultateve. KQZ duhet të jetë organ i përhershëm me qëllim që të mund të realizojë funksionin

e tij. E rëndësishme është dhe përbërja e tij. Ështëpreferuese marrja prej tij e vendimeve me konsensus, ose do të ishte e arsyeshme që vendimet të merren me një shumicë të kualifikuar p.sh. 2/3 ¹⁶.

Për garancitë procedurale rëndësi ka dhe vëzhgimi i zgjedhjeve që duhet të realizohet nga vëzhgues partiakë, vëzhgues vendas jo partiakë si dhe nga vëzhgues ndërkombëtare jo partiakë ¹⁷.

Duhet një sistem i efektshëm apelimi. Procedura e apelimit duhet të jetë e thjeshtë e përcaktuar qartë. Në procedurën e apelimit duhet të rregullohen qartësisht me ligj përgjegjësitë e organeve të ndryshme që përfshihen në të.

Ajo që është e rëndësishme është përcaktimi i qartë se procedura e apelimit duhet të jetë e natyrës gjyqësore, në kuptimin që të garantohen e drejta e apeluesve për procedura që të dëgjohen të dy palët. Ka rëndësi organizimi dhe funksionimi i qendrave të votimit financimi dhe siguria në qendrën e votimit.

4. Përfundime

Mbi bazën e respektimit të parimeve të lartpërmendura mund të përzgjidhet çdo sistem zgjedhor. Sistemet zgjedhore vlerësohen lidhur me zbatimin e parimeve shumë të rëndësishme që përbëjnë bazën e së drejtës zgjedhore. Zbatimi i parimeve lidhur me sistemin zgjedhor përkatës ndihmon që demokracia të shprehet në mënyra të ndryshme, por brenda kufijve të caktuar.

Parimet duhet të vendosen në kontekstin e tyre dhe duhet të garantohet zbatimi i tyre, sepse vetëm kështu mund të garantohet besueshmëria lidhur me një proces zgjedhor të caktuar. Në këtë drejtim duhet të evidentohen qëndrueshmëri e rregullave si dhe kuadri procedural duhet të lejojë që rregullat të zbatohen në mënyrë të efektshme, në rast të kundërt krijohen situata jo të qëndrueshme sikurse janë prezentë dhe në vendin tonë.

16 Në praktikën e KQZ-së vendimet kryesisht janë marrë me shumicë të thjeshtë.

17 Në pikën 89 të këtij Kodi përcaktohet se: Vëzhgimi ndërkombëtar është i nevojshëm në vendet që nuk kanë traditë të konsoliduar në kontrollin e paanshëm të ligjshmërisë së zgjedhjeve.

BIBLIOGRAFIA

Libra, artikuj, studime, botime;

- Aristoteli, Politika, Botim Elta BS & ARTINI, botim i parë, Prishtinë, 1978.
- Aleks Luarasi, Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, shtëpia botuese, Luarasi
- Aurela Anastasi, E drejta Kushtetuese, Shtëpia Botuese "Pegi", Tiranë, 2003.
- Aleksandër Kocani, Metodatat e kërkimit sasior në shkencat sociale, shtëpia botuese UFO Press, Tiranë, 2009.
- Baza Juridike e Gjykatës Kushtetuese, Botuar nga Delta Point Studio, Tiranë, 2009.
- Botim i Këshillit të Evropës, Të bëjmë që institucionet demokratike të funksionojnë.
- Diritto Regionale, Shtëpia Botuese "Dott. Antonio Milai", 2006.
- Diritto Costituzionale (settima edizione) riveduta e aggiornata, Temistocle Martinez, Shtëpia Botuese "Giuttre".
- Ermir Dobjani, E drejta Administrative1, Tiranë, 2004.
- Eqerem Yzeiri, Gjeografia politike, Shtëpia botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2005.
- Francis Fukuyama, Ndërtimi i shtetit, AiiS (Albanian Institute for international studies, Tiranë, 2010.
- Filip Rrumbullaku, Debat Parlamentar para një shekulli..., Horizont, Tiranë, 2008.
- Rex. E.Lee, Vështrime të një juristi për Kushtetutën, Shtëpia Botuese, "Nënë Tereza", Tiranë, 2000.
- Sokol Sadushi, Kontrolli Kushtetuese; Shtëpia Botuese, BOTIMPEX Tiranë, 2004.
- Kushtetuta e Shqipërisë me interpretime të Gjykatës Kushtetuese, Botim i Alb Juris, Tiranë, 2008.
- Krenar Loloci, Kushtetuta e re dhe nevoja për një mentalitet të ri, Shtëpia Botuese "Horizont" Tiranë 2009.
- Krenar Loloci, E drejta Kushtetuese, Shtëpia Botuese "DERADA", Tiranë, 1997.
- Kristaq Traja, Drejtësia Kushtetuese, Shtëpia Botuese "Luarasi, Tiranë, 2000.
- Lekë Sokoli, Metodatat e kërkimit në shkencat sociale, Instituti i Sociologjisë, 2009.
- Luan Omari, Parime dhe Institucione të së drejtës publike, Botimet "Elena Gjika", Tiranë, 2004
- Montesquieu, Mbi frymën e ligjeve, Shtëpia Botuese "Luarasi", Tiranë, 2000.

- Niazi Jaho, Reforma zgjedhore, përsëri me vonesë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë, 2006.
- Niazi Jaho, Gazeta Albania, Dialogu nuk duhet të zhbëjë transparencën, datë 21 Maj 2010.
- Niccolo Machiavelli, Princi, Politika dhe kodi moral, shtëpia botuese UEGEN, Tiranë, 2003.
- Pajtim Bello, KQZ dhe kriza pas zgjedhore, botuar 13 Maj 2011.
- Rexhep Meidani, Mbi Qeverisjen, Pjesa e parë, pjesa e dytë dhe pjesa e tretë, Botime "Dudaj", 2009.
- Rexhep Meidani, Kushtetuta, bilanci dhe perspektiva, shtëpia botuese "Toena", Tiranë, 2009.
- Rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, të datës 14 Shtator 2009.
- Revista "MAPO", Lorenc Vangjeli, KQZ, të hapen kutitë.
- Guido Fasso, Historia e filozofisë të së drejtës, Shtëpia Botuese "Luarasi", 2005.
- Ylli Bufi, Tempulli i demokracisë, shtëpia botuese, OMBRA GVG, Tiranë, 2010.
- Yasha Lange, Media dhe zgjedhjet, Këshilli i Evropës, 2003.
- Xhezair Zaganjori, Demokracia dhe shteti i së drejtës, Shtëpia Botuese "Luarasi", Tiranë, 2000.
- Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Eralda Çani, Shteti i së drejtës në Kushtetutën e republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2011.
- Zhan Zhak Ruso, Kontrata Sociale, Shtëpia Botuese "Luarasi" Tiranë.

Akte normative

1. Statuti i zgjeruar i Lushnjës.
2. Bibliografia e akteve ligjore, vëllimi i parë dhe i dytë, 1920-1944, Zana Bufi Tiranë, 2000.
3. Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, aprovuar nga Asambleja Kushtetuese më 14.03.1946 dhe shpallur nga presidiumi i Asamblesë Kushtetuese me dekret Nr. 24, datë 15.03 1946, gazetë zyrtare nr. 19/1946.
4. Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste e Shqipërisë, ligj nr. 55, datë 28.12.1976, gazetë zyrtare 5/1976.
5. Ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese".
6. Ligji nr. 7573, datë 16.06.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal".
7. Ligji nr. 7556, datë 20.01.1997 "Për zgjedhjet e kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë".
8. Kodi zgjedhor, i vitit 2000 me ndryshimet përkatëse.
9. Konventa evropiane e të drejtave të njeriut
10. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor, miratuar me referendum, shpallur me

dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998, ndryshuar në 2007, 2008, 2012, 2015, 2016.

11. Kodi i Praktikës së Mirë në çështjet zgjedhore, udhëzime dhe raporti shpjegues, miratuar nga Komisioni i Venecias, 18-19 Tetor 2002.
12. Ligji nr. 10 019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, botuar në fletore zyrtare nr. 189/2008.
13. Ligji nr.74/2012, datë 19.07.2012, lidhur me ndryshimin e ligjit 10019, datë 29.12.2008, Kodi zgjedhor.
14. Ligji nr.31/2015, datë 02.04.2015, lidhur me ndryshimin e ligjit 10019, datë 29.12.2008, Kodi zgjedhor.



Dr. MBA. MSc. Enriko CEKO
enrikoceko@yahoo.co.uk



Prof.As.Dr. Naim MËÇALLA



**RËNDËSIA E INFORMACIONIT
PËR MANAXHIMIN E CILËSISË**

**THE IMPORTANCE OF INFORMATION
FOR QUALITY MANAGEMENT**

Përmbledhje

Rëndësia e informacionit për shkencat e manaxhimit ka ardhur duke u rritur në mënyrë graduale që nga fillimet e kësaj disipline, duke vazhduar dhe u përhapur së bashku me rritjen e numrit të nëndarjeve të manaxhimit. Rëndësia e informacionit për sistemet e manaxhimit të cilësisë, kryesisht për Standardet ISO është vërejtur përgjithësisht në të kaluarën vetëm në termat e publikimeve akademike, kryesisht në ato çështje që lidhen me proceset statistikore për marrjen e vendimeve. Tashmë, standardet më të rëndësishme ISO janë duke u rishikuar dhe padyshim edhe standardi ISO 9001. Duke filluar që nga Janari i vitit 2016, Organizata Ndërkombëtare e Standardeve ka ofruar varintin ISO 9001 : 2015, që është një variant që do përdoret në praktikë nga fund i vitit 2016 dhe në të ardhmen. Në këtë version të ri ISO 9001 : 2015 informacioni është parë si një nga faktorët kryesorë të suksesit për subjektet publike dhe private që kërkojnë të gjejnë avantazhin konkurrues, duke marrë vendimet më të përshtatshme përgjatë rrugës dhe procesit të marrjes së vendimeve në organizatë dhe kjo kërkon një sistem të dokumentuar të detyrueshëm informacioni, që sjell sistem efikas dhe efektiv manaxhimi. Ky punim, në përputhje me zhvillimet e fundit në fushën e Standardeve ISO, sjell detaje për sistemin e dokumentuar të informacionit që kërkohet për aplikimin e këtyre standardeve.

Fjalë kyçe: Informacion, manaxhim cilësie, standardet ISO, etj.

Abstract

The importance of information in management science is increasing gradually since at the very beginning of this discipline, continuing and spreading gradually together with the number's increase of the management

branches. The importance of information on quality management systems, especially on ISO standards has been noticed generally on the past only in terms of scholar publications, mainly on those issues related to statistical processes for decision making. Currently, main of ISO standards are under the reviewing process, as well as the most important and the main ISO standard, ISO 9001. Starting from January 2016, International Standards Organization launched ISO 9001:2015 variant to be used and practiced by the end of the 2016 and on the future. In this new ISO 9001:2015 version, information has been seen as one of the main factors of success for public and private subjects looking for achieving competitive advantage, taking the right decisions on the way of organization's decision making process, asking for a mandatory documented information system, able for an effective and efficacy management system. As per current developments on the field of ISO standards, this paper aims to give details of documented information system required for those standards application.

Keywords: *Information, quality management, ISO standards, etc.*

1. Introduction

Management Science includes all aspects of management related to strategy, entrepreneurship, innovation, information technology, and organizations as well as all functional areas of business, such as accounting, finance, marketing, quality and operations. All of those specific disciplines of management science include studies on organizational, managerial, and individual decision making, from both normative and descriptive perspectives, are related and linked very strongly with the information and the quality of information.

In our days encouraging cross-functional and multidisciplinary solutions for our daily problems, the increasing demand for quality of information reflects the increasing demand for a wide diversity of the management science professions, quality management professionals included. Quality management is a specific area of management science which could be applied in diverse organizational forms,

such as for-profit and non profit firms, private and public sector institutions, etc. In all forms of the quality management applications, both empirical (field or lab) and theoretical contributions, requires high quality of information.

Some topics covered in Management Science demanding qualitative information	
1. Accounting	8. Judgment and Decision Making
2. Behavioural Economics	9. Marketing
3. Business Strategy	10. Operations Management
4. Decision Analysis	11. Optimization
5. Entrepreneurship and Innovation	12. Organizations
6. Finance	13. Stochastic Models and Simulation
7. Information Systems	14. Quality management

Management Science also strives to stimulate research in emerging domains created by economic globalization, public policy shifts, technological improvements, and trends in management practice, involving an increasing audience which includes academics at business and engineering schools and managers open to the application of quantitative methods in business, etc [1].

2. The importance of information on quality management systems

The importance of information on quality management systems, especially on ISO standards has been noticed generally on the past only in terms of scholar publications, mainly on those issues related to statistical processes for decision making, but currently it is becoming increasingly evident that information quality (IQ) is important and highly sought after not only for decision making but also for avoiding failure, reducing costs and gaining competitive advantage.

Professionals rely on information to successfully carry out their work and the quality of their information source impacts their decisions. Poor IQ costs the typical company from 10% to 20% of revenue. Wrong price data in retail databases may cost American consumers as much as \$2.5 billion in overcharges annually. Quality pioneer W. Edward Deming declared that Japanese firms regard their

employees as their most significant competitive asset and therefore provide them with good training in specific skills. The goal of IQM is to increase the value of high quality information assets.

Barriers to providing useful information for effective decision making are caused by IQ problems. On a daily basis the media reports on the impact of poor IQ in the healthcare sector. For example: Both of the Institute of Medicine (IOM) reports "To Err Is Human" and "Crossing the Quality Chasm" alerted health care professionals and managers to system defects and a redesign of the health care system, when they concluded that between 48,000 and 98,000 Americans die annually in hospitals as the result of medical errors. An understanding of the processes that generate, use, and store data are essential to understanding information quality.

The traditional approach to quality predominantly focuses on the technical aspects of quality paying little attention to the soft systems (human side). However, quality cannot be measured in purely technical terms by some characteristics of the product or service. The quality gurus reviewed in this study each offer definitions of quality but it is evident that there are substantial differences between them.

From the literature available a variety of approaches claim to provide solutions to the problems of poor quality. The interchange of the words data and information is widespread but there are some differences between the two. Data is normally described as raw facts used for analysis that has to be interpreted to derive meaning, and information described as data that has been processed in some way. We are interested for both, data and information [2].

	DEMING	JURAN	CROSBY	ISHIKAWA	FEIGENBAUM
METHODOLOGY	14 points	10 steps to quality control	14 steps for quality improvement	15 effects of Company - wide quality control	4 categories of quality costs
KEY CONCEPTS	PDCA cycle	Project management	0 defects – do it right first time	Cause and Effect	Total quality control
PHILOSOPHY	Customer focused	Management responsibility – quality costs	Cost of quality	Continuous improvement from management responsibility	Cost of Non conformance
QUALITY DEFINITIONS	Meeting customer needs	Fitness for use	conformance to requirement	Quality circles	Customer satisfaction
APPROACH	Use of data analysis tools such control charts	Trilogy (3 concepts) <ul style="list-style-type: none"> • Planning • Control • Action 	Company - wide		Systems management

Table 1. Key concepts of quality Gurus demanding information

3. Information and ISO 9001: 2015 standard requirements

Currently, main of ISO standards are under the reviewing process, the most important and the main ISO standard, ISO 9001 too. Starting from January 2016, International Standards Organization launched ISO 9001:2015 variant to be used and practiced by the end of the 2016 and on the future.

In this new ISO 9001:2015 version, information has been seen as one of the main factors of success for public and private subjects looking for achieving competitive advantage, taking the right decisions on the way of organization’s decision making process, asking for a mandatory documented information system, able for an effective and efficacy management system [3].

ISO 9001 : 2008	ISO 9001 : 2015
Products	Product s and Services
Exclusions	Non used
Documents, registers	Information documented
Working environment	Processes execution environment
Procurement products	Products and services supplied from outsiders
Suppliers	Outside suppliers

Table 2. Differences between ISO 9001: 2008 and ISO 9001:2015

The new version of ISO 9001 Standard, ISO 9001:2015 clearly defines the evidences required for an improving quality management system (clarifying the requirements for evidences as data and information required for the object of standard, for internal and external audit, etc in paragraph 3.8.1 and 3.8.2), as per below:

Evidences

3.8.1 data

- doing relations with an object (3.5.1)

3.8.2 information

- significant data (3.8.1)

3.5.1 object

- entity
- something perceptual and non perceptual

The new version of ISO 9001 Standard, ISO 9001:2015 clearly defines the role and importance of documented information at Chapter 7 SUPPORT, linking the issue of documented information (7.5) with competencies (7.2), knowledge (7.3) and communication (7.4), asking for creation and up-dating of documented information (7.5.2) and control of documented information (7.5.3) as per below:

7 SUPPORT

7.2 Competencies

7.3 Knowledge

7.4 Communication

7.5 Documented information

7.5.1 General

7.5.2 Creation and up-dating

7.5.3 Control of documented information

As per new version the organisation is free to choose the form of the information documented distribution, but stressing the importance of the system’s efficiency, confirming that the “information and data should be controlled and conserved”. In fact this concept has been called 42 times in the new version of the standard, together with the concept of “the aspects that the organisation should determine”, called 53 times at the version of the standard.

About the application scope of the organization (the scope of the certificate organization is asking to be certified), the new version of ISO 9001 standard require that “the application scope of the organization should be available and maintained like documented information, that declares types of the products and services offered, includes the justification for the eventual request which organization defines that are not applicable”.

About the quality policy of the organization, the new version of ISO 9001 Standard require that “The quality policy should be:

- a) available and maintained like documented information;
- b) communicated, compressed and applied in all the organization;
- c) available for all interested parties, in a suitable way.”

About issue of control of processes etc, the new version requires that “when the sample doesn’t exist, the base used for calibration and verification should be conserved like documented information.”

About the selling products and services the new version of ISO 9001 standard requires that “the organization should conserves the documented information that authorize selling of products and services to the client, including the criterions of acceptance and tracing of persons”, clarifying that “the organization should manage the non conform product in one of the ways of (1) correction, (2) segregation, restraint, restitution or suspension of product and service supply,

(3) information for the client, (4) obtaining authorizations for the acceptance under the concession. When the nonconformity product has been corrected, this should be verified for the conformity and requests".

About the knowledge, the new version of the ISO 9001 standard requires that "knowledge should be considered like a resource, (1) defining the necessary knowledge for the operations of quality management system and its processes, (2) knowledge should be maintained, protected and being available when is necessary, (3) foreseen the necessity for change of knowledge and the risk of non achieving the knowledge in a systematic and planned way."

4. An example from Albanian market

Currently several Albanian organizations have been involved on issues of ISO Standards certification, some of them looking to fulfil high international standards, achieving competitive advantage, cooperating with foreign organizations too. A typical example would be Albanian companies of wholesale and retail of hydrocarbons.

A typical wholesale and retail of hydrocarbons firm that has the fuel depots where store imported hydrocarbons and from where supply hydrocarbons to the retail pump stations has a fully controlled computerized system of information, as per the ISO 9001:2015 Standards requirements.

Concretely, below has been described the procedure of passing the product / service from the initial importer to the final client, respecting ISO 9001:2015 Standard requirements for documented information.

1. The company which supply fuel from other countries store the fuel from the large oil ship to the pipeline which links the link point from the 2000 m from the coastline to the large oil depots of the importing subject. All processes documented with the quantity of fuel, type of fuel, temperature, liquidity, other fuel specifications supplied, together with custom documents like

- bill of payment, VAT payment, duty tariffs, excise duties paid.
2. A computerized system working based in software called SAMPI (Terminal Automotion System), register all procedures of fuel import and quantity stored, together with all documents accompanying fuel.
 3. A CCTV camera system register 24/7 all the procedure.
 4. Fuel tankers of local subjects supplied with fuel and fulfil documents required for this procedure, quantity of fuel and price included at the VAT bill, accompanied with the certificate of origin and quality. Fuel tankers supply fuel at pump stations.
 5. Fuel stations sell fuel to clients, registering quantity, retail price, vehicle plate, etc, VAT included. Fuel stations have installed a computerised system (SAMPI) registering all procedures as well as a CCTV system registering everything 24/7.
 6. Data and information available has been compared for management purposes, as well as for internal and external audits, ISO Standards audits included, as well as for security and safety issues, in cooperation with public order authorities, whenever is needed.

As per procedure, everything is clear and transparent, helping continuous improvement and better internal decision making processes, available for external use too.

One of the possible external uses of this documented information is ISO certification. ISO certification companies audit several issues, management, resources, procedures, suppliers, clients, etc. For all of these audit issues, documented information is needed, especially the documented information related to the product and / or service [4].

As per the fuel market in Albania, the process of passing the product and / or service from the initial supplier to the final client, is controlled, monitored and fully documented from the initial import of fuel to the last bill issued to the final client, help for a better decision on ISO 9001:2015 certificate issuing, permit for a financial audit too [5].

This procedure is recommended whereas is possible to be applied for other types of products and services as per requirements of the ISO 9001:2015 Standard and for legal and other requirements of Albanian market too.

5. Conclusions

- Management Science which includes all aspects of management related to strategy, entrepreneurship, innovation, information technology, and organizations as well as all functional areas of business, such as accounting, finance, marketing, quality and operations, include studies on organizational, managerial, and individual decision making, from both normative and descriptive perspectives, are related and linked very strongly with the information and the quality of information.
- Quality management is a specific area of management science which could be applied in diverse organizational forms, such as for-profit and non profit firms, private and public sector institutions, etc. In all forms of the quality management applications, both empirical (field or lab) and theoretical contributions, requires high quality of information, ISO Standards included. Professionals rely on information to successfully carry out their work and the quality of their information source impacts their decisions. An understanding of the processes that generate, use, and store data are essential to understanding information quality.
- Currently, main of ISO standards are under the reviewing process, the most important and the main ISO standard, ISO 9001 too where information has been seen as one of the main factors of success for public and private subjects looking for achieving competitive advantage, taking the right decisions on the way of organization's decision making process, asking for a mandatory documented information system, able for an effective and efficacy management system, clearly defines the evidences

required for an improving quality management system (data and information).

- As per new version of ISO Standard, the organisation is free to choose the form of the information documented distribution, but stressing the importance of the system's efficiency, confirming that the "information and data should be controlled and conserved".
- About the selling products and services the new version of ISO 9001 standard requires that "the organization should conserves the documented information that authorize selling of products and services to the client, including the criterions of acceptance and tracing of persons", clarifying that "the organization should manage the non conform product in one of the ways of (1) correction, (2) segregation, restraint, restitution or suspension of product and service supply, (3) information for the client, (4) obtaining authorizations for the acceptance under the concession. When the nonconformity product has been corrected, this should be verified for the conformity and requests".
- About the knowledge, the new version of the ISO 9001 standard requires that "knowledge should be considered like a resource, (1) defining the necessary knowledge for the operations of quality management system and its processes, (2) knowledge should be maintained, protected and being available when is necessary, (3) foreseen the necessity for change of knowledge and the risk of non achieving the knowledge in a systematic and planned way."
- Currently several Albanian organizations have been involved on issues of ISO Standards certification, some of them looking to fulfil high international standards, achieving competitive advantage, cooperating with foreign organizations too, requiring and applying clear and transparent documented procedures for a better internal decision making processes, available for external

use too, an experience recommended whereas is possible to be applied as per requirements of the ISO 9001:2015 Standard and for legal and other requirements of Albanian market too.

References

- *Management Science. Introduction, Vol 62, Issue 5, May 2016, pp4.*
- *Mary Levis, Markus Helfert, Malcolm Brady, "Information quality management: review of an evolving research area", pp1 – 2, Proceedings of the 12th International Conference of Information Quality. 2009.*
- *International Standards Organisation. ISO 9001:2015.*
- *Ceko Enriko. Total Quality Management.*
- *[Ceko Enriko. Quality Management Tools.*



Dr. Mark NDRECA



**VËSHTRIM MBI MODELIN E
SUKSESSHËM TË USKOK-ut
NË KROACI DHE RASTI I
SHQIPËRISË.**

Abstrakt:

Vendet e ndryshme të Ballkanit Perëndimor kanë të profilizuara modele të veçanta institucionesh antikorrupsion dhe të angazhuara kundër krimit të organizuar. Modeli i suksesshëm kroat i Zyrës për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (USKOK), paraqitet me interes, pasi vlerësuar nga pikëpamja e rezultateve, kjo strukturë i ka kontribuar Kroacisë në afrimin e saj drejt BE-së.

Kuadri ligjor, ndërtimi i strukturave solidedhe përsosja e sistemit infrastrukturor, aplikimi i metodave pro-aktive të hetimit, qasja multidisiplinare gjatë përdorimit të teknikave të investigimit, bashkëpunimi i brendshëm ndërinstitucional dhe ai ndërkombëtar – shoqëruar me integritetin dhe përkushtimin profesional, kanë qenë principet themelore dhe garancat e suksesit të USKOK-ut.

Ndaj Shqipëria dhe vende të tjera të rajonit që e kanë prioritet integrimin evropian, e kanë të mundur përshtatjen e modeleve të tyre aktuale strukturore të angazhuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duke mbajtur si referencë: kornizën organizative, veprimtarinë ligjore, praktikat të mira dhe çdo element suksesi të USKOK-ut kroat.

Fjalët kyçe: *Korrupsion, Krim i organizuar,*

Hyrje

Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnjë e Hercegovina dhe Serbia - janë vende në përbërje të Ballkanit Perëndimor që kanë prioritet kryesor bashkimin me familjen e madhe evropiane. Sistematikisht këto shtete marrin këshilla dhe rekomandime nga BE-ja për ndërtimin e institucioneve të shtetit ligjor. Një nga rekomandimet më frekvente të adresuara nga zyrtaret e lartë evropianë, mbetet rritja e efikasitetit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndërsa këshilla e tyre është përfitimi i përvojave nga vendet dhe modelet e dëshmuara për sukses kundër këtij "virusi" shkatërrues të institucioneve demokratike.

Në rajonin tonë, Kroacia edhe pse në prag të hyrjes në BE është konsideruar si një nga vendet më të korrumpuara¹⁸, ajo përbën një model-suksesipasi ka shënuar progres të admirueshëm në luftën e saj kundër korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Cilat janë strukturat që ka ndërtuar dhe çfarë legjislacioni ka adoptuar shteti ballkanik? Cilat janë principet e funksionimit efikas të strukturave antikorrupsion dhe kundër krimit të organizuar? Çfarë rezultatesh janë shënuar?

A është e mundur që institucione, struktura dhe korniza ligjore të tilla të "modelohen" e funksionalizohen në vende si Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnjë e Hercegovina e Serbia? Këto janë këto disa prej pyetjeve "tunduese" që kërkojnë përgjigje.

Principet e veprimtarisë dhe tëorganizimit të Zyrës për Luftimin e Korrupsionit dhe të Krimit të Organizuar USKOK.

Në shkuarën e afërt, Kroacia është ndodhur përballë kushtëzimeve të forta për plotësimin e kritereve të anëtarësimit në BE-së për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit dhe të prezencës problematike të krimit të organizuar. Në këto kushte, vendi ballkanik është përfshirë për disa vite në ndërtimin e mekanizmave strukturorë dhe adoptimin e legjislacionit të brendshëm në funksion të efikasitetit të luftës kundër korrupsionit dhe krimin e organizuar. Kroacia arriti që ta shënojë fillimin e hopitcilësor në këtë aspekt, vetëm pas vitit 2001, me krijimin e **Zyrës për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (USKOK)**, pjesë e rëndësishme dhe e specializuar e Zyrës së Prokurorit të Shtetit¹⁹.

Krijimi i USKOK-ut u diktua për shkak se rrjeti ekzistues i prokurorëve të shtetit dhe kompetencat e tyre për t'u marrë me rastet e krimeve të korrupsionit dhe të veprave penale në fushën

18 "Anketa: Kroacia dhe Sllovenia më të korrumpuarat në BE", EU Observer, 8 maj, 2013,

19 Ngritja e USKOK është bërë pas miratimit të Ligjit për Zyrën për Luftimin e Korrupsionit dhe të Krimit të Organizuar. Ky Ligj hyri në fuqi më 19 tetor 2001, kurse Zyra e filloi punën me 3 dhjetor 2001.

e kimit të organizuar nuk kishin rezultuar efikase. Në këto rrethana, Qeveria kroate inicioi Ligjin për Zyrën për Luftimin e Korrupsionit dhe të Krimin të Organizuar, duke synuar ngritjen e një organi të specializuar për të bërë një prerje radikale në luftën kundër korrupsionit. Në të njëjtën kohë Qeveria kroate përmes këtij ligji synoi që në fillim, që të ndërtojë një organ efektiv dhe veprues në të gjithë vendin për ndjekjen e rasteve të kimit të organizuar dhe të aftë e bashkëpunues me organet e homologe nga vende të tjera, në luftën kundër kimit të organizuar ndërkombëtar.

Me krijimin e USKOK-ut Kroacia përbushi angazhimet e marra me ratifikimin Konventës Penale për Korrupsionin (GZ-IT 11/00) dhe Konventës Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar (GZ-IT 14/02 - 13/03) që, në bazë të Kushtetutës së Republikës Kroate, u bënë pjesë e sistemit të brendshëm juridik kroat.

Mbështetja politike e kufizuar dhe legjislationit problematik reflektuan një mandat fillestar të limituar dhe disa vështirësi në funksionimin e Zyrës për Luftimin e Korrupsionit dhe të Krimin të Organizuar. Por pas disa ndryshimeve të mëvonshme, kompetencat dhe autoriteti i kësaj Zyre u zgjerua dhe u efektivizuan veprimet në përbushjen e detyrave funksionale dhe të misionit specifik.

USKOK-u është përqendruar në zhvillimin e bashkëpunimit me agjencitë e tjera dhe përmirësimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet e zbatimit të ligjit dhe organizatat ndërkombëtare. Vëmendje e madhe i është kushtuar zhvillimit të hetimeve financiare me synim "ngrirjen" dhe konfiskimin e fitimeve të paligjshme.

Tashmë USKOK-u është profilizuar si një model i suksesshëm dhe ka rezultuar mekanizmi i duhur për të luftuar korrupsionin në nivele të larta. Ajo ka ndërtuar kapacitete dhe partneritet institucional brenda dhe jashtë Kroacisë duke u bërë ndër institucionet më të besuara. Struktura formale dhe kompetencat e USKOK-ut janë projektuar në mënyrë që ta bëjnë këtë institucion autoritet kryesor shtetëror në parandalimin dhe eliminimin e korrupsionit në Kroaci. USKOK-u ka dalluar për reputacionin e saj dhe veprimtarinë profesionale jashtë ndikimeve politike në

vend. USKOK-u dallon për strukturën e brendshme profesionale, solide dhe të mirëtrajnuar nëpërmjet asistencës së huaj.

Që në fillimet e aktivitetit USKOK ka spikatur **në trajtimin efektiv të rasteve të profilit të lartë në luftën kundër korrupsionit të funksionarëve shtetërorë**. I tillë nuk ishte vetë rasti i hetimit dhe dënimit të ish-Kryeministrit Ivo Sanader, por edhe i disa ish-zyrtarëve të tjerë. Kështu, gjatë veprimtarisë USKOK-u ka proceduar dy zëvendëskryeministra, më pas ministrin e Punëve të Brendshme dhe ministrin e Mbrojtjes. Është hetuar dhe arrestuar komandanti i Forcave Tokësore (*Gjeneral me tre yje*) për vepra penale korruptive. Gjithashtu janë proceduar për ndjekje penale persona që i përkasin agjencisë ushtarake të sigurisë, ose shërbimeve sekrete ushtarake, janë proceduar penalisht kryetarë bashkish, komunash dhe prefektë²⁰.

Në objektin e veprimtarisë së USKOK janë një numër i konsiderueshëm veprash penale të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, të cilat lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Disa prej tyre janë: ndjekja penale lidhur me abuzimet dhe ryshfjetin në procedurat e falimentimit; konkurrenca e padrejtë në operacionet e tregtisë së jashtme; shpërdorimi i detyrës publike; ndërmjetësimi paligjshëm dhe marrja e ryshfjetit; pranimi i ryshfjetit në disa prej transaksioneve ekonomike të cilësuar; keqpërdorimi i pozitës dhe kompetencave të kryera nga një zyrtar i caktuar; privimi i kundërligjshëm i lirisë; rrëmbimi me anë të forcës; trafikimi i qenieve njerëzore dhe skllavëria; grabitja; shantazhi; pastrimi i parave; kryerja e pagesave të paligjshme kur akte të tilla kriminale janë kryer nga një grup ose një organizatë kriminale; trafiku i drogës; vepra penale lidhur me zbulimin e identitetit të dëshmitarit të mbrojtur; pastrimi i parave duke iu shmangur taksave apo detyrimeve doganore²¹, etj.

Në kuadër të hetimeve, mesatarisht çdo vit USKOK kalon rreth 6500-7000 individë. Në sajë të hetimeve të kryera nga USKOK,

20 "Cvitan rrëfen si arrestoi Sanaderin dhe një këshillë për prokurorët shqiptar", gazeta Dita", Tiranë 26 mars 2015.

21 Për më tepër në lidhje me USKOK shiko: <http://www.dorh.hr/Default.aspx?sec=53>

gjykatat kroate sistematikisht konfiskojnë pasuritë e fituara përmes e krimit të organizuar, që për nga vlera e tyre e kalojnë 3- 6 herë buxhetin vjetor të akorduar nga shteti për veprimtarinë e USKOK-ut²².

Në sajë të aktivitetit të USKOK-ut,nga viti 2006 deri në vitin 2012 janë ndjekur penalisht e dënuar 2,185 individë²³.Në këtë kontekst, USKOK-u deri në vitin 2012 ka arritur me sukses një normë dënimi që tejkalon 95% të rasteve për të cilët ajo ka filluar ndjekjen penale²⁴.

Megjithatë kthesa domethënëse në veprimtarinë e USKOK është shënuar pas disa ngjarjeve të ndodhura në vitin 2008 në Kroaci²⁵.

Cilat janë principet bazë që kanë përcaktuar suksesin e USKOK-ut në veprimtarinë e saj?

22 "Cvitan rrëfen si arrestoi Sanaderin dhe një këshillë për prokurorët shqiptar", gazeta Dita", Tiranë 26 mars 2015.

23 Studimi i rastit, Pastrimi i Shtëpisë: Kroacia Fshin Nivelin e Lartë të Korrupsionit, 2005-2012 , Gabriel Kuris në,
http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy_note/PN_id226/Policy_Note_ID226.pdf

24 Po aty.

25 Fushata reaguese ndaj krimit të organizuar në Kroaci u bë shumë ndëshkuese pas disa ngjarjeve tronditëse të vitit 2008 në Kroaci. Kështu, vajza e një avokati të njohur, u qëllua jashtë apartamentit të saj në tetor 2008. Në të njëjtin muaj, një makinë bombë vrau Ivo Pukanic, gazetar i "Nacional", një revistë javore, që shpesh mbulonte krimin e organizuar. Ky shpërthim i ndodhur në Zagreb, vrau gjithashtu një menaxher të kësaj reviste. Kjo situatë rigjallëroi shqetësimet në Bruksel për gatishmërinë e Kroacisë për t'iu bashkuar BE. Në përballje me rritjen e presionit për të kapur kriminelët profesionistë, shumë shpejt u arrestuan të dyshuarit për të dy rastet. Hetimet janë kryer nga USKOK.

- Së pari:

Kuadri ligjor i rishikuar dhe struktura solide.

Puna e USKOK-ut në fillimet e vitit 2002, ka qenë tepër e vështirë dhe e pasuksesshme. Kjo kryesisht për shkak të bazës ligjore dhe mungesës së kapaciteteve profesionale që lidhej me interesin e ulët të ekspertëve të kontabilitet, kriminologjisë, tatimeve, etj. për të qenë pjesë e USKOK-ut. Arsyeja: mostrajtimi i duhur financiar dhe skepticizmi për statusin e tyre ligjor gjatë ushtrimit të veprimtarisë profesionale. Ndryshimet erdhën më vonë, ku përmes mbështetjes vendimtare politike USKOK-ut iu dhanë fuqi të reja ligjore dhe drejtues të rinj. Një nga drejtuesit e USKOK-ut, duke vlerësuar këtë rrethanë është shprehur se:

"USKOK-u nisi punën e tij në vitin 2002, me një kuadër ligjor shumë të keq. Më qartë, nuk mund të veproje e të bëje asgjë në bazë të atij që ishte. Erdhi momenti i ndryshimit të këtij kuadri ligjor, duke u futur hetimi i prokurorisë e që atëherë, prokurorët u kthyen, siç themi ne "dominus litis", u kthyen në zotër të procedurës penale"²⁶.

Kështu kuadri ligjor i përmirësuar ka ndikuar pozitivisht në bërjen me efektive të USKOK-ut. Rishikimet ligjore e fuqizuan USKOK-un në dy drejtime, në kompetenca ligjore për përmbushjen e misionit kushtetues, si dhe në ndërtimin e strukturës së vet solide dhe me kapacitetet e duhura për të përballuar sfidat lidhur me goditjen e korrupsionit dhe të krimit të organizuar. Rritja e konsiderueshme e trajtimit financiar ishte një element i rëndësishëm që ndikoi dukshëm në rritjen cilësore të performancës së USKOK-ut.

Një trend pozitiv i praktikuar nga USKOK janë investimet e vazhdueshme në ndërtimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve të cilëve iu janë ofruar programe trajnimi brenda dhe jashtë Kroacisë²⁷.

Dhe kur është fjala për kapacitetet e USKOK-ut, korniza ligjore e përshkruan strukturën e këtij organi qartë. Nga pikëpamja strukturore, USKOK-u është në varësi të Prokurorit të Shtetit

26 "Cvitan rrëfen si arrestoi Sanaderin dhe një këshillë për prokurorët shqiptar", gazeta Dita", Tiranë 26 mars 2015.

27 Për më tepër në lidhje me USKOK shiko: <http://www.dorh.hr/Default.aspx?sec=53>

në Kroaci. Ajo ka në përbërje një forcë të policisë gjyqësore. Kjo ka bërë që kjo strukturë të fitojë kapacitete operative të afta nga pikëpamja profesionale dhe me cilësi të spikatura ndërvepruese, duke zotëruar metodat më moderne të hetimeve në lidhje me korrupsionin.

Drejtuesi i USKOK-ut, i ofron raporte mujore të rregullta Prokurorit të Shtetit. Ai dhe Zëvendësi i tij vijnë nga radhët e Prokurorëve Publikë. Drejtuesi i USKOK-ut emërohet me një mandat 4 vjeçar nga Prokurori i Shtetit pasi ai ka marrë më parë mendimin paraprak të Ministrit të Drejtësisë dhe mendimet e anëtarëve të Kolegjit Prokurorial.

Për shkak të kompleksitetit të punës së tyre, përpara emërimit, Drejtuesi USKOK-ut dhe të gjithë të punësuarit e tjerë janë subjekt i verifikimeve të sigurisë dhe të kontrolleve financiare nga strukturat e shtetërore të përcaktuara me ligj.

USKOK është i autorizuar më tej për të kryer të gjitha hetimet penale dhe në kuptimin praktik, prokurorët e USKOK-ut kërkojnë informacione direkte nga ministritë e tjera sidomos nga departamentet të kontrollit të brendshëm të institucioneve shtetërore. Komunikimi bëhet në formë të shkruar përveç rasteve të koordinimit direkt në baza të rregullta me policinë e zbulimit të krimit dhe me administratën tatimore.

Të gjitha këto organe janë përgjegjëse të ofrojnë direkt dhe të plotësojnë kërkesat e prokurorëve të USKOK-ut për informacion. Kjo përmendet qartë në ligjin mbi USKOK-un që këto institucione duhet të ofrojnë asistencë dhe të japin të dhëna direkt kësaj strukture. Nëse informacioni i kërkuar nga institucionet vonohet atëherë kjo konsiderohet një shkelje e rëndë e punës ose e detyrave zyrtare²⁸.

Strukturaaktuale e USKOK-ut,përbëhet nga:

1. Departamenti i Hulumtimeve dhe Dokumentacionit,

28 Për më tepër: <http://www.oecd.org/corruption/acn/aboutthenetwork/37330595.pdf>.

Rrjeti Kundër Korrupsionit për Ekonomitë në Tranzicion, Mbledhja e Përgjithshme e 6-të, 30-31 maj 2005.

2. Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit dhe Marrëdhënie me Publikun,
3. Departamenti i Prokurorëve,
4. Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Hetime të Përbashkëta,
5. Departamenti për Hetimin e Pasurisë së Fituar me anë të Krimin.
6. Sekretariati
7. Shërbimet Ndihmëse.

Gjithashtu USKOK-u ka në strukturë edhe tre departamente në Split, Rjeka dhe Osjek²⁹.

Në vitin 2010 struktura e USKOK-u është bërë më funksionale me miratimin e strukturës së Policisë Speciale të USKOK, krahas strukturave të tjera ekzistuese të policisë së shtetit. Kjo Polici Speciale e njohur me shkurtime PUSKOK, është përfshirë në kuadër të veprimeve të ndryshme hetimore për llogari të detyrave dhe misionit ligjor të USKOK.

Nga ana tjetër, Departamenti për Hetimin e Pasurisë së Fituar me anë të Krimin, është pjesa më e re e strukturës qendrore të USKOK-ut. Krijimi i kësaj njësie është diktuar nga nevojat e zhvillimit të hetimeve financiare me synim "ngrirjen" dhe konfiskimin e fitimeve të paligjshme në kuadrin e goditjes dhe të parandalimit sa më efektiv të korrupsionit dhe të krimin të organizuar.

Përveç prokurorëve të specializuar, në Kroaci ka gjyqtarë të specializuar penal që janë të vendosur në gjykatat më të mëdha të qarqeve të vendit, të cilët janë përgjegjës për gjykimin e rasteve të korrupsionit dhe të krimin të organizuar. Këto raste marrin prioritet të lartë në sistemin e drejtësisë kroate.

29 Për më tepër në lidhje me USKOK shiko: <http://www.dorh.hr/Default.aspx?sec=53>

- Së dyti:

Aplikimi i metodave pro-aktive të hetimit.

Për arritjen e rezultateve të mira në zbulimin, ndjekjen dhe vënien përpara ligjit të subjekteve të krimeve brenda juridiksionit të saj, USKOK-u është fokusuar në bashkëpunimin e ngushte me qytetarët dhe në rritjen e besimit të ndërsjellët.

Sipas ish- drejtuesit të USKOK, Cvitan, kjo do të thotë se prokurori nuk pret të reagojë atëherë kur dikush bën kallëzim, por që në zërin e parë që dëgjon, sapo mëson diçka, reagon dhe merr masat duke kryer verifikimet, duke dhënë urdhra të qarta e të duhura edhe policisë, edhe organeve të tjera shtetërore kompetente, menjëherë dhe pa prituri indicie të tjera³⁰.

Nga ekspertë të huaj është nënvizuar fakti se media kroate ka patur një ndikim pozitiv në ofrimin e fakteve lidhur me ekzistencën e korrupsionit dhe të krimit të organizuar. Madje, shpesh, zbulimet gazetareske kanë shërbyer si nxitje për hapjen e çështjeve të ndryshme. Kjo është arritur duke vendosur një raport të drejtë me botën e medias dhe në veçanti me atë investigative. Përmes kontakteve të organizuara me gazetarët është synuar që ata të ishin të informuar drejt për misionin, detyrat dhe format e punës së USKOK-ut.

Nga ana tjetër ka rezultuar pozitive edhe pjesëmarrja e prokurorëve në trajnimet për media në funksion të përmirësimit të aftësive të tyre për t'iu përgjigjur pyetjeve gazetareske pa e rrezikuar rastet konkrete në hetim. Ngjashmërisht është vepruar edhe me OJQ-të. Kështu, marrëdhëniet e ngushta me mediat dhe shoqërinë civile janë konceptuar në funksion të forcimit të besimit publik. Kjo sepse mediat dhe shoqëria civile janë konceptuar si partnere të rëndësishme në reformimin e shëndoshë të opinionin publik dhe në rritjen e sensibiliteve publike për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

30 "Cvitan rrëfen si arrestoi Sanaderin dhe një këshillë për prokurorët shqiptar", gazeta Dita", Tiranë 26 mars 2015.

- Së treti:

Qasje multidisiplinarenë aplikimin e teknikave të investigimit.

Çështjet që lidhen me hetimin e korrupsionit të zyrtarëve dhe të krimit të organizuar janë të komplikuar. Zgjidhja me sukses e të panjohurave gjatë hetimit kërkon jo vetëm njohuri të spikatura juridike-profesionale, por edhe nga fusha të tjera, si financa, ndërtimi, informatika etj. Një nga ish - drejtuesit e USKOK-ut, ka nënvizuar se:

“...ne kemi punuar me një qëllim të caktuar për të goditur vatrat e korrupsionit dhe kemi pasur aksione të mirëcaktuara kundër korrupsionit në ndërtim, shpërdorim detyre, në dhënien e lejeve të ndërtimit ku janë tjetërsuar territoret dhe ka ardhur deri në rritjen e vlerës së tokës. Gjithashtu aksionet tona kanë qenë drejtuar kundër korrupsionit në universitete. Këto janë aksionet e njohura siç është INDEX, ku janë arrestuar për një ditë 105 persona, ku janë proceduar shumë profesorë në Zagreb pastaj në Osjek, më pas në Split dhe përsëri në Zagreb në Fakultetin e Mjekësisë”³¹.

Angazhimi i kombinuar i niveleve të ekspertizës multidisiplinare, i shoqëruar me një buxhetim të mjaftueshëm financiar, janë një princip tjetër i rëndësishëm që i ka kontribuar suksesit kroat.

Përvoja e USKOK-ut nxjerr në evidencë edhe një element tjetër të rëndësishëm, ku qasja multidisiplinare është thelbësore: Korrupsionin e lidhur me Prokurimet publike. Kështu, sipas të dhënave të Bankës Botërore, korrupsioni shpesh i lidhur me prokurimet publike, i kushton vendit prej 5,4 milionë banorësh rreth 1,2 miliardë dollarë në vit ose rreth 2 për qind të prodhimit të brendshëm bruto³². Hetimet dhe çuarja me prova përpara gjykatave e funksionarëve të përfshirë në këto veprimtari antiligjore kërkon jo vetëm një nivel njohurish

31 Po aty. “Cvitan rrëfen si arrestoi Sanaderin dhe një këshillë për prokurorët shqiptar”, gazeta Dita”, Tiranë 26 mars 2015.

32 Neil Macdonald dhe Stefan Wagstyl, “Financial Times”, 15 Jan. 2010.

teoriko-praktike për aspektet juridike, financiare, bankare, por edhe njohuri të veçanta tekniko inxhinierike, sipas specifikimeve të objektit të prokurimit publik, të dyshuar për abuzime.

Nga ana tjetër, mjaft të komplikuar janë hetimet lidhur me individualizimin e pasurive dhe të kapitaleve me origjinë kriminale. Mënyrat e qarkullimit dhe të transferimit të këtyre vlerave financiare dhe identifikimi i destinacioneve reale të adresimit të tyre, paraqiten "ekuacione me shumë të panjohura" dhe zgjidhja e tyre kërkon qasje dhe cilësi në nivelin e njohurive dhe të aftësive multidisiplinare të specialisteve dhe strukturave në USKOK. Për më tepër, që rezultatet pozitive në hetimin e rasteve të tilla kanë mundësuar marrjen e vendimeve të ligjshme nga gjykatat kompetente për konfiskimin e këtyre të ardhurave financiare, në çfarëdo vendi që ato kanë qenë të fshehura apo të depozituara.

- Së katërti:

Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi i brendshëm ndërinstitucional.

Koordinimi dhe bashkëpunimi i USKOK-ut me institucionet e tjera është një element shumë i rëndësishëm dhe i dëshmuar për sukses. USKOK-ut ofron struktura të qarta të raportimit përmes miratimit të përbashkët të memorandumevetë mirëkuptimit me ministritë dhe agjencitë relevante për të krijuar mënyra të kontrolluara për qasje në bazat e të dhënave të tyre. Kjo i ka mundësuar USKOK-ut të ushtrojë fuqitë e veçanta të kontrollit të të dhënave financiare pa shkelur privatësinë e qytetarëve.

Në këtë kuadër, sipas Civitan, janë nënshkruar marrëveshje ndërmjet USKOK, prokurorisë dhe institucioneve të tjera relevante. Janë vendosur pikat e kontaktit, pra personat dhe kur nis një aksion, atëherë saktësisht dihet kush, çfarë bën, ku shkon, kush jep urdhër etj. Pra, dihet me saktësi se e kujt është përgjegjësia dhe në rast moszbatimi dihet se cilat janë konsekuencat e këtyre veprimeve. Këtu është e domosdoshme të përfshihen edhe organizma apo agjenci të tjera. Kështu, që nga viti 2006, USKOK-u ka në ambientet e punës

së tij, qasje në bazën e të dhënave të administratës tatimore dhe që nga viti 2007, USKOK ka qasje në bazën e të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme³³.

Nga ana tjetër, është perfeksionuar bashkëpunimi dhe koordinimi mes USKOK-ut , gjykatave dhe policisë gjithashtu duke qartësuar strukturën e këtij bashkëpunimi. Prokurorët e USKOK-ut spikasin për fuqinë e tyre përfshirë këtu edhe autoritetin për të përdorur metodat speciale të hetimit, si infiltrim të fshehtë, operacione goditëse (kapjen e personit duke kryer veprën penale), dhe mbikëqyrjes së mjeteve të telekomunikacionit. Për më tepër, numri i krimeve me të cilët USKOK-u mund të merrej u rrit dhe organet tjera ishin të detyruar të ndihmojnë USKOK-un në hetimet e saj³⁴.Për shembull USKOK-ut i lejohet të inspektojë të dhënat financiare personale dhe operacionet e biznesit dhe të "ngrijë" asetet pas miratimit gjyqësor³⁵.

- Së pesti:

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar është një nga principet thelbësore që ka garantuar suksesin.Për më tepër që gjatë hetimit të krimeve me natyrë financiare është thelbësore *ndjekja e rrugës së parasë*. Pa këtë element, do të kishte rezultuar e pamundur që të ndiqen gjurmët e krimit dhe të parave publike të përvetësuara në Kroaci. Lidhur me këtë çështje, Civitan ka nënvizuar:

“Rëndësi ka që paraja e vjedhur të kthehet mbrapsht. Sepse, nëse korrupsionin apo krimin e organizuar e godisni në xhep, kur i merrni paratë, aty i dhemb më shumë, dhe pa para nuk kanë më atë fuqi dhe ndihen të marginalizuar. Në këtë mënyrë bëhen me të parrezikshëm e të parëndësishëm”.³⁶

33 “Cvitan rrëfen si arrestoi Sanaderin dhe një këshillë për prokurorët shqiptar”, gazeta Dita”, Tiranë 26 mars 2015.

34 “Lufta kundër korrupsionit: Analizë krahasuese mes Kosovës dhe Kroacisë”, KIPRED, Analizë e Politikave Nr. 1/14, Shkurt 2014.

35 Po aty.

36 “Cvitan rrëfen si arrestoi Sanaderin dhe një këshillë për prokurorët shqiptar”, gazeta Dita”, Tiranë 26 mars 2015.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është realizuar bazuar në marrëveshje bilaterale dypalëshe, në bazë të të cilave USKOK-u ka patur mundësinë që të shkëmbeje informacione të ndryshme me strukturat homologe. Në kuadër të këtij bashkëpunimi USKOK-u ka përfituar edhe nga ndihma juridike ndërkombëtare për të poseduar dëshmi apo fakte për çështje të caktuara në hetim.

3. Rasti i Shqipërisë

Pas viteve 90' brenda një periudhe të shkurtër kohe, Shqipëria filloj të shënohej në raportet e institucioneve ndërkombëtare, si një vend, burim i një kriminaliteti të lartë. Gradualisht grupet kriminale shqiptare me kalimin e viteve u bënë konkurrentë të grupeve të kriminale të disa vendeve të BE-së për trafikun e drogës, trafikun e qenieve njerëzore dhe sidomos për trafikimin e femrave për shfrytëzimprostitucioni; kontrabandës, si dhe veprave të tjera penale të lidhura me trafikete paligjshme.

Në vitet 1990-97, vendi ynë dalloj për shfaqjen e strukturave kriminale hierarkike në formën e bandave të armatosura, organizatave kriminale dhe grupeve të strukturuar kriminale. Kurse gjatë viteve 1998-2004, bashkë me mënyrën e organizimit të tyre, u zhvillua dhe u zgjerua sfera e veprimtarive të këtyre strukturave kriminale. Trafikimi i drogës dhe armëve lulëzuan dhe u shndërruan në veprimtaritë parësore fitimprurëse për këto organizime kriminale. Rreth fundit të viteve 2004-2005, fillojnë dhe shfaqen forma të reja organizimesh kriminale dhe perfeksionohet ndërveprueshmëria e tyre.³⁷ Grupet kriminale u shfaqen më komplekse dhe më të mirë-organizuar për arritjen e objektivave të tyre kriminale.

Në Shqipëri, një komponent i rëndësishëm i krimit të organizuar është evidentuar edhe *krimi kibernetik në formë të organizuar*. Duhet

37 Për më tepër shiko: "Strategjia Ndërsektorale e Luftës Kundër Krimit të Organizuar Trafikeve dhe Terrorizmit", miratuar me Vendimin Nr. 1140, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale e Luftës Kundër Krimit të Organizuar Trafikeve dhe Terrorizmit".

cilësuar se vendi ynë ka qenë objekt i krimeve kibernetike jo vetëm nga grupe kriminale vendase, por edhe nga grupe kriminale të huaja, me origjinë nga shtete fqinje si Italia, Mali i Zi dhe Bullgaria, apo edhe vende të tjera.

Pavarësisht shfaqjes së vonë të tij, për vetë natyrën dhe veçoritë që ka, krimi i organizuar kibernetik³⁸ paraqitet e orientuar drejt sofistikimit të mëtejshëm të tij. Kjo e bën më të vështirë investigimin, goditjen dhe parandalimin e tij. Në një dokument të Komisionit Evropian për Shqipërinë, nënvizohet se "*numri i procedimeve penale lidhur me krimin kibernetik është rritur gjatë vitit 2012, por është ende i ulët*"³⁹.

Faktorët që kanë ndikuar në favorizimin e trendëve të korrupsionit dhe të kriminalitetit të organizuar, janë *faktorë politikë, socialë, teknologjikë, mjedisor, ligjorë dhe organizativë*.

Përballë realiteteve kriminale, vendi ynë ka ngritur institucionet specializuara të reagimit kundër krimit të organizuar e korrupsionit si dhe ka adoptuar legjislacionin përkatës. Ky reagimi ndaj prezencës kriminale me tendencë të qarta përshkallëzuese ka rezultuar i pamjaftueshëm. Kjo edhe për shkak të prezencës së lartë të korrupsionit në strukturat e rendit, drejtësisë, administratës publike, doganave e më gjerë.

Me kalimin e viteve dhe me mbështetjen e presionin e organizmave ndërkombëtarë, vendi ynë arriti të ndërmarre disa hapa institucionale në luftën kundër formave të shfaqjes së krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilat kanë shënuar impakte pozitive⁴⁰, por janë larg

38 Format e para të organizuara, që janë proceduar nga policia e shtetit, datojnë në vitin 2008. Nuk ka të dhëna, nëse kanë ekzistuar edhe më parë rrjete kriminale në fushën e krimit kompjuterik.

39 Komisioni Evropian "Raport Progresi 2013, Shqipëria", fq.49.

40 Në kuadrin institucional e strukturor, në vitin 2007, krijohet Njësia e Përbashkët Hetimore në përbërje të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me përbërje prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore si dhe staf të specializuar të Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe inspektorë të Shërbimit Informativ Shtetëror. Njësia e Përbashkët Hetimore do të koordinonte hetimin e veprave penale të krimit ekonomik. Ndërsa në vitin 2009 u nënshkrua një Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet gjashtë institucioneve:

së krahasueshmes me arritjet e shënuara nga përvoja kroate, apo me pritshmëritë që kanë ndaj Shqipërisë BE dhe SHBA.

Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri janë shënuar disa ndryshime ligjore e institucionale të rëndësishme në kuadrin e aktivitetit të strukturave të angazhuara kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Janë forcuar kapacitetet profesionale dhe bashkëpunimi ndër-institucional dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Por ka edhe një problematikë komplekse ku spikasin disa elementë:

Së pari:

Ajo që vihet re në kuadrin institucional është fakti se reformat e ndërmarra në kuadrin e institucioneve që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit kanë qenë të pjesshme dhe jo gjithëpërfshirëse. Nga ana tjetër, bashkëpunimi ndër-institucional midis agjencive dhe ndarja e informacioneve sensitive apo qasja në *data bazat* e rekordeve kriminale, si dhe veprimet e përbashkëta e të koordinuara ndaj subjekteve të involvuar në veprimtari të krimit të organizuar e korrupsion, kanë qenë e "tkurrura".

Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurisë dhe Shërbimi Informativ Shtetëror. Ky Memorandum u shoqërua me krijimin e Njësive të Përbashkëta Hetimore në Prokuroritë e Rretheve Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Korçë dhe më pas në Elbasan.

Në kuadrin ligjor, një zhvillim i rëndësishëm është shënuar në vitin 2014, me transferimin e juridiksionit për katër vepra penale të korrupsionit nga Njësitet e Përbashkëta Hetimore në Gjykatën e Krimeve të Rënda bazuar në ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale me Ligjin 21/2014. Në vijim të këtyre ndryshimeve, u krijua pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda seksioni i Hetimit të korrupsionit dhe pasurive. Po këtë vit, në Prokurorinë e Përgjithshme, u ngrit Drejtoria e Kontrollit të Hetimit të Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit (Task-Forcë) për kontrollin e hetimit të korrupsionit, krimit ekonomik dhe hetimit pasuror, në përbërje të të cilit funksionon edhe Sektori i Hetimit të krimit kibernetik. Nga viti 2014 në kompetencën e Prokurorisë për Krime të Rënda janë edhe veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të zyrtarëve të lartë, përfaqësuesve të zgjedhur vendorë, gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë. Gjithashtu, në kompetencë të kësaj Prokurorie është edhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit përmes konfiskimit të pasurisë së personave të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik si rezultat i pjesëmarrjes në veprimtari të dyshuar kriminale (në krimin e organizuar, trafikje dhe korrupsion. Ndryshime të rëndësishme ka patur edhe në aktivitetin e Gjykatave.

Së dyti:

Mendojmë se kapacitetet profesionale në investigimin dhe hetimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit kanë qenë të limituara në aspektin numerik dhe me "defekte" në cilësinë e formimit të profilizuar për aspektet e krimit kibernetik apo të disa veprave me profil financiar.

Së treti:

Infrastruktura logjistike, motivimi individual dhe mbështetja e duhur ligjore, ekonomike, politike dhe financiare e kombinuar me verifikimin sistematik të profilit të sigurisë dhe të besueshmërisë të individëve që punojnë pranë këtyre institucioneve institucioneve – jo në çdo rast ka qenë në nivelin e duhur.

Në këto kushte lind pyetja:

A do t'i zgjidhë dhe garantojë këto elemente reforma e sapo-nisur në drejtësi dhe në strukturat e tjera që do të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri?

Megjithëse kjo mbetet për t'u verifikuar, përvoja e vendeve të tjera dhe mbi gjithçka principet e organizimit dhe të veprimtarisë, korniza ligjore dhe statuta e USKOK-ut në Kroaci, na bëjnë të besojmë se ekzistojnë modele suksesi të cilave ne duhet t'i referohemi, në kuadrin e ndërtimit të institucioneve të besueshme të shtetit ligjor.

Burimet:

- "Anketa: Kroacia dhe Sllovenia më të korruptuarat në BE", EU Observer, 8 maj, 2013,
- "Cvitan rrëfen si arrestoi Sanaderin dhe një këshillë për prokurorët shqiptar", gazeta Dita", Tiranë 26 mars 2015.
- <http://www.dorh.hr>
- http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy_note/PN_id226/Policy_Note_ID226.pdf (Studimi i rastit, Pastrimi i Shtëpisë: Kroacia Fshin Nivelin e Lartë të Korrupsionit, 2005-2012, Gabriel Kuris)
- "Lufta kundër korrupsionit: Analizë krahasuese mes Kosovës dhe Kroacisë", KIPRED, Analizë e Politikave Nr. 1/14, Shkurt 2014.
- Komisioni Evropian "Raport Progresi 2013, Shqipëria".
- <http://www.oecd.org/corruption/acn/aboutthenetëork/37330595.pdf>. Rrjeti Kundër Korrupsionit për Ekonomitë në Tranzicion, Mbledhja e Përgjithshme e 6-të, 30-31 maj 2005.
- Neil Macdonald dhe Stefan Wagstyl, "Financial Times", 15 Jan. 2010
- "Strategjia Ndërsektorale e Luftës Kundër Krimit të Organizuar Trafikeve dhe Terrorizmit", miratuar me Vendimin Nr. 1140, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale e Luftës Kundër Krimit të Organizuar Trafikeve dhe Terrorizmit".
- Ligji Nr. 9110, dt.24.07.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda".

Raport i Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri gjatë vitit 2015, publikuar në Mars 2016.

MSc. Arben IBRO

MSc. Fran KAÇORRI

MSc. Bora SELMANI
Akademia e Sigurisë



**DHUNA NË FAMILJE,
ROLI I LEGJISLACIONIT DHE I POLICISË
SË SHTETIT NË
PARANDALIMIN DHE REDUKTIMIN E
SAJ NË VITIN 2015.**

(koncepte, analiza dhe rekomandime)

Hyrje

1. Kuptimi mbi dhunën në familje, shkaqet, karakteristikat dhe pasojat e saj
2. Roli i legjislacionit dhe i Policisë së Shtetit në parandalimin e dhunës në familje.

Dhuna në familje, dhe kryesisht ndaj grave nuk është dukuri e re në Shqipëri. Ajo i ka rrënjët thellë në traditat dhe zakonet patriarkale, të cilat prej kohësh e kanë dominuar dhe i kanë dhënë formë shoqërisë shqiptare, sidomos në zonat rurale. Mbi dyzet vjet të regjimit komunist në Shqipëri, edhe pse u bë punë e madhe lidhur me barazinë midis burrit dhe gruas, nuk i zhduku qëndrimet patriarkale të rrënjosura thellë, ndër të cilat edhe ato që lidhen me Kanunin e Lek Dukagjinit, që aplikohesh në disa zona të Shqipërisë. Lind pyetja: A ka patur dhunë në familje gjatë kohës së regjimit komunist? Sigurisht që ka patur, edhe pse jo në përmasat e sotme, por ato nuk kanë "dalë jashtë familjes", nuk janë botuar në shtypin e shkruar e nuk janë pasqyruar nga media siç ndodh sot. Ka patur sepse, një sërë shkaqesh të dhunës në familje që evidentohen sot, kanë ekzistuar edhe atëhere.

Dhuna në familje u shfaq vërtet dhe hapur si problem shqetësues në Shqipëri në vitet '90, në periudhën e tranzicionit, kur vendi po përjetonte ndryshime të mëdha politike, ekonomike e shoqërore. Rastet e dhunës në familje pësuan rritje të ndjeshme në vitet '90, ndërkohë që familjet shqiptare po përjetonin shumë stresa dhe trysni si pasojë e tranzicionit, të cilat shfaqeshin në nivelet e larta të papunësisë (duke ndikuar dukshëm në rënien e gjendjes ekonomike të familjes, në shfaqjen e konflikteve, të dhunës dhe të divorceve), në mungesat e mëdha në strehimit (jetonin 2-3 kurora në një banesë ,gjë që bëhej shkak për konflikte brenda familjes), u shtuan trazirat shoqërore dhe krimet e dhunshme në rrugë, etj, të cilat e tronditën shumë edhe familjen shqiptare, si qeliza bazë e shoqërisë.

Në kushtet e një situatë të tillë, që nga viti 1991 e në vazhdim, qeveritë shqiptare kanë ratifikuar një numër të madh konventash të OKB-së, si për të Drejtat Civile dhe Politike, për të Drejtat Ekonomike,

Sociale dhe Kulturore, për të Drejtat e Fëmijëve, kundër torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve të tjera mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave si dhe konventat europiane, si; për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut, Protokolli për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut, për Parandalimin e torturës dhe të Dënimeve ose trajtimeve të tjera Çnjerëzore ose Degraduese, për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. Përveç sa më sipër, në vitin 1998, Shqipëria miratoi edhe Kushtetutën e re, e cila në nenin 18/2, promovon parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, mbrojtjen e respektimit e dinjitetit njerëzor dhe të të drejtave e lirive të njeriut, apo neni 54/3 të saj që shprehet se çdo fëmijë ka të drejtën "të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin normal të fëmijës."

Lidhur me këtë fenomen, krahas qeverisë shqiptare, organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe OJF kanë punuar në bashkëpunim me qeverinë për të trajtuar çështjet e dhunës në familje, përfshirë këtu dhe dhunën ndaj grave në familje. Rezultat i kësaj pune të përbashkët janë masat parandaluese (nismat educative, fushatat e ndërgjegjësimit), masat mbrojtëse (shërbimet për përkrahjen e viktimave, shërbimet e këshillimit dhe strehat për dhunën në familje) si dhe masat ligjore (legjislacioni për masat ndaj dhunës në familje, që mbron viktimat dhe ndëshkon autorët, lëshimi i urdhërave të mbrojtjes, etj.).

I. Dhuna në familje, shkaqet dhe pasojat e saj

Dhuna në familje është një fenomen mbarëbotëror, i cili ndikon negativisht në integritetin fizik, psikologjik, ekonomik dhe social, sidomos të pjesës më të ndjeshme të shoqërisë: grave, fëmijëve dhe të moshuarve. Ky fenomen, i cili shkaktohet nga faktorë të ndryshëm, si ndikimi kulturor me rrënjë të thella në traditat e vjetra patriarkale, situatat jetësore jo të shëndosha, diskriminimi gjinor, papunësia, etj., përbën një shqetësim në rritje për shoqërinë shqiptare, qeverinë dhe

shoqatat civile, si dhe donatorët e huaj të cilët operojnë në vend.

Dhuna është përkufizuar nga sociologë të ndryshëm si një "veprim që rrjedh nga një ose më shumë persona, nëpërmjet të cilit kryhet qëllimisht keqtrajtimi, vuajtja, presioni, manipulimi apo akte të tjera që dëmtojnë integritetin fizik, psikik dhe moral të një personi apo grupi njerëzish. Dhuna është presioni psikologjik apo ushtrimi i forcës ndaj një personi me qëllim marrjen e benefiteve kundër vullnetit të viktimës⁴¹.

"Dhuna në familje" nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve apo partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve apo partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën⁴².

Ndërsa, në kuptimin ligjor:

- "Dhunë" është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.
- "Dhunë në familje" është çdo akt dhune, sa më sipër, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.
- "Pjesëtarë të familjes", do të konsiderohen : bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues, vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit, fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues,
- "Viktimë" është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna.
- "Dhunues/e" është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.
- "Urdhër mbrojtjeje" është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën.
- "Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje" është urdhri i lëshuar

41 Teksti "Sociologjia", Antony Giddens, faqe 394-395

42 Konventa e KE Për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), neni 3.

përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrorit të mbrojtjes me vendim gjykate⁴³.

Brenda familjes dhuna është kryesisht një aktivitet mashkullor. Të dhënat tregojnë se lloji i parë i dhunës në familje është abuzimi fizik që ka në shenjestër të tij më së shumti fëmijët dhe kryesisht ata të moshës nën 6 vjec. Lloji i dytë dhe më i përhapur i dhunës në familje është dhuna ndaj grave, por nuk duhet harruar se edhe gratë mund të ushtrojnë dhunë në familje, e cila drejtohet vecanërisht kundrejt fëmijëve, por në raste më të pakta edhe ndaj bashkëshortëve. Dhuna femërore, është më e kufizuar dhe episodike se ajo mashkullore dhe shumë rrallë shkakton dëmtime fizike.

Pse dhuna në shtëpi është kaq e përhapur? Kjo ndodh, sepse lidhjet familjare janë normalisht të ngarkuara me emocione të forta, ku shpesh ndërthuren dashuria dhe urrejtja. Grindjet që shpërthejnë brenda familjes mund të sjellin antagonizma, të cilat mund të mos përjetojnë në të njëjtën mënyrë në kontekste të tjera sociale⁴⁴. Ai që duket si incident i vogël mund të precipitohet në një grindje të madhe midis bashkëshortëve ose midis prindërve dhe fëmijëve e të shkaktojë dhunë fizike apo psikologjike ndaj më të dobtëve. Dhunuesit mund të ndjejnë nevojën për të kontrolluar partnerin e tyre për shkak të vetëvlerësimit të ulët, xhelozisë ekstreme, ndjenjës së pronësisë, vështirësive për të kontrolluar zemërimin dhe emocionet e forta apo ndjesive të inferioritetit ndaj partnerit në drejtim të edukimit kulturor e profesional apo të ardhurave ekonomike.

Nga analiza e këtij fenomeni, vihet re se shume njerëz kanë besime të theksuara tradicionale dhe mendojnë se zotërojnë të drejtën për të patur kontroll mbi partnerin dhe fëmijet e tyre. Disa të tjerë mund të vuajnë çrregullime të padiagnostikuara të personalitetit apo çrregullime psikologjike të ndryshme. Të tjerë akoma mund të mbartin sjellje të tilla të përvetësuar gradualisht gjatë procesit të zhvillimit të tyre, aty ku dhuna është pranuar si pjesë normale e rritjes në familjet përkatëse.

43 Ligj nr.9669, datë 18.12.2006 "Për msat ndaj dhunës në mardhëniet familjare",neni

44 Gezim Tushi- Shoqëria Moderne dhe Njeriu i lakuar- Emal- Tirane, 2008

Gjithashtu, është evidentuar se fëmijët të cilët janë dëshmitarë apo viktimë të dhunës mund të krijojnë besimin se dhuna është një mënyrë e arsyeshme për të zgjidhur konfliktet midis njerëzve. Djemtë që rriten me besimin se gruaja nuk duhet vlerësuar apo respektuar dhe që shikojnë se dhuna ushtrohet lehtësisht drejt tyre, kanë më shumë gjasa të dhunojnë femrat në jetën e tyre prej adulti. Vajzat që bëhen dëshmitare të dhunës në familjet e tyre të origjinës, kanë më shumë gjasa të kthehen në viktimat e burrave të tyre të ardhshëm. Mund të thuhet se krijimi i këtij rrethi vicioz ka si shkak kryesor pikërisht fillimin brenda ambjentit të familjes, pranimin e këtij fakti në mënyrë graduale gjatë rritjes dhe në fund trashëgimin apo reflektimin e sjelljeve të tilla (tashmë të mësuara dhe me modele të gatshme për ti provuar) tek familjet që krijojnë në të ardhmen⁴⁵.

Një faktor tjetër që ndikon është fakti që një pjese e madhe e dhunës në familje aktualisht tolerohet, madje dhe pranohet. Megjithëse shoqëria sanksionon në mënyrë të kufizuar vetëm disa forma të dhunës familjare, ajo mund të thellohet drejt shfaqjeve të ashpra të sulmit. Veprime të tilla si "pëllëmba" e prindit apo "të rrahurit" në shtëpi, apo edhe nga mësuesit në shkollë, siç kanë qenë rastet e fundit në rrethin e Shkodrës, Tiranës, Dibrës (07.03.2016) në përgjithësi miratohen nga të tjerët dhe madje nuk konsiderohen si akte dhune dhe nga ana tjetër vihet re se tjetër qëndrim mbahet nëse dikush në një dyqan qëllon me pëllëmbë një fëmijë që nuk i bindet. Në fakt, në të dy rastet, në dhunën fizike që ushtrohet ndaj fëmijës nuk ka asnjë ndryshim. Murray Straus (1978, f.455)⁴⁶ ka argumentuar se qenia prind të pajis me një "licencë për rrahje", sepse "marrveshja e martesës është një licencë rrahjeje". Nga studimet rezulton se një në katër amerikane, nga të dy sekset, mbrojnë pikëpamjen se "kur një burrë rreh gruan, duhet të ketë një arsye të fortë", Greenblat, (1983)⁴⁷. Nuk ka asnjë dyshim se dhuna në familje është baza e dhunës. Ajo shihet përditë tek prindërit e lënduar fizikisht dhe psikologjikisht,

45 Vasta R.; Haith M.; Miller S.- Psikologjia e fëmijës- Perkth: Fatmir Hoxha - UEGEN, Tirane 2007.

46 Teksti "Sociologjia", Anthony Giddens, faqe 395

47 Teksti "Sociologjia", Anthony Giddens, faqe 395

duke u bërë shembull për fëmijët e tyre, njerëz që në të ardhmen do të mund të shfaqin prirje të dhunshme.

Studime të ndryshme nxjerrin në pah se është e vështirë të masësh nivelin dhe përhapjen e dhunës në familje, pasi ky fenomen zhvillohet brenda familjes dhe konsiderohet si çështje familjare. Si rrjedhojë, studime të ndryshme vlerësojnë se janë disa faktorë që mund të ndikojnë në raportimin e ulët të dhunës në familje, si, turpi, frika nga ndëshkimi, normat kulturore, stereotipet që ekzistojnë për dhunën në familje etj., ndaj faktet dhe shifrat duhen parë me kujdes, pasi ato jo detyrimisht japin një pasqyrë të qartë lidhur me përhapjen në vend të dhunës në familje.

Dhuna ka një efekt të thellë mbi gratë. Studimet e këtij fenomeni tregojnë se në disa vende dhuna, fizike e psikologjike, apo të dyja sëbashku, fillojnë para lindjes, nëpërmjet seksit ose abortit selektiv. Dhuna shfaqet edhe në procesin e lindjes lindjes, ku evidentohet se, prindërit, të dëshpëruar për të patur një djalë mund të vrasin foshnjat e tyre femra. Kjo gjë vazhdon të ndikojë gratë gjatë gjithë jetës së tyre. Çdo vit, miliona vajza i nënshtrohen abortit ose gjymtimit të organit gjental femëror. Vajzat kanë më shumë gjasa se sa vëllezërit e tyre të përdhunohen ose sulmohen seksualisht nga anëtarët e familjes, nga njerëzit me pozitë apo nga të jashtëmit. Në disa vende, kur një grua e vetme ose e re është përdhunuar, ajo detyrohet të martohet me sulmuesin e saj apo të burgoset për kryerjen e një veprë «penale». Gruaja që mbetet shtatzënë para martesës mund të rrihet, izolohet ose të vritet nga të afërmit e saj, edhe pse shtatzënia është rezultat i përdhunimit. Pas martesës, rreziku i dhunës ndaj grave është edhe më i madh, pasi jeton brenda mureve të shtëpise, aty ku burri i saj i jep vetes të drejtën për të sulmuar, përdhunuar apo vvarë atë. Gratë më të vjetra ose me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, kanë probabilitet më të lartë për tu sulmuar.

Forma më e zakonshme e dhunës është dhuna në shtëpi ose në familje, ajo mes bashkëshortëve, ndaj gruas dhe abuzimit të fëmijëve. Hulumtimet vazhdimisht tregojnë se një grua ka më shumë gjasa të plagoset, përdhunohet apo vritet nga një partner apo ish sesa nga dikush tjetër i huaj. Burrat mund të shkelmojnë, kafshojnë,

grushtojnë apo të përpiqen të mbytin gratë e tyre, të përdorin armë vdekjeprurëse për të vrarë ose plagosur ato. Nganjëherë gratë janë plagosur rëndë dhe nganjëherë janë vrarë ose kane vdekur si pasojë e lëndimeve të tyre. Sulmet kanë për qëllim të dëmtojë shëndetin psikologjik të gruas si dhe trupin e saj si dhe janë të shoqëruara shpesh me poshtërim dhe dhunë fizike, shpesh janë të paparashikueshme dhe kanë pak lidhje me sjelljen e grave si dhe mund të kenë një kohëzgjatje që nis nga javë pas javë e mund të shtrihen për shumë vite⁴⁸.

Dhuna psikologjike përfshin abuzimin verbal të përsëritur, ngacmimet, heqjen e të drejtave financiare dhe personale. Për disa gra, fyerjet e pandërprera dhe tiranitë që përbëjnë abuzim emocional mund të jenë më të dhimbshme se sulmet fizike. Është raportuar se gratë ndjejnë se aspekti më i keq i abuzimit nuk është dhuna në vetvete, por «tortura mendore» që i bën të «jetojnë në frikë dhe terror».

Gjymtimi gjenital femëror (FGM). Është një formë e dhunës ndaj vajzave që ndikon në jetën e saj prej të rrituri, është një praktikë tradicionale kulturore. Në shoqëritë ku ajo praktikohet, besohet se FGM është e nevojshme për të siguruar dinjitetin e vajzës dhe familjes së saj duke rritur edhe shanset e saj për tu martuar. FGM nënkupton të gjitha ndërhyrjet që përfshijnë heqjen plotësisht ose pjesërisht të aparatit gjenital femëror të jashtëm ose dëmtimi organeve gjenitale, qoftë për arsye kulturore apo të tjera jo-terapeutike.

*Dhuna e përditshme*⁴⁹. Kjo është ajo që përjtohet rëndom në jetët e të gjithëve ne dhe që karakterizohet në thelb nga dështimi për të respektuar rregullat, ndeshet në situata banale si mosrespektimi i ruajtjes së radhës, abuzimit në transportin publik, në pritjet e gjata për trajtim në spitale, kur tregohemi indiferent ndaj vuajtjeve njerëzore, në problemet e sigurisë publike apo aksidente. Ne të gjithë kontribuojmë dhe bëhemi pjesë e një skenari lufte, i cili

48 Basow Susan A. -Stereotipat dhe rolet gjinore, perkth:Edlira Haxhiymeri, Eglantina Gjermani; Botimi i III- DITURIA-Tirane, 2003

49 Journal of Interpersonal Violence

kthehet në një xhungël urbane. Disa elementë përbërës të dhunës ë përditshme janë:

a. *Shfaqjet e dhunës politike*, e cila lind nga grupe të organizuara, në pushtet ose jo. Indiferenca e njerëzve të zakonshëm ndaj ngjarjeve në vend, mospjesëmarrje në vendime, ekzistenca e korrupsionit, etj çon në keqmenaxhimin e institucioneve dhe praktikave institucionale duke shkaktuar dhunë dhe reagime nga grupe shpesh edhe të armatosura.

b. *Evidentimi i dhunës socio-ekonomike*, që reflektohet në kushtet e varfërisë dhe marginalizimit të grupeve të mëdha të popullsisë, si: papunësia, punësimi më i vogël, informaliteti, në mungesën ose mundësi të pabarabarta të qasjes në arsim dhe shëndetësi për gratë apo në tërësi.

c. *Dhuna kriminale*, që shfaqet në veprat penale në formën e vjedhjes, mashtrimit, trafikimit të drogës e i qënieve njerëzore, sjelljet që kryhen me mjete të paligjshme për të arritur të mira material si dhe çdo formë e sjelljes shoqërore individuale apo të organizuar që thyen rregullat e përcaktuara për të jetuar në komunitet. Të rinjtë e vendit tonë janë përballur me mundësitë dhe e projektojnë frustrimin e tyre. Kjo sigurisht varet nga familjet e tyre, shkollat, institucionet shtetërore, pra, është përgjegjësi e të gjithëve.

Nisur nga studimet e kryera mbi fenomenin e dhunës në familjenë Shqipëri dhe jo vetëm, evidentohen një sërë faktorësh që bëhen shkak për dhunën në familje. Këto studime evidentojnë tre nivele bazë faktorësh që nxisin dhunën në familje, të cilat janë:

1.Makrofaktorët: ndikimi i kulturës, ekonomisë, politikave, lëvizjeve të shumta demografike, mungesa e arsimit, traditës patriarkale, etj.

2.Mikrofaktorët (niveli familjar) : marrëdhëniet familjare, historia e mëparshme e abuzimit gjatë fëmijërisë, rritja në një

familje me ambient abuzues, modeli prindëror në familje, numri i lartë i fëmijëve në një familje, edukimi familjar, mungesa e mirëkuptimit në mes çifteve, papajtueshmëria e karaktereve, mungesa e të kuptuarit të fëmijëve, etj.

3.Faktorët e nivelit personal: probleme të shëndetit mendor, çrregullime të ndryshme të personalitetit, abuzimi me alkoolin e drogën, stresi, niveli i ulët arsimor, kompleksi i inferioritetit, niveli i ulët i kontrollit, mungesa e ndjeshmërisë, dështimi në kontrollin e impulseve (vetevetes), mungesa e vetëdijes, varësia emocionale, përvojat personale në marrëdhëniet familjare etj.

Por ajo që është më e rëndë për familjen, si qeliza bazë e shoqërisë, janë pasojat që vijnë nga dhuna, e cila është me efektë të rënda e të shtrira në kohë, pasi pasojat e saj mund të jenë të riparueshme apo mund të riparohen pas një kohe të gjatë. Pasojat e dhunës në familje, mund të kategorizohen në:

a.Pasojat për jetën dhe shëndetin e të dëmtuarit.

- *Dhuna ndaj grave dhe vajzave*, si dhe anëtarët e tjerë të shoqërisë, rrit rrezikun e shëndetit të dobët. Një numër në rritje i studimeve që merren me dhunën dhe shëndetin vazhdimisht raportojnë mbi efektet negative⁵⁰. Masa e vërtetë e ndikimit është e vështirë të vlerësohet për shkak se të dhënat mjekësore zakonisht mungojnë detaje jetësore në lidhje me shkaqet e dhunshme të lëndimit apo shëndetit të sëmurë. Pasojat e dhunës ndaj grave mund të mos jenë vdekjeprurëse, disa kanë formën e lëndimeve fizike, disa shkaktojnë paaftësisë kronike apo probleme të shëndetit mendor, ashtu sikurse një përqindje e lartë e lëndimeve kërkojnë trajtim mjekësor. Ato që mund të jenë vdekjeprurës: janë vrasjet, vdekja si rezultat i lëndimit të përhershëm ose AIDS. Shkak mund të jetë gjithashtu vetëvrasja, e përdorur si mjet i fundit për t'i shpëtuar dhunës ose e shkaktuar nga dhuna.

50 Echeburúa, E., Corral, P. Amor, P.J., Sarasua, B. y Zubizarreta, I. (1997a). Repercusiones psicopatológicas de la violencia doméstica en la mujer: un estudio descriptivo. Revista de Psicopatología y Psicología Clínica, 2, 7-19

- Lëndim gjatë shtatzënisë. Kërkimet e fundit kanë identifikuar dhunë gjatë shtatzënisë, duke u kthyer në një rrezik për shëndetin e nënës dhe fetusit të palindur.
- Plagosje për fëmijët. Fëmijët në familje të dhunshme mund të jenë viktimë të abuzimit. Shpesh, fëmijët janë plagosur duke u përpjekur për të mbrojtur nënat e tyre. (rasti i fundit, janar 2016, evidentohet në fshatin Pojan të Korçës, ku djali i doli përpara babait të armatosur me armë zjarri dhe u plagos rëndë, për të evituar vrasjen e nënës nga babai dhunues dhe i dehur, i cili më pas u arrestua nga policia).
- Shtatzënia e padëshiruar. Dhuna ndaj grave ose përdhunimi mund të prodhojë një shtatzëni të padëshiruar dhe ndikon në nxitjen e grave për të kërkuar përdorimin e kontraktivëve. Ato mund të jenë të stepura për përdorimin e tyre me partnerët nga frika e rrahjes ose braktisjes. Kjo rrit rrezikun e shtatzënisë së padëshiruar duke sjellë shumë probleme të tjera. Për shembull, është e dokumentuar se lindja e fëmijëve gjatë adoleshences se hershme apo të mesme i gjen vajzat biologjikisht dhe psikologjikisht të papjekura, duke shkaktuar rezultate negative shëndetësore për nënën dhe fëmijën.
- Vulnerabiliteti për sëmundje. Krahasuar me gratë jo të dhunuara, gratë që kanë përjetuar forma të ndryshme të dhunës kanë më shumë gjasa të përjetojnë një numër të problemeve të rënda shëndetësore. Është vënë re se gratë e dhunuara mund të jenë më të rrezikuara për shkak të imunitetit të dobët si pasojë e stresit të shkaktuar nga abuzimi. Për shembull, gratë e abuzuara kanë më shumë gjasa për të pirë duhan se sa ato pa një histori dhune.

b. Pasoja të karakterit psikologjik.

- Shëndeti mendor. Për gratë e rrahura apo të sulmuara seksualisht, lodhja emocionale dhe fizike mund të çojë deri në vetëvrasje. Këto vdekje janë një dëshmi dramatike e mungesës së mundësive në dispozicion për gratë që tu shpëtojnë marrëdhëniet të dhunshme. Kërkimet tregojnë se gratë e dhunuara përjetojnë vuajtje të mëdha psikologjike për shkak të dhunës. Shumë prej

tyre janë në depresion të rëndë, ndërsa të tjerat shfaqin simptomat e PTSD (Stresit Post Traumatik)⁵¹. Ato mund të jenë lodhura vazhdimisht, por nuk arrijnë të flenë, mund të kenë ëndrra dhe gjumë të shqetësuar apo çrregullime të të ngrënit. Shumë prej tyre drejtohen nga alkooli ose droga për të maskuar dhimbjen e tyre, ato vetëizolohen dhe bëhen të tërhequra, etj.

- *Përdhunimi dhe abuzimi seksual i fëmijëve*. Kjo mund të shkaktojë dëme të ngjashme psikologjike. Një episod i dhunës seksuale mund të jetë i mjaftueshëm për të krijuar efekte negative të qëndrueshme, sidomos nëse fëmija-viktimë më pas nuk merr mbështetjen e duhur. Ashtu si dhuna ndaj grave në familje, edhe abuzimi i fëmijëve zakonisht zgjat shumë vite dhe efektet e saj negativ mund të ndihen në moshën e rritur. Për shembull, humbja e vetëvleresimit dhe respektit për veten nga gratë që kanë qenë të abuzuara në fëmijëri mund të reflektohet në përpjekjet minimale që ajo bën për të shmangur situatat ku shëndeti apo siguria e tyre është në rrezik. Viktimat, si gratë dhe fëmijët, të cilët kanë vuajtur dhunën fizike, psikologjike dhe seksuale përshkohen nga ndjenjat e mëposhtme: frikë, faj, dëmtim, drrejtje, turp, depresion, neveri, mosbesim, izolim, ankth, etj⁵².
- *Efektet mbi fëmijët - dëshmitarë të dhunës*. Kërkimet kanë treguar se edhe fëmijët të cilët kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje edhe pa pësuar vetë atë drejtpërdrejt, shpesh vuajnë shumë nga simptomat që kanë fëmijët, të cilët janë abuzuar fizikisht ose seksualisht. Vajzat që janë dëshmitare të dhunës së ushtruar nga i ati ose njerku ndaj nënës së tyre, kanë më shumë gjasa të pranojnë dhunën si pjesë normale të martesës dhe jetës në familje. Meshkujt nga ana tjetër, kanë më shumë gjasa të jenë të dhunshëm ndaj partnereve të tyre në të ardhmen.

51 Echeburúa, E., Corral, P., Amor, P.J., Zubizarreta, I. y Sarasua, B. (1997b). Escala de Gravedad de Síntomas del Trastorno de Estrés Posttraumático: propiedades psicométricas. Análisis y Modificación de Conducta, 23, 503-526

52 Zenel Orhani- Psikologjia e Emocioneve- Ada, Tirane, 2003.

II. Ndikimi i legjislacionit dhe Policisë së Shtetit në parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje.

2.1. Ndikimi i legjislacionit për masat ndaj dhunës në familje dhe ndikimi i tij në parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje

Nisur nga rastet e shtuara të dhunës në familje, duke vlerësuar realisht këtë fenomen shqetësues të shoqërisë shqiptare si dhe duke analizuar veçanërisht pasojat e rënda që sjellin e që do të sjellin në të ardhmen e familjes dhe të shoqërisë shqiptare, nëpërmjet ndikimit të drejtpërdrejtë të shoqërisë civile, të OJF-ve që veprojnë në vendin tonë, shteti shqiptar, nëpërmjet oragneve të tij ligjvënese dhe ekzekutive ndërmoi një sërë masash të karakterit ligjor, organizativ dhe operues për të parandaluar dhe reduktuar këtë fenomen. Këtij qëllimi i kanë shërbyer dhe masat e mëposhtëme, si:

- masat për përmirësimin e kuadrit ligjor e institucional kombëtar, krahas ratifikimit të një sërë konventash ndërkombëtare, që synojnë parandalimin, luftimin, reduktimin dhe eliminimin e dhunës në familje. Hapat e hedhur në këtë drejtim datojnë rreth njëzet vite më parë, por përmirësimet e fokusuara veçanërisht në çështjen e dhunës në familje kulmuan nga viti 2006 e në vijim, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 "Për Masa ndaj Dhunës në Marrdhëniet Familjare" (i ndryshuar).
- Veprime të tjera të rëndësishme ligjore lidhen edhe me: Ligjin nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" , Ligjin nr.10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" , Hartimin dhe zbatimin e dy strategjive kombëtare dhe planeve të tyre për veprim, konkretisht: Strategjia e parë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje (SKBGJ-DHF) në vitet 2007-2010 si dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje në

vitet 2011-2015 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj. Rëndësi mori dhe Plani Kombëtar i Veprimit për përfshirjen e burrave/djemve si partnerë të grave/ vajzave për arritjen e barazisë gjinore dhe kundër dhunës me bazë gjinore e asaj në familje për vitet 2014-2019", hartuar me kërkesë të MMSR dhe mbështetjen e UNDP, UN Women dhe UNFPA-ja.

- Hartimin dhe zbatimin e VKM Nr. 334 datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".
- Ndryshimet e bëra dhe parashikimi i dhunës në familje si vepër penale në K.Penal të R.Shqipërisë (me Ligjin Nr.23, datë 01.03.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 "K.Penal i R.Shqipërisë", si dhe me Ligjin Nr.144/2013 datë 2.5.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 "K.Penal i R.Shqipërisë").
- Ndryshimime në ligje të tjera si : në ligjin Nr.10399 datë 17.03.2011 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" ku u sanksionua që t'u jepet ndihmë ekonomike edhe grave të dhunuara, në rastet kur ato pajisen me urdhëra mbrojtës., në ligjin Nr. 143/2013 "Për disa shtesa në ligjin Nr 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike" ku u shtua në listën e personave që kanë të drejtë të përfitojnë ndihmën juridike rastet kur personi është viktimë e dhunës në familje.
- Ratifikimi në shkurt 2013 të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (e njohur si Konventa e Stambollit), që ka hyrë në fuqi në datën 1 gusht 2014, etj⁵³.

53 Raport: "Vlerësimi i funksionimit të strukturave kundër dhunës në familje në Policinë e Shtetit, si pjesë e mekanizmit të referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare", faqe 18-44.

Ndryshimet në Kodin Penal - Ndikimi të veçantë në parandalimin dhe reduktimin e dhunës në marrdhëniet familjare

Në këtë studim dëshiroj të evidentoj ndryshimet në Kodin Penal në vitin 2012, të cilat patën ndikim të ndjeshëm në parandalimin e dhunës si u sanksionuan dy nene të posaçme e të rëndësishme për dhunën në familje.

- Neni 124/b - përcakton mbrojtjen e të miturve edhe nga prindërit, vëllezërit dhe motrat, gjyshërit, kujdestari ligjor ose nga çdo person i detyruar të kujdeset për ta duke i dënuar me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet.
- Neni 130/a - përcakton dhunën në familje duke përfshirë vepra penale të tilla si : rrahjen apo çdo vepër tjetër dhune, kanosjen serioze për vrasje ose plagosjen e rëndë, plagosjen me dashje, të kryer nga bashkëshorti/ja; ish-bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose ish-bashkëjetuesi/ja, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij dhe duke e dënuar autorin/ët me burgim deri në pesë vjet.

Këto masa të rëndësishme kanë një subjekt të veçantë që përfshin një anëtar të familjes që kryen akte të dhunshme ndaj një anëtari tjetër të familjes. Me këtë ndryshim mund të themi se dhuna në familje tani është qartësisht e përfshirë në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Para ndryshimeve në K.Penal, incidentet e dhunës në familje mund të ndiqeshin në rrugë civile duke iu drejtuar gjykatës për urdhër mbrojtje apo i urdhër të menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose në rrugë penale duke iu drejtuar prokurorisë në rastet kur plotësoheshin disa kushte dhe nga ana tjetër, dënimi për shkeljen e urdhrit të mbrojtjes apo i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ishte gjorbë ose burg deri në 2 vjet.

Bazuar në ndryshimet e K.Penal, tani incidentet e dhunës në familje cilësohen vepër penale dhe si pasojë prokuroria me të marrë djepin për një rast të dhunës në familje fillon menjëherë procedimin e

rastit (kryesisht), pra edhe nëse pala paditëse tërhiqet, çështja nuk mund të pushohet.

Nga ana tjetër, dhunimi i urdhrit të mbrojtjes(UM) apo i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes(UMM) përbën një kundravajtje penale sipas nenit 320/321 të K.Penal të ndryshuar dhe për rrjedhojë, dhunuesi mund të arrestohet kur ekzistojnë këto rrethana dhe dënimi për shkeljen e këtyre urdhrave është përcaktuar vetëm burg deri në 2 vjet, pra është hequr dënimi me gjobë.

Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare⁵⁴ - Gjetje e rëndësishme dhe efikase për kordinimin e masave për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje.

Përpjekjet për ngritjen e një mekanizmi të tillë kanë filluar menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit për Dhunën në Familje. Hapat e parë u ndërmorën fillimisht nga OJF-të, të cilat të mbështetura nga donatorët ndërtuan modelet e para të pilotimit të këtij mekanizmi në nivel vendor duke u nisur nga zberthimi i filozofisë së ligjit. Më pas, po me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare u hartua edhe Platforma Kombëtare për Ndërtimin e Reagimit të Koordinuar të Komunitetit kundër Dhunës në Familje në nivel vendor. Kjo shërbeu si udhërrëfyes për shtrirjen e mekanizmit të pilotuar në të gjithë vendin, duke shtuar edhe elementë pozitivë të praktikës botërore. Për një zbatim sa më të efektshëm të ligjit u hartua dhe miratua edhe VKM Nr. 334 datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".

Sipas VKM Nr.334,datë 17.02.2011, mekanizmi i referimit të rasteve të dhunës në familje është i përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme. Filozofia e këtij mekanizmi është:

54 Raport: "Vlerësimi i funksionimit të strukturave kundër dhunës në familje në Policinë e Shtetit, si pjesë e mekanizmit të referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare", faqe 18-44

“sapo një viktimë e dhunës në familje, e mbijetuar kontakton një nga anëtarët e Mekanizmit të Referimit (nuk ka rëndësi se cili anëtar kontaktohet i pari) anëtari i kontaktuar menjëherë fillon procesin mbështetës duke informuar të paktën një përfaqësues të bashkisë, policisë dhe strukturave shëndetësore”.

Shërbimet e ofruara për viktimat e dhunës në familje janë afatshkurtra dhe afatgjata. Në shërbimet afatshkurtëra, përfshihen: mbrojtje të menjëhershme dhe siguri, mbështetje shëndetësore, strehim, informacion dhe asistencë për fillimin e procedurave për urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes apo për ndjekjen e rastit penalisht, sipas përcaktimeve në Kodin Penal.

Si përfundim, masat e marra që nga viti 2006, me daljen e ligjit 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrdhëniet familjare” e deri në vitin 2013, kur janë bërë edhe ndryshimet e fundit në Kodin Penal, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje si dhe kanë vënë para përgjegjësisë ligjore autorët e tyre.

Legjislacioni kombëtar i miratuar tregon një nivel të rritur të vlerësimit të këtij fenomeni nga strukturat shtetërore, shteti kishte marrë përgjegjësitë e tij dhe njëkohësisht përcaktoi përgjegjësitë, detyrat dhe rolin e strukturave përkatëse shtetërore dhe bashkëpunimin e tyre me objektiv themelor parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në maximumin e mundshëm.

Statistikat e tregojnë se si rezultat i reagimit pozitiv të shoqërisë dhe të strukturave shtetërore, kryesisht ligjzbatuese, reagim që vihet re në vlerësimin dhe reagimin e shpejtë ndaj rasteve të dhunës dhe nëpërmjet ndëshkimit të autorëve të tyre, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në uljen e numurit të veprave penale të dhunës në familje. Nga statistikat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit evidentohet se veprat penale si “rrëmbimi dhe tortura” nuk evidentohen që prej vitit 2012, ndërsa “mosdhënia ndihmë” nuk evidentohet në vitet 2014-2015. Ndërsa vepra penale e vrasjes në vitet 2014 dhe 2015 në krahasim me vitet 2012-2013 ka pësuar ulje përkatësisht me 22,5% në vitin 2014 dhe me 33.2% në vitin 2015. Ulje kemi edhe në disa vepra

të tjera të rënda penale (shih tabelën). Por, përvec kësaj evidentohen edhe disa vepra penale që kanë pësuar një rritje të lehtë në 2015 në krahasim me vitin 2014, sic janë "vepra të turpshme", rritur me 1 rast, "mosdhënia e mjeteve të nevojshme për jetesë" rritur me 1 rast si dhe "marrja e pa të drejtë e fëmijës me 3 raste,etj.

Statistikë e dhunës në familje për disa vepra të rënda (2012-2015)⁵⁵

Vitet	Vrasje Nenet 76-83,85	Vrasje e mbetur në tentativë	Shkaktim vetvrasje (Neni 99)	Plagosje e rëndë dashje (Neni 88)	Plagosje e lehtë me dashje (Neni 89)
2012	28	9	6	14	66
2013	28	12	3	3	46
2014	22	11	12	10	37
2015	19	6	5	7	17
	97	38	26	34	166

2.2.Ndikimi i veprimtarisë së Policisë së Shtetit në parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje

Në luftën e përbashkët kundër dhunës në marrdhëniet familjare veprojnë shumë aktorë si pjesë të një mekanizmi të vetëm, në përbërje të të cilëve është dhe Policia, si institucion i administratës shtetërore. Puna e saj për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje është pjesë e strategjisë së saj për rendin publik. Në strategjinë e viteve 2007-2013, Policia e Shtetit caktoi si prioritetet: "*reduktimin e mëtejshëm të krimit dhe sjelljes antishoqërore*" dhe në këtë kuadër, një vëmendje e veçantë i kushtoi reduktimit të dhunës në familje, përmes masave ligjore dhe trajnimit të vazhdueshëm të personelit policor. Ndërsa në strategjinë e viteve 2014-2020, duke analizuar me përgjegjësi gjendjen e rendit publik, në këtë kuadër edhe atë të dhunës në marrdhëniet familjare, duke vlerësuar faktin se edhe pse krimi i vrasjes në vitin 2014 është ulur me 10 %, përsëri veprat penale ndaj jetës e shëndetit dhe sidomos krimet brenda familjes e ato ndaj pronës, ngelen shqetësuese për shkak të shtrirjes dhe pasojave të rënda që sjellin. Për këtë qëllim, Policia e Shtetit përcaktoi si moto të saj: "*Së bashku për një mjedis të sigurtë dhe jetë cilësore në komunitet*".

55 Statistika të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, (marrë shkurt, 2016)

Duke mbetur në çështjen në fjalë, detyra kryesore e Policisë së Shtetit në kuadër masave ndaj dhunës në familje është : *“Krijimi strukturave të posaçme me personat përgjegjës, përgjigja ndaj çdo njoftimi të marrë për dhunë në familje, kryerja e veprimeve procedurale, hetimi e referimi në prokurori, informimi dhe orientimi i viktimës për shërbimet sociale/shëndetësore, mbrojtja e garantimi i viktimës dhe dëshmitarët si dhe të veprimi për kapjen e autorit, paraqitja e kërkesës për urdhër mbrojtje dhe urdhër të menjëhershëm mbrojtje si dhe mbështetja e zyrave të përmbarimit për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës“.*

Kryerja e veprimtarisë së mësipërme, bën që Policia e Shtetit të konsiderohet si aktori kryesor i Mekanizmit të Referimit efektiv, sepse pa bashkëpunimin dhe trajtimin me prioritet e profesionalizëm nga ana e saj të rasteve të raportuara të dhunës në familje, është thuajse e pamundur të flasim për një mekanizëm efektiv. Shërbimet e Policisë së Shtetit, duke u bazuar në traditën dhe eksperiencën e saj, janë të parat që marrin njoftim mbi rastet e dhunës në familje, kjo jo vetëm se historikisht njerëzit i janë drejtuar policisë për ndihmë, për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të tyre, por sepse ata kanë besim tek ajo, besojnë se ajo zotëron kapacitetet, kualifikimin dhe mjetet e nevojshme për tu përballur dhe për të vënë para përgjegjësisë ligjore autorët e veprave penale.

Policia qëndron në vendin e parë, ndër institucionet ku viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare kanë denoncuar dhunën e pësuar, policia vazhdon të perceptohet nga viktima si organi që ofron siguri për viktimën e dhunës në familje gjatë procesit gjyqësor të shqyrtimit të kërkesë padisë për lëshimin e UMM/UM dhe ekzekutimit të tij si dhe që mundëson prova për dhunën e pësuar nga viktima duke ia lehtësuar procesin e të provuarit në gjykatë.

Ky rol konsiston në :

- Veprimtarinë parandaluese që organizon dhe kryen Policia e Shtetit për ruajtjen e rendit e të sigurisë publike në tërësi, pjesë e së cilës është dhe veprimtaria për parandalimin e dhunës në familje
- Reagimi dhe dhënia e shërbimeve të duhura për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, që nga vlerësimi, reagimi, kryerja

- e veprimeve procedurale(hetimi), ndihma për viktimën, etj.
- Bashkëpunimin dhe mbështetja për aktorëve të tjerë të luftës kundër dhunës në familje, me synim reagimin në bllok dhe me efikasitetin e duhur në kuadër edhe të detyrimeve që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore.
 - Evidentimi sistematik dhe të përditësuar të informacionit mbi rastet e dhunës në familje, analiza e këtij informacioni, nxjerrja e përfundimeve mbi shkaqet e dhunës në familje dhe përcaktimi i detyrave për thellimin e punës parandaluese dhe për reduktimin e kësaj dhune.

Por, megjithë rolin e tyre këto masa nuk e kanë ulur këtë fenomen në nivelet që synojë masat ligjore të marra, veprimtaria e institucioneve shtetërore në zbatim të tyre si dhe veprimtaria e aktorëve të tjerë që veprojnë në këtë drejtim.

Përfundime

1. Në vitin 2015 *ka rënie të numurit të veprave penale në kuadër të dhunës në familje*, gjë që tregon se legjislacioni dhe veprimtaria e gjithë aktorëve të përfshirë në këtë veprimtari dhe vecanërisht e Policisë së Shtetit si aktori kryesor, ka filluar të japë efektet e duhura. Statistikat tregojnë se nga 24 vepra penale të klasifikuara si dhunë në familje në 14 prej tyre ka rënie, pra në masën 58 % të tyre.

2. *Janë rritur rastet e denoncuara dhe të evidentuara*, gjë që tregon rritje të besimit të publikut në organet përkatëse shtetërore, sidomos në atë të policisë, përderisa këto raste denoncohen tashmë dhe kërkohet ndihmë. Kjo tregon gjithashtu rritje të ndërgjegjësimit se dhuna në familje është krim dhe se duhet ndëshkuar.

3. Gjatë vitit 2015, në raport me vitin 2014 evidentohet *ulja e rasteve të dhunës fizike dhe rritja e rasteve të dhunës psikologjike*, gjë që dëshmon se ka një tendencë për ndryshimin e formave të dhunës, nga fizike në psikologjike. Evidentohet se në vitin 2015, në krahasim me vitin 2014 kemi rritje të veprave penale të "marrdhënieve seksuale me dhunë" me 2 raste, të "fyerjes" me 4 raste, si dhe të veprave të tjera si "veprat e turpshme, mosdhënia e mjeteve për jetesë, shkatërrimi i pronës, etj.

Rekomandime

Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje janë evidentuar tashmë qartësisht si prioritete të qeverisë shqiptare. Veprimet për parandalimin dhe për reduktimin e fenomenit dhe trajtimin me efektivitet të rasteve po bëhen gjithnjë e më të organizuara dhe mirëkoordinuara institucionalisht. Për këtë :

1. Vemendja duhet të përqëndrohet në thellimin e bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve pjesmarrës, pasi ashtu si Policia e Shtetit që është gjithnjë e gatshme për t'ju përgjigjur dhunës në familje e kujdesit ndaj viktimave të kësaj dhune edhe aktorët e tjerë duhet ta bëjnë një gjë të tillë dhe sidomos ato organizata që thithin edhe fonde të destinuara për sigurimin dhe mbështetjen e viktimave të dhunës.

2. Duke patur parasysh se është intensifikuar dhuna psikologjike në familje, ne duhet të shtojmë kujdesin që duhet treguar përsa i takon trajtimit të formave të ndryshme të dhunës, sidomos dhunës seksuale, pasi kjo formë dhune vazhdon të mbetet ende tabu.

3. Të vihen më shumë në dispozicion të policisë burime financiare dhe njerëzore si dhe të plotësohen nevojat për infrastrukturë në komisariatet e policisë për ambjentët ku trajtohen viktimat e dhunës në familje, gjë që mund të zgjidhet edhe me donacione vendase apo të huaja. Duhet të fuqizohet struktura e dhunës në familje, ata duhet të trajnohen vazhdimisht si dhe të ketë qëndrueshmëri në punë të punonjësve të policisë që punonjë në sektorë të tillë, ashtu si dhe në sektorë të tjerë, pasi fitojnë eksperiencë në trajtimin e dhunës në familje. Strukturat e policimit në komunitet dhe te dhunës në familje të mos konsiderohen "vende pëllumbash", por vende ku hartohen strategji e ku jepen rekomandime edhe për strukturat e tjera të Policisë së Shtetit për parandalimin apo reduktimin e dhunës ndaj marrdhënieve familjare.

4. Lidhur me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, Akademia e Sigurisë, nëpërmjet departamentit përkatës të Fakultetit të Sigurisë Publike, përveç planifikimit të bërë në programin mësimor të lëndës përkatëse për vitin 2015-2016, në bashkëpunim

me strukturat përkatëse në Drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe OJF-të duhet të planifikojë për vitin mësimor 2016-2017 hartimin e një programi më të zgjeruar për këtë.

Si përfundim, analizat e punës, monitorimi dhe vlerësimi i rasteve të dhunës më bazë gjinore dhe të dhunës në familje duhet të jetë një proces i një punë të vazhdueshme dhe të bëhet pjesë e rutinës së punës, me qëllim që të evidentohen në kohë tendencat për dhunë dhe rastet kur ajo shfaqet, me qëllim që merren masat e nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e saj.

Referencat

- Teksti "Sociologjia", Antony Giddens, faqe 394-395
- Konventa e KE Për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), neni 3.
- Raport: "Vlerësimi i funksionimit të strukturave kundër dhunës në familje në Policinë e Shtetit, si pjesë e mekanizmit të referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare", faqe 18-44
- "Studim për vitkimat e krimit të dhunës në familje dhe sulmeve seksuale", Shtator 2013,
- Ligj nr.9669, datë 18.12.2006 "Për msat ndaj dhunës në marrdhëniet familjare", i ndryshuar
- VKM Nr. 334 datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".
- Gëzim Tushi- Shoqëria Moderne dhe Njeriu i lakuar- Emal- Tiranë, 2008
- Vasta R.; Haith M.Miller S.- Psikologjia e femijes- Perkth: Fatmir Hoxha-UEGEN, Tirane 2007.
- Basow, Susan A. -Stereotipat dhe rolet gjinore, perkth:Edlira Haxhiymeri, Eglantina Gjermani; Botimi i III- DITURIA-Tirane, 2003
- Journal of Interpersonal Violence
- Echeburúa, E., Corral, P., Amor, P.J., Sarasua B.y Zubizarreta, I. (1997b). Escala de Gravedad de Síntomas del Trastorno de Estrés Postraumático: propiedades psicométricas. Análisis y Modificación de Conducta, 23, 503-526
- Echeburúa, E., Corral, P. Amor, P.J., Sarasua, B. y Zubizarreta, I. (1997a). Repercusiones psicopatológicas de la violencia doméstica en la mujer: un estudio descriptivo. Revista de Psicopatología y Psicología Clínica, 2, 7-19
- Zenel Orhani- Psikologjia e Emocioneve- Ada, Tirane, 2003.
- Statistika të Drejtorisë së Policisë së Shtetit mbi dhunën në familje për vitet 2012-2015.

Dr. Eneida FRASHËRI



Msc. Eva JANAQI



NGJARJET TRAUMATIKE DHE SOMATIZIMI NË FËMIJËRI

Abstract

The diagnosis and treatment of children and adolescents who have somatization disorders constitute a challenge for pediatricians.

The purpose of the study is to describe the role of traumatic events in the development of somatization in children and the identification of risk factors.

Systematic literature review was used to achieve the goals of this study. Clinical and scientific articles in the field of psychiatry, pediatrics and psychology were searched in MEDLINE database.

Our knowledge on somatization in children and its effects are limited. The collaboration between mental health professionals and primary care physicians is a necessity. Also the development of appropriate diagnostic schemes for somatization disorders in children is a priority.

Abstrakti

Diagnozifikimi dhe trajtimi i fëmijëve të cilët vuajnë nga somatizimi përbën një sfidë për pediatrit.

Qëllimi i studimit është të përshkruajë rolin që luajnë ngjarjet traumatike në zhvillimin e somatizimit tek fëmijët si dhe evidentimin e faktorëve riskues.

Rishikimi sistematik i literaturës u përdor për të arritur qëllimet e këtij studimi. Artikuj klinike dhe shkencore në fushën e psikiatrisë, pediatriisë dhe psikologjisë u kërkuan në databazën MEDLINE.

Njohja jone aktuale mbi somatizimin tek fëmijët dhe pasojat e tij janë të kufizuara. Një domosdoshmëri është bashkëpunimi midis profesionistëve të shëndetit mendor dhe mjekëve të kujdesit shëndetësor parësor. Zhvillimi i skemave të duhura diagnostike tek çrregullimet somatizimit për fëmijët është një prioritet.

Hyrje

Somatizimi nuk është një fenomen i pazakontë në fëmijëri përkundrazi është e shpeshtë që fëmijët të ankohen për dhimbje të cilat nuk kanë baza mjekësore. Somatizimi është përkufizuar si tendenca për të shfaqur dhe përjetuar shqetësime fizike që kanë një origjinë të panjohur dhe simptomat i atribuohen një sëmundjeje fizike, për të cilën kërkohet kujdes mjekësor (Lipowski, 1988). Shpesh në literaturën e lidhur me fëmijërinë, somatizimi është karakterizuar nga prezenca e ankesave të shpeshta fizike, të tilla si dhimbje koke, dhimbje abdominale ose diskomfort abdominal, dhimbje muskuloskeletike, të vjella, marrje mëndsh, dhimbje kraharori apo lodhje. Këto simptoma mund të jenë të përjetuara të vetme ose së bashku.

Somatizimi është subjektiv dhe ka një natyrë të pashpjegueshme mjekësore, shoqërohet me manifestim fizik dhe prezenca e tij rezulton me përqendrim të funksionimit. Për vetë natyrën fizike të simptomave, fëmijët që somatizojnë janë shpesh të parë në një këndvështrim pediatrik. Të dhënat tregojnë se 11% e vajzave dhe 4% e djemve në vizita pediatrike paraqesin simptoma somatike të pashpjegueshme. Kjo vëmendje mjekësore jo vetëm që është e kushtueshme por shpesh herë dhe e rrezikshme sepse mund të çojë në procedura të rrezikshme mjekësore (Campo dhe Fritsch, 1994).

Simptomat më të raportuara zakonisht tek fëmijët dhe adoleshentët janë: dhimbje koke, me një prevalencë 10-30% , e ndjekur kjo nga dhimbja abdominale me një prevalencë 10-25%. Dhimbja e muskujve dhe e gjymtyrëve është raportuar të afektojë rreth 25% të fëmijëve, dhe lodhja rreth 15%. Të tjera shqetësime të zakonshme janë marrje mëndsh 15% dhe dhimbja e kraharorit 7-15% (Campo dhe Fritsch, 1994).

Metodologjia

Diagnostifikimi dhe trajtimi i fëmijëve të cilët vuajnë nga somatizimi përbën një sfidë në pediatri. Qëllimi i studimit

është të përshkruajë rolin që luajnë ngjarjet traumatike tek fëmijët si, keqtrajtimet në fëmijëri, situatat traumatike në shkollë, stresi në somatizimin tek fëmijët, si dhe evidentimi i faktorëve riskues.

Rishikimi sistematik i literaturës u përdor për të arritur qëllimet e këtij studimi. Artikuj klinike dhe shkencore në fushën e psikiatrisë, pediatriisë dhe psikologjisë u kërkuan në databazën e MEDLINE. Artikujt e konsultuar përfshinin termat "somatizim", "fëmijë", "ngjarje traumatike" dhe "faktorë riskues", ishin në anglisht dhe ishin botuar jo më heret se viti 1990.

Pas grumbullimit të një sërë artikujsh, u bë një shqyrtim shumë i detajuar i artikujve madje dhe i bibliografisë së tyre, në mënyrë që të identifikohesh ndonjë artikull shtesë me rëndësi për studimin. Prej 42 artikujve të shqyrtuar, në 13 prej tyre trajtoheshin rolin që luajnë ngjarjet traumatike në zhvillimin e somatizimit dhe evidentonin faktorët që i bënin më të riskuar fëmijët ndaj somatizimit.

Ngjarjet traumatike të fëmijërisë dhe somatizimi

Ankesat e zakonshme somatike në fëmijët e shkollës, të tilla si dhimbja e kokës dhe e stomakut, është e lidhur më variabla psikosociale të ankthit dhe depresionit, fatkeqësive të fëmijërisë dhe distresit në shkollë. Trajtimi i këtyrë çështjeve komplekse të shëndetit të fëmijëve kërkojnë një identifikim të qartë, referim të përshtatshëm, dhe plane të individualizuara trajtimi.

Somatizimi tek fëmijët konsiston në përjetimin e distresit somatik dhe nuk mund të shpjegohet plotësisht nga një diagnozë mjekësore. Simptomat somatike tek fëmijët me çrregullimin e somatizimit bëhen fokusi i vëmendjes të tyre dhe shpesh interferojnë me shkollën, jetën në shtëpi, dhe marrëdhëniet me bashkëmoshatarët. Çrregullimi i somatizimit tipikisht vjen mbas përballjes me një stresor psikologjik. Somatizimi shpesh ndodh në përgjigje të stresit psikologjik, dhe zakonisht persiston edhe pasi stresori akut është larguar, duke çuar në gjëndjen ku si fëmija ashtu dhe familja besojnë se problemi mjekësor nuk është gjetur ende. Kështu pacientët dhe familjet mund të vazhdojnë të kërkojnë për diagnozën

e saktë mjekësore. Shqetësimet somatike mund të jenë simptoma komorbide me depresionin dhe çrregullimet e ankthit. Shqetësimet të vetëdijshme apo të pavetëdijshme mund të shprien në simptoma somatike të cilat ndryshojnë për nga ashpërsia dhe që mund të prekin çdo organ.

Trauma psikologjike mund të dëmtojë sistemin endokrin. Po ashtu ekspozimi ndaj një stresi ekstrem nxit përgjigjen "lufto apo ik" e cila aktivizon sistemin simpatik. Kjo përgjigje rrit nivelin e kortizolit në SNQ, e cila e lejon individin të ndërmarë veprime mbijetese, por që në nivele ekstreme ndikon në zhvillimin e trurit. Tek fëmijët nivelet e larta të kortizonit mund të çrregullojnë diferencimin e qelizave, migrimin e qelizave, apo funksione të tjera të SNQ. Trauma prek dhe sistemin limbik të trurit (përgjegjës ky për emocinet, kujtesën, afektin, rregullimin e nxitshmërisë), neokorteksin (perceptimin e vetes dhe të botës) dhe funksione të tjera në SNQ. Eksperiencat traumatike janë ruajtur në mendjen/trupin e fëmijës dhe përbëjnë një kërcënim të vazhdueshëm për mirëqënien e tij.

Efektet mendore të traumave fokusohen më tepër në stresin post-traumatik. Somatizimi nuk listohet midis përgjigjeve klasike të krizave. Megjithatë "somatizimi", "simptomat e somatizimit" dhe 'simptomat somatike' jo diagnostike janë përshkruar gjerësisht në literaturë.

Somatizimi ka më shumë mundësi të ndodhë tek fëmijët dhe adoleshentët të cilët janë të **keqtrajtuar** ose kanë pësuar të gjitha tipet e traumave. Trauma e fëmijërisë është një faktor rrisht i rrezikut për somatizimin. Roelofs et al. (2002) krahasuan 54 pacientë me çrregullimin e somatizimit dhe 50 me çrregullime të gjëndjes shpirtërore dhe matën traumat e përjetuara gjatë fëmijërisë. Ata gjetën se personat somatizues kishin pasur trauma të fëmijërisë si abuzimi fizik, abuzimi seksual, apo dhunë të formave të ndryshme më shumë se sa ata që vuanin nga depresioni (Roelofs et al., 2002).

Edhe pse shumica e studimeve kanë egzaminuar vetëm abuzimin fizik dhe seksual, studimet e kohëve të fundit kanë treguar që edhe abuzimi emocional dhe neglizhimi janë të lidhura me somatizimin po ashtu. Po ashtu fëmijët mund të përjetojnë një sërë **situatash**

traumatike në shkollë të cilat mund të nxisin somatizimin. Bullizmi, dhuna në shkollë, ekspozimi ndaj një ngjarjeje traumatike në ambientet e shkollës si dhe pritshmëritë tepër të mëdha në lidhje me arritjet e fëmijës janë vlerësuar si faktorë që çojnë në somatizim.

Të mesuarit është procesi psikologjik primar nëpërmjet të cilit shfaqet somatizimi (Campo dhe Fritsch, 1994). Të mesuarit nëpërmjet modelimit ndodh atëherë kur një fëmijë vëzhgon një prind apo një të afërm në familje i cili si pasojë e të qenit i sëmurë merr më shumë vëmendje. Por një fëmijë mund të mësojë edhe nëpërmjet eksperiencës direkte, kur ai merr më shumë vëmendje kur është i sëmurë se sa kur nuk është sëmurë. (Campo dhe Fritsch, 1994). Në shumë raste somatizimi fillon pasi fëmija ka pasur një problem të vërtetë, cka sugjeron se vëmendja e marrë përgjatë kohës që fëmija ishte i sëmurë mund të çojë disa fëmijë që ta mbajnë problemin në mënyrë që të marrin akoma me shume vëmendje (Garralda, 1999).

Stresi është përcaktuar si një faktor shkaktar (e.g., Reynolds, O’Koon, Papademetriou, Szczygiel, & Grant, 2001; Torsheim & Wold, 2001). Format më të zakonshme të stresit konsistojnë në presionin që i ushtrohet fëmijës për të mesuar.

Studimet kanë evidentuar edhe disa ngjarje të tjera traumatizuese që ndikojnë në çrregullimin somatik duke përfshirë divorcin e prindërve, sëmundjet e prindërve dhe abuzimin seksual të fëmijës (Hotopf, 2002)


Fëmijët mund të përgjigjen stresit në mënyra të ndryshme bazuar në temperamentin e tyre, shkallën dhe natyrën e sistemeve të mbështetjes familiare. Shpesh fëmijët e konvertojnë stresin në simptomë fizike. Disa situata nxitje që mund të jenë veçanërisht të vështira në fëmijëri përfshijnë tranzicionin e programeve shkollore, divorcin e prindërve, një zhvendosje ose lëvizje banimi ose traumat e përjetuara në shkollë. Simptomat somatike mund të bëhen një mënyrë e fëmijës për të përballuar streset e jetës.

Faktorët e Riskut

E megjithatë jo të gjithë fëmijët që përjetojnë trauma shfaqin sjellje somatizuese. Atëherë shtrohet pyetja se cilët janë faktorët e riskut

apo ato tipare predispozuese që e bëjnë një fëmijë të ekspozuar ndaj një traume të somatizojë ndërsa një tjetër jo?

Katër janë faktorët kryesorë që përfshihen në somatizim. Karakteristikat individuale të fëmijës, marrëdhëniet prind-fëmijë, familja dhe shkolla.



Figurë: Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e çrregullimit të somatizimit tek fëmijët

Fëmijët somatizues janë përshkruar të jenë më shumë obsesive, të ndjeshëm, të pasigurt, dhe ankthiozë (Garralda, 1996; Kowal dhe Pritchard, 1990). Fëmijët e karakterizuar me një temperament më të vështirë është bërë e ditur të shfaqin më shumë efekte somatizuese përballë stresorëve të përditshëm (Walker e t.j., 2001). Këto gjetje mund të jenë gjithashtu dhe si rezultat i vështirësisë për të rregulluar emocionet p.sh fëmijët që kanë një emocionalitet negativ janë më të predispozuar për ta përjetuar një ngjarje negativisht (stresorët) mbas të cilit e kanë më të vështirë të kthehen në nivelet bazë të nxitshmërisë (Calkins, 1994).

Fëmijët somatizues vijnë nga familje të përshkruara si më pak mbështetëse (Walker dhe Greene, 1987; Walker e t.j., 1988) dhe me një marrëdhënie të varfër prind-fëmijë (Aro e t.j., 1989; Aro e t.j., 1987;

Rauste-von Wright dhe von Wright, 1981).

Shumë studime kanë tregua që ankthi, depresioni, dhe sjellja antisocial janë më të shpeshta në familjet e fëmijëve ose të adoleshentëve me ankesa somatike se sa në familjet e shëndetshme ose familjet me një sëmundje organike (Campo & Fritsch, 1994; Garralda, 1996; Gulhati & Minty, 1998). Për më shumë, kërkimet kanë treguar nivele të larta të perceptimit të konfliktit dhe stresit të raportuara në familjet e pacientëve somatik (Aro, 1989; Zuckerman e tj., 1987). Gjithashtu prania e një prindi që vuan nga depresioni ose konfliktet e vazhdueshme mund të mbushin fëmijët me një nivel të tillë stresi të cilët ata nuk janë në gjëndje ta përballojnë.

Faktorë si të ardhura të pakta, edukim i ulët i prindërve, prind i vetëm, dhe shkollë jo e përshtatshme janë parë si faktorë që mund të rritn somatizinin (Alfven, 1993; Berntsson & Koehler, 2001; Fearon & Hotopf, 2001).

Walker (Walker e tj., 2002; 1994; 2001) realizuan disa studime për të parë lidhjen midis stresorëve në shkollë dhe funksionimit në shkollë në somatizimin në fëmijëri dhe adoleshencë. Ata gjetën që mundësitë e somatizimit janë të amplifikuara në kontekstin e marrëdhënieve të varfra me të tjerët në shkollë dhe aftësive akademike. Ky studim përshkruan fëmijët që janë inkompetentë në të paktën një fushë të funksionimit në shkollë, janë më në risk për një shfaqje më të madhe të somatizimit në ndikimin e një situatë stresuese. Këto gjetje mbështesin një hipotezë të dytë që fëmijët të cilët mund të kenë frikën e dështimit në shkollë ose në fushën akademike janë më pak të prirur të përballen me ngjarjet negative të jetës dhe më të prirur rrjedhimisht të zhvillojnë simptoma somatike. Shprehja e këtyre simptomave mund të jetë përfituese për ta duke ju lejuar atyre të shmangin situatën stresuese, ose të tërheqin vëmendjen duke përforcuar kështu shprehjen e simptomave, dhe përjetimin e distresit somatic duke i bërë kështu më vulnerabël ndaj ngjarjeve traumatike, në shkollë apo në shtëpi.

Përfundime

Si përfundim mund të thuhet se të dhënat sugjerojnë se stresi në marrëdhëniet prind-fëmijë është i shoqëruar me rritjen e somatizimit tek fëmijë, sidomos kur fëmijët janë të karakterizuar nga një temperament i vështirë/ emocional ose kanë deficiete në marrëdhëniet dhe funksionimin në shkollë. Gjithashtu disa risqe sociodemografikë mund tju shtohen faktorëve të mësipërm.

Njohja jone aktuale mbi somatizimin tek fëmijët dhe pasojat e tij janë të kufizuara. Një domosdoshmëri është bashkëpunimi midis profesionistëve të shëndetit mendor dhe mjekëve të kujdesit shëndetësor parësor. Zhvillimi i skemave të duhura diagnostike tek somatizimi për fëmijët është një prioritet.

Referenca:

- Aro, H., Hanninen, V., dhe Paronen, O. (1989) Social support, life events and psychosomatic symptoms among 14-16 years old adolescents. *Social Science Medicine*, 29, 1051-1056
- Beck, J. (2006). Trajectories, antecedents, and outcomes of childhood somatization. *Marrë nga: etd.library.pitt.edu*
- Campo, J. V., & Fritsch, S. L. (1994). Somatization in children and adolescents. *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 33, 1223-1235.
- Charles C. Engel, J. (2004) Somatization and multiple idiopathic physical symptoms:
 - relationship to traumatic events and posttraumatic stress disorder. Washington, DC, US: *American Psychological Association*.
- Garralda, M. E. (1999). Practitioner review: Assessment and management of somatisation in childhood and adolescence. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 40, 1159-1167.
- Garner, D.M., Olmstead, M.P., Bohr, Y., & Garfinkel, P.E. (1982). The eating attitude test: Psychometric features and clinical correlates. *Psychological Medicine*, 12, 871-8.
- Hotopf, M. (2002). Childhood experience of illness as a risk factor for medically unexplained symptoms. *Scandinavian Journal of Psychology*, 43, 139-146.
- Vega, B., Liria, A. (2005). Trauma, dissociation and somatization. *Annuary of clinical and health psychology*, 27-38.
- Silber, T. (2011). Somatization Disorders: Diagnosis, Treatment, and Prognosis. *Marrë nga: <http://pedsinreview.aappublications.org>*
- Reynolds, L, O'Koon, J., Papademetriou, E., Szczgiel, S., Grant, K. (2001). Stress and somatic complaints in low-income urban adolescents. *Journal of Youth and Adolescence*, 30, 499-514.
- Walker LS, Garber J, Smith CA, Van Slyke DA, Claar RL. The relation of daily stressors to somatic and emotional symptoms in children with and without recurrent abdominal pain. *Journal of Consulting and Clinical Psychology*. 2001;69:85-91.
- Walker LS, Garber J, Green JW. (1991) Somatisation symptoms in pediatric abdominal pain patients: Relation to chronicity of abdominal pain and parent somatisation *Journal of Abnormal Child Psychology*. 19:379-394.



Erjona FUSHA



TIPARE DHE VEÇORI TË URBANIZIMIT

Abstrakti

Në këtë punim do të trajtohen tipare të urbanizmit bazuar në Shkollën e Çikagos. E cila analizon hapësirën urbane dhe truallin nisur nga një qasje funksionaliste dhe administruese. Ndërsa qyteti është një model industrial i organizuar përreth qasjes urbane në rrahë koncentrikë. Gjithashtu do të trajtohen pikëpamje të rëndësishme të Louis Wirth lidhur me tiparet dhe veçoritë e urbanizimit. Wirth e pa qytetin si promovim të individualizmit. Me fjalë të tjera, njerëzit në një qytet ndiqen nga interesat e tyre mbi ato të të tjerëve (interesat e grupit). Së dyti, ai e pa anonimitetin si një tipar përcaktues të qyteteve. Banorët e zonave urbane nuk e njohin njëri-tjetrin. Për njerëzit që banojnë në zonat urbane marrëdhëniet karakterizohen nga ajo që Wirth e quan cektësi. Kjo do të thotë se marrëdhëniet janë të papërcaktuara. Jeta urbane është kaotike dhe ne duhet të ndërveprojnë me shumë njerëz, por Wirth beson se kjo njohje është vetëm në një nivel sipërfaqësor. Në vende të zhvilluar për të mbajtur marrëdhënie të ngushta me njerëzit, ne duhet të ndërveprojnë ditë për ditë brenda qytetit në mënyrë që marrëdhëniet tona të mos jenë sipërfaqësore.

Fjalët kyçe: urbanizim, qyteti, Shkolla e Çikagos dhe lëvizja e popullsisë.

1. Hyrje

Periudha e tranzicionit post komunist ka sjellë dinamika të reja në transformimin e zonave urbane. Sado përmirësime janë bërë në shumë drejtime, vihet re se ka edhe shpërbërje të identitetit tradicional të qyteteve. Kështu nga njëra anë ky identitet urban i ardhur nga e shkuara është dëmtuar nga koha dhe nga ana tjetër ai është ndodhur nën presionin e dinamikave të reja urbane të shoqërisë së tregut.

Identiteti urban në rradhë të parë është një vlerë simbolike. Sado që është materializuar në objekte të ndryshme ai ka një kuptim

simbolik, shpreh në rradhë të parë një vlerë shpirtërore madhore. Pastaj është një vlerë simbolike qendrore që është pranuar pothuajse nga shumica e komunitetit që njeh vetveten në të, barazohet me të, i jep kuptim qenies së vet nepërmjet tij.

Ndërkaq kur hapësira urbane nuk është veçse një element pragmatik, vetëm një zonë ku blihet dhe shitet ku fitohen ose humben para, në këtë rast ajo e ka humbur simbolikën e vet, bëhet e huaj për njeriun dhe prodhon një shpërbërje të vetë shoqërisë.

Në Shqipëri të gjithë të gjithë këto elemente u përzien me njëri – tjerin duke bërë që nga pikëpamja simbolike qyteti t'i ngjajë një kaosi kuptimor, me ngjyra të përziera dhe pa kuptim. Në kushtet kur gati çdo qytet europian dhe më gjerë ka identitetin e vet, do të ishte e papranueshme për ne sepse pavarësisht dëmtimeve që ka pësuar identiteti simbolik sërish ka vlera të papërsëritshme të kulturës materiale që duhen mbrojtur.

Në planet rregulluese të qyteteve duhet t'i jepet rol më i madh dhe i pazënvendësueshëm aspektit simbolik, faktit që hapësira duhet të flasë, të transmetojë vlera simbolike, të shtjellojë qartë identitetin e vendit ku shtrihet apo disa elementë identitarë që duhet të qëndrojnë pranë dhe të harmonizuar me njëri – tjetrin.

Qytetet shqiptare në përgjithësi dhe Tirana në veçanti, kanë përjetuar dramën e urbanizimit të mbrapsht, ndërkohë komunitetet vuajnë gjithë pasojat e këtij procesi të periudhës së pas vitit 1990. Gjatë këtyre viteve shoqëria shqiptare e etur për liri, u përball me dyndjet e banorëve të fshatrave kryesisht drejt qyteteve të mëdha dhe territoreve urbane, me mungesën e kontrollit administrativ e të zbatimit të ligjit, keqpërdorimin e të drejtës së pronës dhe manipulimin ndaj saj, e të tjerë kushte, të cilat krijuan një realitet të veçantë për territoret urbane në Shqipëri, të ngjashëm me ritmet e fillimit të urbanizimit perëndimor, të cilat përkrijnë me nisjen e rrugëtimit të industrializimit, të vlerësuar nga Max Weber, George Simmel, Louis Wirth, etj.

Jeta urbane e Tiranës, kryesisht ajo larg qendrës, i ngjan zhvillimeve urbane të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit të XX, të përshkruar nga George Simmel i cili duke përshkruar jetën urbane

të metropolit mendonte se:

“kishte dy prirje te rëndësishme të jetës urbane, të cilat kondiciononin mendimin dhe veprimin e komuniteteve urbane: intensiteti i nxitjes nervore apo ndjesia në qytet si edhe moskontrolli i efekteve të tregut në marrëdhëniet urbane, ku shoqëria urbane nuk kishte zgjedhje tjetër veçse të bëhej e pandjeshme ndaj ngjarjeve dhe njerëzve përreth tyre dhe se, vërshimet e shpërthimet e vrullshme e të papritura, ishin treguesit psikologjikë të jetës sociale në hapësirën urbane” (S. Georg 1903: 18).

2. Shkolla e Çikagos dhe sociologjia urbane

Universiteti i Çikagos u themelua në vitin 1982. Shkolla e Çikagos luajti një rol shumë të rëndësishëm në lidhje me themelimin e Sociologjisë urbane.

Shkolla e Çikagos njihet me modelin Burgess të formave urbane, që bazohet në tiparet e shfrytëzimit të tokave të Çikagos më 1920 dhe përmes këtij modeli tentohet të përshkruhen tiparet bazike të segregimit shoqëror në jetën moderne. Ky model është tip ideal për të përshkruar rritjen e qytetit duke treguar mungesën e karakteristikave natyrore si: ujërat dhe kodrat. Ky model përshkruan strukturat shoqërore urbane dhe ofron një shpjegim në lidhje me shpërndarjen e grupeve shoqërore në zonat. Bazohet në idenë së vlerat e tokës janë më të larta në qytet sepse konkurenca është më e madhe në vendbanimet në qendër.

Shkolla e Çikagos ka zhvilluar dy koncepte në Sociologjinë Urbane, si më poshtë vijon:

1. Është i ashtuquajtur i drejtim ekologjik (që tregon përshatjen e njerëzve ndaj mjedisit. Qytetet nuk ngrihen në mënyrë të rëndomtë por ngrihen duke iu përshtatur mjedisit, pra përqendrohën në zona të përshtatshme aty ku mund të furnizoheshin më lëndë të para sepse kjo ju mundësonte të siguronin jetesën. (S. Mike, W. Alan and W. Kevin; 2003: 9)
2. Urbanizmi në grupe shoqërore, si mënyrë jetese, i zhvilluar nga Wirth (Park, 1952; Wirth, 1938). Këtë koncept e

shtjelloi Wirth: shkalla në të cilën bota bashkëkohore mund të thuhet se është urbane nuk matet plotësisht dhe saktësisht me përqindjen e popullsisë së përgjithshme që jeton në qytete. Në qytete, vë në dukje Wirth, njerëzit jetojnë pranë njëri-tjetrit pa u njohur personalisht – një dallim thelbësor me fshatrat e vegjël tradicionale. Pra ai analizonte se çfarë është urbanizmi si formë sociale. (S. Mike, W. Alan and W. Kevin; 2003: 9)

Në kuadër të analizës urbane, shkolla e Çikagos kishte edhe kërkuesit e vet: etnografët dhe këta hulumtimin e tyre e bazuan në jetën urbane, përkatësisht në mangësitë e saj: tek pasiguria në qytet. Dhe këta tipizuan disa lloje kulturash në kuptimin e mangësive të qytetit, pra këto që përbejnë ambientin jo të favorshëm për të jetuar në qytet: Bandat (the Gang); endacakët (the Hobo); kërcimtarët taksi, njeriun që blenë një femër për t'a shoqëruar. Hulumtimi i këtyre u bazua në metodën e observimit.

Shkolla e Çikagos e analizon hapësirën urbane dhe truallin nisur nga një qasje funksionaliste dhe administruese. Ndërsa qyteti është një kampion i qytetit model industrial i organizuar përreth qasjes urbane në rrahë koncentrikë. Ai është produkt i ndarjes së punës në shoqëritë moderne industriale.

3. Teoria e Wirth-it mbi sociologjinë urbane

Rreth 60 vjet më parë Louis Wirth shkoi që urbanizimi i botës në fundin e shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillimin e atij të njëzet ishte një nga "faktet më impresionuese të kohëve moderne" duke sjellë ndryshime të thella në jetën sociale dhe ekonomike të qyteteve dhe shteteve. (Wirth, L. 1938: 4)

Wirth propozoi një paradigmë të re akademike për jetën e qytetit si një konstrukt social. Urbanizimi si mënyrë jetese është karakterizuar shpesh nga përhapje konfliktesh të normave dhe vlerave, nga ndryshimet të shpejta, nga rritja e lëvizjes së popullsisë, nga vënia e theksit tek të mirat materiale dhe tek rritja e individualizimit.

Wirth vëzhgon se shkalla në të cilën bota bashkëkohore mund të thuhet se është urbane nuk matet plotësisht dhe saktësisht me përqindjen e

popullsisë totale që jeton në qytete. Ndikimet që ushtrojnë qytetet mbi jetën shoqërore të njeriut janë më të mëdha se çdo të tregonte raporti i popullsisë urbane, pasi qyteti është jo vetëm gjithnjë e më shumë vendbanimi dhe puna e njeriut modern, por edhe qendra nismëtare dhe kontrolluese e jetës ekonomike, politike dhe kulturore i cili ka tërhequr në orbitën e tij bashkësitë më të largëta të botës dhe i ka endur në zonat, popujt dhe veprimtarinë e shumëllojshme në një kozmos (Wirth, L.1938: 8).

Wirth thekson se tri janë karakteristikat kryesore të qendrave të banuara: madhësia e popullsisë, densiteti dhe heterogjeniteti demografik. Wirth insiston se banorët urbanë, në kontrast me zonat rurale, varen shumë nga ndërveprimet e përditshme me njerëzit, duke prodhuar kontakte të papërcaktuara, sipërfaqësore, kalimtare, segmente dhe i shtyn njerëzit të përdorin rezervimin, indiferencën dhe një opinion të shkujdesur që të imunizojnë veten kundrejt pritshmërive të të tjerëve. Prandaj, kontakti ndërpersonal është i shtyrë vetëm nga përfitimet egoiste. Me këto tri faktorë, Wirth propozon tri prespektiva të ndërlidhura, në të cilën për të ndërtuar një teori të urbanizimit: strukturën fizike, organizimi social dhe qëndrimet. Nga pikëpamja fizike, qyteti është bërë dominant për shkak të shumëllojshmërisë së shërbimeve dhe institucioneve, si edhe lehtësirat superiore që i shërbejnë atyre, sigurojnë armatimin e nevojshëm për të mbrojtur mbi rajonet me aftësi konkurruese të vogla. Për sa i përket këndvështrimit organizativ, ekzistenca urbane është karakterizuar nga një zbehje e theksit mbi farefisninë dhe kontakteve primare, për të çliruar individët të veprojnë racionalisht në ndjekje të interesave të tyre dhe pa këshillat rënduese të insitucioneve tradicionale.

Argumenti bazë i Wirth, ishte që jeta e qytetit karakterizohet nga izolimi dhe çrregullimi shoqëror dhe kjo vjen nga fakti që qytetet janë të mëdhenj, të dendur dhe heterogjenë, po të përdorim fjalët e tij.

Teoria e Wirth është e rëndësishme për pranimin se urbanizimi nuk është vetëm pjesë e shoqërisë, por shpreh dhe ndikon në natyrën e sistemit më të gjerë social. Aspektet e mënyrës urbane të jetesës janë

karakteristikë e jetës shoqërore në tërësi, jo thjesht veprimtari të atyre që rastisin të banojnë në qytete.

4. Sfera Private - Sfera Publike

Shumë lloje komunitetesh mund të zhvillohen me ndihmën e komunikimit dhe tiparet e tyre në bazë të situatave të komunikimit. Faktorë të shumtë marrin pjesë në formimin e situatave komunikuese: kushtet natyrore, zhvillimet teknologjike, media, aftësitë, njohuritë dhe synimet e pjesëmarrëve të situatës, pritjet paraprake ndaj komunitetit, dhe kështu me rradhë. Forca e organizimit, e cila bashkon faktorë të ndryshëm mund të jetë kryesisht natyrale (si për shembull në komunitetin e prindërve dhe fëmijëve), por mund të jetë edhe si rezultat i situatës që ka krijuar aktiviteti i njeriut (si në rastin e krijimit të miqësive apo politikave komunitare), forcat që formësojnë situatën janë shpërndarë dhe gjithashtu mund të kenë një rëndësi vendimtare: janë pjesëmarrësit që kanë kontrolluar situatën, apo ata i janë nënshtruar rrethanave që pa kushte veprojnë në këtë situatë? Me fjalë të tjera: janë njerëzit që marrin pjesë në komunikim të detyruar për të komunikuar në një mënyrë të caktuar, apo ata mund të ndikojnë apo formojnë karakteristikat e komunikimit me vendimet e tyre dhe në këtë mënyrë duke krijuar tiparet e komunitetit? Ekspertët e teknologjisë së komunikimit (klerikë, politikanë, profetërinj, artistë të caktuar, gazetarë, intelektualë, etj.) e dinë se si duhet vepruar për të ndërtuar dhe operuar situata, dhe ky mision social është më së shumti i tyre. Natyrisht, veprimtaria e inxhinierëve të komunikimit nuk ndodh në një vakum; presione historikisht sociale gjithashtu veprojnë në zgjedhjen e metodave të tyre. Kështu, forcat të cilat formojnë situata komunikimi punojnë në bazë të interesave dhe vlerave të ndërtuara mbi faktorët e natyrshëm. Sistemi i aplikuar i interesave dhe vlerave (botëkuptimi ideor, apo tërësia e pikëpamjeve mbi botën dhe njeriun; me fjalë të tjera: ideologjia) domosdoshmërisht vepron në situata, duke përfshirë aktivitetet fizike dhe mendore të palëve pjesëmarrëse në situatë. (Mendoni për shembull vlerën e natyrës së ngarkuar të gjendjeve që sigurojnë funksionimin e rregullt të institucioneve politike, proceseve të prodhimit, stilet artistike,

paradigmat shkencore, apo ceremonitë fetare). Si rrjedhim, zhvillimi i situatave gjithmonë ka dimensione morale dhe politike, aq sa ne nuk e konsiderojmë komunikimin ose ndonjë nga versionet e tij si neutrale po (eksperienca tona me imazhet teknologjike mund të sigurojnë një motiv të fortë për këtë), situata është aq e ngarkuar me vlera, dhe kjo i jep cilësi të errët. Nën një evoluim natyral komunikimi formon situatën politike. (Fromm E. 1994:160).

Ne mund të konsiderojmë një situatë si personale në qoftë se kontrolli i personit që komunikon është i plotë mbi vetë situatën. Diametralisht e kundërta e kësaj është gjendja e masave, ku kontrolli personal mungon plotësisht. (Në raste të tilla kontroll mbi situatën ushtrohet nga një institucion i përgjithshëm shoqëror ose publik). Ndër të tjera, kjo është arsyeja pse raporti në mes sferës private dhe publike shpesh është problematike, pasi niveli i një lloji të caktuar i kontrollit mund të vlerësohet dhe të interpretohet në mënyra të ndryshme. Një situatë e sferës publike ndërton individë të cilët i përkasin një komuniteti të caktuar dhe një situatë e publikut ndërton komunitetin i cili është i përbërë nga individë. Në të njëjtën kohë, vija kufitare në mes sferës private shpesh është problematike, pasi niveli i një lloji të caktuar të kontrollit mund të vlerësohet dhe të interpretohet në mënyra të ndryshme. Një situatë e sferës publike ndërton individë të cilët i përkasin një komuniteti të caktuar dhe një situatë e publikut ndërton komunitetin i cili përbëhet nga individët. Në të njëjtën kohë, vija kufitare në mes të sferës private dhe publicitetit gjithashtu e bën domosdëshmërinë e tyre të dukshme. Sfera personale dhe private nuk është vetëm e ndryshme për sa i përket nivelit të kontrollit, por situata e sferës private është gjithashtu e madhe dhe në zgjerim, ndryshe nga një situatë personale dhe kjo gjithashtu përfshin çështjet publike. Rasti është i ngjashëm në marrëdhëniet e publikut dhe masave: një situatë e publikut përmban çështje personale. Ne mund të shohim se zgjerimi i çështjeve personale përkon me sferën e kontrollit total mbi situatat personale dhe zgjerimi i çështjeve publike përkon me sferën e pamundësisë të kontrollit total mbi situatën. Kjo është një lidhje mjaft e natyrshme, pasi nga njëra anë bëhet fjalë për fushën e veprimtarisë individuale dhe nga ana tjetër, mbi sferën e bashkëpunimit të

nevojshëm mes individëve të tjerë. Opinioni publik i përfaqësuar nga një individ dhe opinioni publik është tërësia e mendimeve private – dhe të dyja janë rezultat i akteve komunikuese. Kontrolli që mund të arrihet në çdo situatë është plotësuar me përgjegjësi, nëse ne flasim për individët të cilët marrin pjesë në komunikim apo institucionet që përfaqësojnë çështjet publike. Herë pas here, diskutime morale mund të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve praktike të lidhura me të, në sferën personale private dhe publike; kryesisht linjat politike dhe ligjore të mendimit na ndihmojnë të kuptojmë çështjet e masave, publike dhe private.

Si rezultat i ndryshimeve strukturore, në sferën private dhe publike, tregohet një tendencë në interpretim; dallimet e tyre bëhen të paqarta dhe e gjithë sfera e komunikimit tregon karakteristikat e sferës private. Përhapja e të drejtave të autorit, p.sh., është një dëshmi e transformimit të marrëdhënieve të pushtetit të situatave të komunikimit dhe kjo sjell rëndësinë në rritje të pajisjeve të telekomunikacionit (kryesisht radios dhe televizionit) dhe në përgjithësi tendencat e zbatimit të papenguara të marrëdhënieve të tregut në situata të komunikimit. Individit është shndërruar në konsumatorin e opinionit publik dhe komunitetet janë shndërruar në komunitete të konsumit.

5. Përfundime

- Rritja urbane shfaq tipare të ndryshme si migrimi nga zonat rurale në ato urbane, mundësitë e punësimit në qendrat urbane, rritje e standardeve të jetës, lehtësira në transport dhe edukim.
- Individët zhvendosen në zonat urbane në mënyrë që të punojnë në industrinë e shërbimeve.
- Wirth propozoi një paradigmë të re akademike për jetën e qytetit si një konstrukt social
- Wirth insiston se banorët urbanë, në kontrast me zonat rurale, varen shumë nga ndërveprimet e përditshme me njerëzit, duke prodhuar kontakte të papërcaktuara, sipërfaqësore, kalimtare

- Jeta e qytetit karakterizohet nga izolimi dhe çrregullimi shoqëror dhe kjo vjen nga fakti që qytetet janë të mëdhenj, të dendur dhe heterogjenë, po të përdorim fjalët e tij.
- Sfera personale dhe private nuk është vetëm e ndryshme për sa i përket nivelit të kontrollit, por situata e sferës private është gjithashtu e madhe dhe në zgjerim, ndryshe nga një situatë personale dhe kjo gjithashtu përfshin çështjet publike

6. Bibliografia

1. Fromm Erich (1994) : *Escape Form Freedom.*, Henry Holt and Caompany, Owl Books Edition, New York NY, United States
2. Simmel Georg, "The Metropolis and Mental Life" (1903) in Gary Bridge and Sophie Watson, eds. *The Blackwell City Reader*. Oxford and Malden, MA;
3. Savage Mike, Warde Alan and Ward Kevin, *Urban Sociology Capitalism and Modernity*, Palgrave Macmillan 2003
4. Wirth, Loius. (1938), *Urbanism as a Way of Life* , American Journal of Sociology

Abstract

This article aims to provide the urbanization features based at the Chicago School, which takes in consideration the urban space and the land from a functionalist and management approach. The city is an industrial model organized around the urban approach in concentric circles. The article will also provide the views of Louis Wirth regarding the features and characteristics of urbanization. Wirth saw the city as a promotion of individualism. In other words, the people are pursuing their interests over those of others (interest group) in a city. Secondly, he saw the anonymity as a defining feature of the city. Urban residents do not know each other. For the people who live in urban areas the relations are characterized by what Wirth calls superficiality. This means that relationships are undefined. The urban life is chaotic and we have to interact with many people, but Wirth believes that this knowledge is only on a superficial level. In order to maintain close relationships with the people in the developed countries we should interact daily within the city to guarantee that our relations will not be superficial.

Keywords: *urbanization, city, Chicago School, population movement*



Dokt. Meri KRAJA
Kolegji Universitar "Wisdom",
Fakulteti i Drejtësisë.
merikraja@yahoo.it



Msc. Flutura SHABANI
Kolegji Universitar "Wisdom",
Fakulteti i Drejtësisë.
flutura.shabani@yahoo.com



SHPËTIMI I HEBRENJVE GJATË PERIUdhËS SË MONARKISË

Abstrakt

Ka ngjarje në historinë e njerëzimit që shënojnë epokat ose i venë vulën e tyre periudhave të ndryshme. Të mbrosh Izraelin do të thotë të ruash të drejtën e vetë ekzistencës së Izraelit. Një ekzistencë që është gjithmonë e kërcënuar çdo ditë e më tepër nga disa forma teokratike në Lindjen e Mesme. Është një fakt pak i njohur në historinë e gjatë të Holokaustit, që shqiptarët kanë mbrojtur hebrenjtë nga pushtuesit naziste, dhe se ata ishin në gjendje të mbronin hebrenjtë që vinin nga vendet e huaja.

Arsyeja e zgjedhjes së kësaj teme vjen nga dëshira për të kujtuar një faqe të historisë hebraike por dhe të historisë njerëzore, e shënuar në mënyrë tragjike nga martirët, eksodet dhe persekutimet. Kujtimi i tyre është një detyrim moral që kemi kundrejt këtij populli, ndaj ofendimeve të dinjitetit njerëzor, persekutimit të personave të pafajshëm, shfarosjes në masë e një race. Qëllimi i këtij kërkimi do jetë ti përgjigjemi pyetjes: kush i shpëtoi hebrenjtë në të vërtetë?

Objekti i kërkimeve do jenë motivet dhe mekanizmat sociale e morale që kanë karakterizuar këtë mbrojtje, si dhe kush e inicioi vendimin për të shpëtuar hebrenjtë. Kush krijoj frymën e duhur dhe kushtet e nevojshme për të hapur dyert dhe zemrat e Shqiptarëve për hebrenjtë në rrezik.

Kohët e fundit nga literatura bashkohore e huaj dhe në veçanti ajo italiane tentohet të ekzaltohet më tepër roli dhe politikat liberale antisemitiste italiane në Shqipëri, si dhe të lihet në plan të dytë roli i vërtetë i shqiptarëve në këtë histori.

Fjalët kyçe: *Holokaustit, Hebre, Pushtues, Mbretëri, mbrojtje.*

Abstract

Throughout human history, there have been many events that have put a mark on different periods. Protect Israel's right, means protect Israel's right to exist as a Jewish state. An existence which is each day threatened, by some more theocratic forms in the Middle East. In the long history of the Holocaust, it is not a well known fact, that Albanians have protected the

Jews from Nazi invaders, and they were able to protect the Jews who came from foreign countries.

The reason for choosing this topic comes out of a desire to remember a site of Jewish history but even of human history, marked by tragic martyrs, persecution and exoduses. Their memory is a moral obligation that we have towards the people to human dignity, insults, persecution of innocent people, of mass extermination of a race. The purpose of this research aims to respond to the question: who really saved Jews? The object of the research will be the social and the moral motives and mechanisms that have characterized this defense, and who initiated the decision to save Jews. Who created the proper spirit and the necessary conditions to open the Albanian doors and hearts for the threatened Jews. Recently in foreign contemporary literature, especially in the Italian literature, there is more focus on anti-Semitic Italian policies in Albania, and the real supporting role of the Albanians on this history is shadowed.

Hyrje

Të flasësh rreth historisë së hebrenjve nuk është e lehtë, sepse kudo në botë jo vetëm njohin një pjesë të mirë të saj, por hebrenjtë kanë dhe një opinion të mirë përcaktuar. Për një grup i cili nuk ka kaluar asnjëherë 1% të popullatës botërore⁵⁶ mund të konsiderohet dhe një privilegj, por për historianin është shumë e vështirë të mbajë distancën e duhur në qëndrimet e tij rreth "popullit të zotit", kur izraeli konsiderohet si pilastrë i civilizimit në brëndësi të Barbarive.

Historia e hebrenjve duhet të zhvillohet përtej këtyre horizonteve, në objektivat që i kemi përcaktuar vetes, disa periudha të kësaj historie tremijëvjeçare mund vetëm të citohen ndërsa të tjerat duhet të qëndrojnë jashtë saj. Por në kompleks do përqëndrohemi tek disa argumenta parësorë për temën tonë. Filli i kuq dhe i hollë që përshkruan këtë histori është emigrimi. Hebrenjtë nuk kanë qënë gjithmonë në emigrim por emigrazioni ka karakterizuar historinë e tyre për epoka të tëra.

56 Michael Brenner, "Breve storia degli ebrei", Donzeli Editore, Romë, 2009, fq10.

Ky punim ka si objektiv të rindërtojë në mënyrë të përmbledhur dhe shkurtimisht historinë herë pas here të tronditur të këtij vendi, duke u ndalur më gjatë nëperiudhën e Monarkisë, si dhe duke e treguar atë përmes një populli tjetër të vogël, atë të hebrenjve në Shqipëri. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, hebrenjtë u ndoqën u persekutuan me dëbime masive, por populli shqiptar edhe pse ishte vetë i robëruar, i strehoi ata, i ndihmoi dhe i përkrahi. Sot, Shqipëria është pjesë e listës së *"Të Drejtët Ndër Kombe"*⁵⁷, sepse ne sot mund të krenohemi me faktin që kemi shpëtuar të gjithë hebrenjtë në territorin tonë. Fenomeni i Holokaustit dhe i shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri nuk është njëçështje me të cilën ne duhet të mburremi, por të kërkojmë shpjegim se si ishte e mundur që populli më i varfër në Europë, i mbetur pa qeveri dhe i pushtuar për vite, arriti të kthehej në një model për mbrojtjen e një race në rrezik. Vitet që mbuluan periudhën 1928-1945 janë ato në të cilat anti-semitizmi u zhvillua në mënyrë të dhunshme dhe të tmerrshme në shumë pjesë të botës, me përjashtim të Shqipërisë. Shqipëria e këtyre viteve tragjike tregon se anti-semitizmi nuk është i pashmangshëm dhe se mund të ekzistojë një marrëveshje e vërtetë mes një kombi dhe pakicës që jeton në të.

Megjithëse punimet shqiptare na japin një vështrim të përgjithshëm të fenomenit të ardhjes së hebrenjve dhe të pranisë së tyre, ato nuk depërtojnë shumë në shkaqet e ardhjes së tyre, dhe ne njohim shumë pak rreth identitetit të tyre dhe mundësisë e faciliteteve të ndryshme që ju dhanë nga ana e Monarkisë. Ky punim tenton të ndërtojë, nëpërmjet dokumentave të arkivit, prezencën hebraike në shqipëri në periudhën e monarkisë, pra me qendrimet e qeverive dhe ushtrive pushtuese. Duke pasqyruar aspektin e shpëtimit të hebrenjve gjatë Holokaustit. Shifrat e pranisë së hebrenjve, e shpëtimit të tyre në trojet shqiptare ndryshojnë nga një autor te tjetri, ato nuk janë të përcaktuara plotësisht, mbasi studimet mbi to kanë filluar në dhjetëvjetëshin e fundit dhe ende nuk janë të përfunduara, falë vështirësive që hasen në shqyrtimin e mijëra dokumenteve të arkivave, por edhe të mos paraqitjes në dokumente të shumë veprimeve t'asaj kohe. Kjo pjesë

57 Norman Gershman *"BESA Një kod nderi Myslymanët Shqiptar që Shpëtuan Hebrenjtë Gjatë Holokaustit"*, http://ew.milliseagal.at/besa/besa_catalog_alb.pdf

e historisë shqiptare s' njihet mirë dhe nuk është trajtuar gjërësisht, tezat e fundit ngrenë pyetje mes rolit që pati mbretëria apo fashizmi? Sipas studiuesit Shaban Sinanit, kjo pjesë e historisë nuk është trajtuar gjërësisht nga frika se, duke njohur këtë realitet, mund t'i njihet tërthorazi ndonjë meritë edhe mbretërisë apo fashizmit⁵⁸. Në të vërtetë, kjo vetëm do ta nderonte historinë e vendit dhe asgjë më shumë.

1 - MISTERI QË I RRETHON

Për hebrejntë flitet shumë, në disa raste dhe tepër, sepse përbëjnë gjithnjë interes, nganjëherë dhe antipati, apo urrejtje, por kurrë indiferencë. Por gjithsesi ngelen të pa njohur dhe ndoshta, në këtë mister që i rrethon, zhvillohen, dhe janë zhvilluar në të kaluarën, shumë paragjykime që i kanë goditur dhe që akoma sot zgjaten këmbëngulës, mbase pa përgjigje.

Është opinion i përbashkët, edhe mes hebrejve, që populli hebre është persekutuar gjithmonë, por pas këtij afirmimi në aparençë të pafajshëm, fshihet një paragjykim: "*n.q.se kanë qënë gjithmonë të paragjykuar dhe të urreyer nga njerëzit një gjë duhet të kenë bërë për të merituar një fat të tillë!*".

Në të vërtetë ndër shekuj paragjykimet ksenofobe kanë marrë forma të ndryshme. Lindja e tyre ka qënë gjithmonë frut i dinamikave fetare, sociale, ekonomike dhe politike.

I konsideruar gabim si një fenomen historik antik, metafizik, dhe i pa oksidueshëm, antisemitizmi, krijesë perverse i një miksi iluminist, pozitivist e romantik, është në të vërtetë i vjetër vetëm njëqind vjet, por i demonstruar në shekullin e XX si një element i aftë, në bashkëpunim me totalitarizmin bashkohorë, për të favorizuar shfarosje dhe dhunë që janë të pa kuptueshme nga mendja njerzore.

Por, a ka vetëm një rrënjë urretje, e përcaktuar në fund të shek.XIX si "*Antisemitizëm*"?⁵⁹

58 Shaban Sinanit, "*Shqiptarët dhe Hebrejntë: mbrojtja dhe shpëtimi*", Studim monografik, Tiranë, Naimi 2009. Fq.144.

59 Abraham B. Yehoshua, "*Antisemitismo e sionismo*", Giulio Einaudi, Torino, 2004, fq 20.

Sipas interpretimit të bërë nga historianët, kalohet nga *Antihebraizmi*-tek *antijudaizmi*- dhe më pas tek *antisemitizmi*, i bazuar në teori pseodo-shkencore Naziste. Në të vërtetë duhet të pranojmë se në këtë tezë ka të verteta por dhe skematizime. Pa ushqyerjen e përhershme dhe të vazhdueshme të ndërgjegjes kolektive të vështimit antihebraik me baze antifetare, antisemitizmi nuk do të ishte zhvilluar në një masë kaq të madhe.

Gjithsesi, hebrenjtë nuk kanë qënë gjithmonë të persekutuar, ndër shekuj ka pasur periudha persekutimi por dhe të një bashkëjetese të lumtur dhe një ndërgjegje civile mes maxhorancës dhe minorancës hebraike (psh: rasti i Shqipërisë).

Pra edhe pse është e gabuar që të konsiderojmë antihebraizmin dhe antisemitizmin si fenomene të ndara dhe pa lidhje, sepse i përkasin epokave të ndryshme dhe bazohen në logjika të diferencuara, të dyja së bashku, patën implikime të forta politike të lidhura me ndërtimin dhe përforcimin e identitetit të një grupi individësh kundrejtë një tjetri, i përceptuar si i ndryshëm dhe i huaj pra i rrezikshëm.

Antisemitizmi modern i veshur me Antijudaizmin evropian të shekujve, solli në shek.XX tragjedinë e Shoah-së. Kur në 1933 Adolf Hitleri merr drejtimin e Gjermanisë dhe i jep jetë projektit të tij të çmendur për shfarosjen e Hebrenjve ka në dispozicion të tij mjaft materiale në të cilat mund të inspirohej. çdo tentativë e zvoglimit të përgjegjësisë nuk ka asnjë arsye të ekzistoj, ndërkohë që akoma pritet të ketë një ndërgjegjësim më të madh evropian mbi "*çështjen hebraike*"⁶⁰.

1.1 Hebrenjtë ndër shekuj

Po të trajtojmë historinë e hebrenjve ndër shekuj do shohim se çdo gjë fillon me një legjendë, që dëshmon se prezenca e tyre në Shqipëri daton që para 2000 vjetëve. Legjenda tregon se për shkak të një stuhie të fortë, një anije e nisur në drejtim të Romës me një ngarkesë me skllevër hebrenj të ardhur nga Palestina u devijua nga

60 Alessia Lirosi, "*Le radici storiche dell'antisemitismo Nuove fonti e ricerche*", Seminario organizzato dall'Università di Roma, "La Sapienza" e dall'Istituto Storico Germanico di Roma, 13-14 dicembre 2007, fq7.

stuhia dhe sklleverit zbarkuan në brigjet shqiptare⁶¹. Por kjo ngelet thjesht në limitet e një legjende. Në vitet 1979-1980, gjatë kërkimeve arkeologjike në Sarandë në një nga mjediset e një kishe që i përket shekujve V-VI e.s u zbuluan tre shtresa mozaikësh. Në një prej tyre spikati një fragment i një shandani hebraik i cili tregon për praninë e një sinagoge të hershme në këtë qytet dhe njëkohësisht edhe për praninë e qytetarëve hebrenj. Për praninë e hebrenjve në Iliri që në kohën e sundimit romak dëshmojnë edhe dokumente të tjera. Në vitet e fundit të shekullit XV, grupe të tjera hebrenjsh të ndjekur nga inkuizicioni Spanjoll e Portugez erdhën në Shqipëri në kohën e sundimit të Sulltan Bajazitit II. Për shkaqet e ardhjes së tyre ka mendime të ndryshme. Arsyetimi i bërë është se ata erdhën në Shqipëri sepse këtu do të gjenin shpëtim. Ndërsa disa historianë të tjerë tregojnë se në Arbëri i tërhoqi vetë Sulltan Bajaziti II me qëllimin që të gjallëronte tregëtinë në disa limane të vendit, siç kishte vepruar edhe Republika e Venedikut. Në të vërtetë historia tregon se në fund të viteve 1400 mjaft familje hebraike u larguan nga Spanja dhe u vendosën në Vlorë, Lezhë, Berat dhe limane të tjerë përtej kufijve të sotëm shtetërorë të Shqipërisë.

Duhet theksuar se për shekujt XVII-XVIII dokumentat që flasin për praninë e bashkësive hebraike në Shqipëri janë të pakta. Por kjo nuk përjashton mundësinë e shkrirjes së tyre me popullsinë vendase dhe mosdallimin e tyre nga autoritetet Osmane. Numri i hebrenjve filloi të rritej nga viti 1933. Gjatë këtyre viteve shumë hebrenj nga Gjermania, Austria, Polonia, Franca, Hungaria Italia etj., vërshuan për në Shqipëri. Një pjesë e tyre hynë fshehurazi, ndërsa një pjesë tjetër me viza në pasaporta, me synimin për të përdorur Shqipërinë si urë kalimi drejt SHBA-së e vendeve të tjera të sigurta, ose dhe për të qëndruar në Shqipëri.

61 Harvey Sarner, "Shpëtimi në Shqipëri, Njëqindpërqind e hebrenjve në Shqipërisë shpëtuan nga Holokausti", Tiranë 1998, fq 8

2 - KËRKESATPËR HYRJEN E HEBRENJËVE NË SHQIPËRI

Regjistrimi i parë i hebregjeve në Shqipëri është bërë në vitet 1923-1930. Sipas antropologut Dr. Jakov Milaj, nga të dhënat e këtij regjistrimi del se bashkësia e hebregjeve me banim të përhershëm në Shqipëri arrinte deri në afro 200 veta, banorë të këtij vendi⁶². Nga një dokument i Arkivit Qendror të Shtetit rezulton se aty nga viti 1930 kishin ardhur nga Greqia disa hebrenj, që e kishin deklaruar veten si shqiptarë.⁶³ Qysh prej vitit 1929, gjenden në arkivat e Mbretërisë Shqiptare kërkesa për shtetësi shqiptare nga emigrantë hebreg në vendin tonë. Por vihet re një shtim i lëvizjes së hebregjeve drejt Shqipërisë pas shpalljes së doktrinës së "Shfarosjes Përfundimtare" nga Hitleri dhe hyrjes në fuqi të ligjeve antisemite në vitet 1932-1933, dhe ku kërkohej, ndër të tjera, që të vendosej raca në pasaportë.

Në fakt, diplomacia shqiptare e kundërshtoi doktrinën naziste duke u mobilizuar për të strehuar ata që persekutoheshin në Gjermani, Austri por edhe në vende të tjera të Europës. Konkretisht, qeveria mbretërore shqiptare bëri gjithçka ishte e mundur për të shpëtuar hebregjtë dhe qëndrimet e saj ishin mirëpritur nga diplomacia botërore.

Në vitin 1934, Komisioneri i Lartë për Refugjatët pranë Lidhjes së Kombeve, Z. James Mac Donald, i kërkoi Mbretërisë Shqiptare nëse ekzistonte mundësia për vendosjen në Shqipëri të një numri hebregjsh nga Gjermania dhe menjëherë mori përgjigje pozitive. Sipas Dr. Patrice Najbor, 500 familje hebregje përfituan nga kjo ndihmë. Po atë vit, Herman Bernstein, që ishte ambasador i SHBA-ve në Tiranë gjatë asaj kohe, shkruante në gazetën njujorkeze "Jewish Daily Bulletin", se "nuk ekziston asnjë diskriminim kundër hebregjeve në Shqipëri, sepse Shqipëria është një ndër vendet e rralla të Europës së sotme ku paragjykimet fetare nuk ekzistojnë".

Po ashtu, Bernd Fischer ka relatuar biseditet dhe projekt-marrëveshjen e Ambasadorit Herman Bernshtajn me Ambasadorin e shtetit shqiptar në SHBA, Faik Konica, pikërisht për vendosjen

62 Jakov Milaj, "Raca shqiptare: Studim antropologjik e historik", Osmani, 1944, fq 89.

63 AQSH, F.152, V.1930, D.1352, Listë hebrenjsh nga Greqia të deklaruar si shqiptarë, 1930.

e 500 familjeve hebreje nga Evropa Qendrore për në Shqipëri, dhe vendi i instalimit ishte përcaktuar diku midis Drinit dhe Bunës. Bonifikimi i zonës do bëhej nga investime Hebrenje, por kjo marrëveshje nuk u realizua, madje as nuk u nënshkrua, për arsye të ndërhyrjeve që bëri Roma⁶⁴. Herman Bernstajn, i cili ishte vetë hebre, kishte bërë disa studime mbi hebrejtë në Shqipëri dhe qëndroi aktiv në çështjen e hebrenjve në Shqipëri deri në vdekjen e tij në vitin 1935⁶⁵. Gazetat e bashkësive hebraike të vendeve të ndryshme të Europës i kushtuan gjatë viteve '30-të një rendësi të veçantë Shqipërisë dhe strehimit që vendi ynë u ofroi hebrejeve.

Kështu, më 10 qershor 1935, gazeta "Moment" në Poloni botoi artikullin me titull "Hebrejtë ftohen të vendosen në Shqipëri", nga ku citohet mes të tjerash, se "qeveria shqiptare ka marrë një vendim të posaçëm, duke ftuar edhe hebrejtë e Çekisë dhe Gjermanisë", dhe se "qeveria e Mbretërisë së Shqipërisë është e gatshme të pranojë vendosjen e hebrenjve në vend dhe t'u ofrojë atyre kushtet e mundshme".

Të njëjtën gjë shkruanin edhe gazetat "Jewish Telegraphic Agency" dhe "Jewish Chronicle" në Angli, ndërsa gazeta britanike "Jewish Daily Post" shkruante më datë 14 korrik 1935 se "shërbimi diplomatik i Shqipërisë qysh prej një muaji ka njoftuar vendimin e Tiranës për pranimin e hebrenjve në vend".

Gjatë asaj kohe, por edhe në vitet në vazhdim në Mbretërinë Shqiptare, nuk gjendet në shtypin shqiptar asnjë qëndrim ose relativitet i një ngjarjeje anti-semite në vendin tonë.

Siç e pohon Prof. Monika Stafa, që ka studiuar qëndrimin e hebrenjve në Shqipëri në kohën e Mbretit Zog, "Tirana nuk miratoi asnjëherë ligje anti-semite; madje as vendime, as rregullore dhe asnjë akt me karakter racor"⁶⁶.

Nga ana tjetër, Ftesa e qeverisë shqiptare për instalimin e

64 Harvey Sarnet, "Shpëtimi në Shqipëri ,Njëqindpërqind e hebrenjve në Shqipërisë shpëtuan nga Holokausti",Tiranë 1998., fq 31.

65 B.Fisher, "Hebrejtë e Shqipërisë gjatë periudhës zogiste dhe Luftë së dytë Botërore" 2008, fq.202.

66 Gazeta "Atdheu mbi të gjitha Zog I",NR 2 -2016(683), 4 shkurt 2016 , fq 12.

hebrenjve që ishin në gjendje të derdhnin kapitale gjeti presion nga ana e qeverise Italiane, në Fletoren Zyrtare botoheshin vendimet dhe qëndrimet e shtetit shqiptar lidhur me strehimin e hebrenjve në Shqipëri, sa që, në vitin 1935, gazeta e famshme bullgare "*Pravda*" njoftonte se "*vullneti i qeverisë shqiptare për të pranuar hebrenjtë po kundërshtohet nga Italia*"⁶⁷. Në këmbim qeveria italiane siguroi dy koncensione të vlefshme në Shqipëri. Koncensioni i parë kishte të bënte me tokë shumë prodhuese të Shqipërisë, në të cilën do të stabilizoheshin bujq italianë për një afat prej 20 vjetësh, kurse koncensioni i dytë kishte të bënte me tri sipërfaqe të tjera, që ishin të destinuara për shfrytëzim mineralesh për 90 vjet⁶⁸.

Numri i i refugjatëve hebrenj të strehuar në Shqipëri, ose që kaluan nga Shqipëria pa rrezik gjatë kohës së Mbretit Zog, nuk është përcaktuar ende përfundimisht, por dihet se deri në prag të pushtimit të vendit nga Italia fashiste më 7 prill 1939, qindra ose mijëra prej tyre hynë në vendin tonë. Jutta Gerechter në kujtimet e veta për Shqipërinë gjatë viteve 1939-1945 shkruante se, Mbreti Zog pranoi t'u jepte të gjithë emigrantëve hebrenjë nënshtetësinë shqipëtare, por pushtimifashist e pengoi të realizonte atë vendim. Problemi i hebrenjëve në të vërtetë nuk ishte arritja në shqipëri, por t'u krijohej mundësia për të arritur diku tjetër nëpërmjet Shqipërisë. Mundësitë që të linin vëndine tyre pakësoheshin dita ditës.

Në vitet 1935 -1936 një grup hebrenjsh kërkuan të vinin në Shqipëri duke ofruar të bënin investime në fusha të ndryshme, por kërkesa e tyre mbeti në letër për shkak të ndërhyrjeve të Italisë fashiste. Sipas Z. Apostol Kotani , Doktor i Shkencës së Historisë, pengu i shqiptarëve ka qënë mos arritja e shpëtimit të hebreat të shquar Dr. Norbert Joklit (1877-1942), Profesor i Universitetit të Vjenës, një nga baballarët e albanologjisë dhe i dekoruar më 1937 me Urdhërin Skënderbeu.

Komuniteti hebre në Shqipëri u njoh zyrtarisht nga Zogu më

67 Po aty.

68 AMPJ, D.95, V.1939, fl.75. "*Jewish Chronicle*", dt.12.07.1935. Koncesionet e reja te dhanun italianve, dt.27.07.1935.

2 prill 1937. Ai i pranoi plotësisht hebrenjtë shqiptarë si pjesë e një komuniteti fetar⁶⁹. Në shtator të vitit 1937, ka të dhëna se nëpër Shqipëri po kalonte një grup hebrenjsh prej 54 vetash, të ardhur nga Polonia dhe Çekosllovakia, që ishin nisur nga Austria në mënyrë ilegale dhe arrin në Palestinë duke kaluar edhe nga Shqipëria⁷⁰. Marrëveshja dypalëshe e vitit 1938 midis Austrisë dhe Mbretërisë Shqiptare për heqjen e vizave ndërmjet dy vendeve, stimuloi ardhjen në Shqipëri të shumë familjeve hebrejsh, që rrezikonin jetën në Europë.

Studiuesit Dr. Apostol Kotani, Bernd Fisher dhe Martin Gilbert, evidentojnë se edhe në janar 1939 kishin hyrë në Shqipëri 100 hebrenj, bashkë me familjet e tyre, dhe poashtu edhe në shkurt. Ndërsa në mars të vitit 1939 kishin hyrë 95 familje.

Qeveria e mbretit Zog I, vuri disa kushte për hyrjen e Hebrenjëve në Shqipëri. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.367/67, datë 28.01.1939, çdo hebre i cili kërkonte të hynte në Shqipëri duhet të kishte me vehte jo më pak se 250 franga ari ose valutë të huaj me këtë vlerë. afati i vizës ishte vetëm për një muaj, por me afat shtyerje dhe për një muaj tjetër dhe pas këtij afati të largoheshin nga toka Shqipatre. ⁷¹ Përveç vizës kishte edhe një dokument tjetër, që ishte karta turistike, e cila merrej në prefekturë. Këto karta ndryshe nga vizat nuk paguheshin.⁷²Vërshimi i hebrenjve në shqipëri në këto vise tërhoqi vëmëndjen dhe rriti ndërhyrjen e qeverisë Fashiste Italiane. Për këtë fakt, Konsullata Shqipëtare e Romës në aktin Nr. 184/1, datë 01.02.1939, i shkruante Ministrisë së Punëve të Jashtme në Shqipëri se:“ *Kemi përshtypjen se qeveria Italiane nuk e sheh me sy të mirë grumbullimin e Hebrenjëve në tokën tonë, sidomos vendosjen e tyre*”.

69 B.Fisher, “*Hebrenjtë e Shqipërisë gjatë periudhës zogiste dhe Luftës së dytë Botërore*” 2008, fq.202.

70 Rudolf M. Wlaschek, “*Juden in Böhmen: Beiträge zur Geschichte des europäischen Judentums im 19. und 20. Jahrhundert*“, 2, vollst, R. Oldenbourg, 1997 - Bohemia (Czech Republic) fq 138.

71 AQSH, F. 346, V. 1939, D.107, fq.1. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.118 më Dt.28.01.1939.

72 AQSH,F.346,D.107,fl11, Mbi kartat turistike.

Edhe studiuesi Robert Elsie pohon se, " *deri në vitin 1939, Ambasada e Shqipërisë në Berlin pajiste hebretë me viza*"⁷³. Madje, Sir Martin Gilbert shënon në librin e vet " *Winston Churchill: profeti i të vërtetës*", se një emisar i Mbretit Zog kishte takuar Churchillin në fillim të vitit 1939 për t'i propozuar që Shqipëria të bëhej vend strehimi për hebretë, dhe se për të realizuar këtë qëllim, Churchilli do të duhej të frenonte oreksin e Musolinit dhe të garantonte pavarësinë e Shqipërisë.

Dr. Patrice Najbor thot se rreth 2.000 hebrenj kanë hyrë në Shqipëri para LDB, ndërsa Bernd Fischer e kufizon këtë numër në rreth 800 vetë, pavarësisht se, po Fischer, flet për " *vite të arta për hebretë në Shqipëri gjatë periudhës mbretërore*"⁷⁴. Hebrenjtë e ardhur në Shqipëri megjithëse nuk kishin probleme në lidhje me antisemitizmin, duhet të përmendet këtu qëurvejoheshindhe si dëshmi për këtë kemi një listë emërore të periudhës 21.01.1938-11.12.1938, të hebrenjve të ardhur në prefekturën e Korçës e cila përmban edhe shënime mbi lëvizjet dheurvejimin e tyre.⁷⁵

Në fakt Mbreti Zog I kishte marrë shumë kërkesa personale nëpërmjet letrave që hebretë e rrezikuar në vendet e tyre i kërkonin strehim në Shqipëri, siç është rasti i Dr. Martin Gottlif nga Gjermania dhe Richard Atlas nga Austria. Qeveria e Zogut mori pjesë aktive në sjelljen e hebrenjve në Shqipëri, dhe ishte gjithashtu e interesuar për mirëqenien e tyre sapo ato të arrinin.

Poashtu, edhe shkrintari gjerman Dr. Leo Mathia dhe artisti izraelit Joli Jakov, gjetën strehim në Shqipëri. Supozohet se edhe fizikanti dhe shkencëtari Albert Einstein kaloi nëpërmjet Shqipërisë në vitin 1930, para se të largohej për në SHBA-të. Pavarësisht se ende nuk është vërtetuar vizita e tij me prova të pakontestueshme, mjaft studiues besojnë se ai ka vizituar Shqipërinë dhe kërkimet e studimet rreth kësaj çështjeje vazhdojnë.

73 Robert Elsie, " *A dictionary of Albanian religions, mythology and folk culture*", Hurst & Compani, London, 2001, UK, fq 33.

74 Gazeta, " *Atdheu mbi të gjitha Zog I*", NR 2 -2016(683), 4 shkurt 2016 , fq 12.

75 Nevila Nika e Liliana Vorspi, " *Gli ebrei in Albania, Catalogo dei documenti dell' Archivio Centrale di Stato della Repubblica d'Albania*", Progedit snc, Bari, 2006. f 24.

2.1 Hebrenjtë klandestin në shqipëri

Por hebrenjtë arritën të hynin në truallin shqiptarë edhe me dokumenta falco, ku dhe u strehuan nga familjet shqiptare. Ndihmesë në paisjen me dokumente falco u kanë dhënë shqiptarët me banim në Shkup, Manastir, Tetovë, Prishtinë, etj., Kjo del qartë edhe nga njoftimi i Kuesturës Mbretërore në Tiranë ku i bënte me dije Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë me shkresën e saj Nr. 02251, datë 04.08.1943 se: " me letërnjoftime falco të marra në Bashkinë e Prishtinës kanë hyrë në Tiranë hebrenjtë Pepo Moreno, Sabi Moreno, Isak Ruben Emanuele, Menahem Ruben Emanuele"⁷⁶. Në arkivat e shtetit shqiptarë gjejmë një listë të gjatë të rasteve të tilla.

Kishte raste që hebrenjtë për këtë kalim paguanin deri në 2000 lev (5 napoleona)⁷⁷, apo 4000 lev (10 napoleona), për person duke ndjekur itinerarin Tetovë-Gostivar e më tej për të hyrë pastaj në Shqipëri⁷⁸. Kishte raste, ku hebrenjtë për t'u larguar nga Maqedonia (Bullgaria) dhe për të hyrë në Mbretërinë Shqiptare, ndihmoheshin nga ndonjë nëpunës bullgar i hekurudhës, në shkëmbim të pagesës prej 500-600 levash bullgare, kështu ata hipnin dhe fshiheshin nëpër vagona për transportimin e kafshëve dhe shkonin në Ferizaj⁷⁹. Në Ferizaj dhe në Prishtinë ekzistonte edhe një rrjet tjetër që bënte pajisjen hebrenjve me dokumente identiteti false dhe kostoja, sipas një dokumenti arkivor të vitit 1943, shkonte mbi 1000 napoleona.⁸⁰

Ka akoma zëra që pretendojnë se vendimet dhe qëndrimet e Mbretërisë Shqiptare kundrejt hebrenjve ishin të interesuara për arsye të nevojave të zhvillimit ekonomik të shtetit shqiptar. Nuk vihet në

76 A. Kotani, "Shqipëtarë dhe Hebrenjtë në shekuj". Shoqata e miqësisë Shqipëri-Izrael, Mësonjëtorja, Tiranë, 2007, f. 55.

77 AQSH, F.153, V.1943, D.386, fl.114, Albala jak di benvenuto e di Levi Rachele, nato a Monastir il 4.9.1925, domiciliato a Skopie, qui residente in Via Durrazzo Vecchia 17, Suddito bulgaro, ebreo, dt 26.6.1943.

78 AQSH, F.153, V.1943, D.386, fl. 191, Dichiarazione di Batta Romano nella Polizia, dt 14.6.1943.

79 AQSH, F.153, V.1943, D.386, fl.201, ProcesVerbambi deklarimet e David Samuel, dt. 30.6.1943.

80 AQSH, F.153, V.1943, D.386, fl. 264, Isak Aroesti e Salomon Aroesti denunciati perché tentativo fornirsi di documenti falsi d'identita con l'intervento dei nominati Bajram Dobruna, commerciante da Prishtina e Lah Sheh Dadi da Ferizaj, dt 30.05.1943.

dyshim pragmatizmi i Mbretit Zog I në drejtimin e shtetit shqiptar, por analiza objektive e fakteve tregon se ishte një pragmatizëm në interes të vendit dhe kombit shqiptar, pasi mund të kishte rrezikuar më pak personalisht nga Italia. Kemi të gjitha arsyet të besojmë se ndikimin vendimtar për të shpëtuar hebrenjtë e inicioi Mbreti Zog I dhe Qeveria Mbretërore, pasi ata krijuan frymën e duhur dhe kushtet e nevojshme për të hapur dyert dhe zemrat e Shqipërisë dhe Shqiptarëve për hebrenjtë në rrezik.

KONKLUSIONE

Vetëm disa vjet pas formimit të shtetit të parë shqiptarë në 1912, ku edhe të drejtat e vetë shqiptarëve nuk ishin krijuar në tërësinë e tyre, shqiptarëve ju duhej të ballafaqoheshin me problemin e mbrojtjes së hebrenjëve, të cilët deri atëherë kishin jetuar në harmoni të plotë me qytetarët shqiptarë. Në këtë situatë, shqiptarët pa dallim feje apo origjine, mbajtën një qëndrim të dobishëm, duke siguruar mbrojtjen e të gjitha familjeve të hebrenjve që ishin brënda vendit, madje edhe të atyre që erdhën më vonë. Populli shqiptar i mirëpriti hebrenjtë e ndjekur dhe të përsekutuar, u krijoi atyre kushte për t'u strehuar.

Në muzeun e Jeruzalemit, Yad Vashem, populli hebre ka nderuar 63 shqiptarë të cilët mbrojtën hebrenjtë, duke i nderuar ato edhe me tituj nderi. Qëllimi kryesor i marrjes së vendimit për të ndërtuar Yad Vashem ishte krijimi i një përkujtimeje për ruajtjen e kujtimit të gjashtë milionë hebrenjve, viktimat të Holokaustit. Yad Vashem është projekti i vetëm i këtij lloji në botë. Ai nderon individët që shpëtuan hebrenjtë gjatë luftës. Prej vitit 1963, ju ngarkua detyra e dhënies së çmimit "*Të Drejtët Ndër Kombe*", një komisioni të drejtuar nga një gjyqtar i Gjykatës së Lartë të Izraelit, detyra e të cilit është të kontrollojë me hollësi të gjitha dokumentat mbi çështjet që shqyrton. Komisioni konsideron edhe faktet që jepen nga të mbijetuarit apo dëshmitarët okularë. "*Të Drejtët Ndër Kombe*" janë simbol i ruajtjes së vlerave njerzore-kundër çthurjes absolute morale të njerzimit .

Roli i Mbretit Zog u vlerësua nga vetë Shteti i Izraelit duke e dekoruar me rastin e Ditës së Përkujtimit të Holokaustit, më 27 janar, për kontributin e veçantë në shpëtimin e hebrenjve. Shqipëria

dhe populli shqiptar konsiderohen nga opinioni botëror si një rast unik në qëndrimin që mbajten ndaj hebrenjve gjatë luftës së dytë Botërore dhe pushtimit fashist, jo vetëm duke mirëpritur, ruajtur hebrenjtë e shpërngulur dhe të ardhur këtu gjatë luftës, por edhe duke mos denoncuar pranë autoriteteve pushtuese naziste asnjë prej tyre. Gjurmët e kësaj urrejtje për fat të keq nuk janë zhdukur ende. Njerezimi hyri në shekullin e 21, ende me hijen e holokaustit, ky fenomen vërtitet akoma nëpër botë.

BIBLIOGRAFIA.

- A.Kotani, *"Shqipëtarët dhe Hebrejtë në shekuj"*. Shoqata e miqësisë Shqipëri-Izrael, Mësonjëtorja, Tiranë, 2007.
- Abraham B. Yehoshua, *"Antisemitismo e sionismo"*, Giulio Einaudi, Torino, 2004.
- Alessia Lirosi, *"Le radici storiche dell'antisemitismo Nuove fonti e ricerche"*, Seminario organizzato dall'Università di Roma, *"La Sapienza"* e dall'Istituto Storico Germanico di Roma, 13-14 dicembre 2007.
- B.Fisher, *"Hebrejtë e Shqipërisë gjatë periudhës zogiste dhe Luftës së dytë Botërore"* 2008.
- Gazeta *"Atdheu mbi të gjitha Zog I"*, NR 2 -2016(683), 4 shkurt 2016.
- Harvey Sarner, *"Shpetimi në Shqipëri ,Njëqindpërqind e hebrevje në Shqipëri të shpëtuar nga Holokausti"*, Tiranë 1998.
- Jakov Milaj, *"Raca shqiptare: Studim antropologjik e historik"*, Osmani, 1944.
- Michael Brenner, *"Breve storia degli ebrei"*, Donzeli Editore, Romë, 2009.
- Nevila Nika e Liliana Vorspi, *"Gli ebrei in Albania ,Catalogo dei documenti dell'Archivio Centrale di Stato della Repubblica d'Albania"*, Progedit snc, Bari, 2006.
- Robert Elsie *"A dictionary of Albanian religions, mythology and folk culture"*, Hurst&compagn, London, 2001,UK.
- Rudolf M. Wlaschek, *"Juden in Böhmen: Beiträge zur Geschichte des europäischen Judentums im 19. und 20. Jahrhundert "*, 2., vollst , R. Oldenbourg, 1997 - Bohemia (Czech Republic)

BURIME ARKIVORE

- AMPJ, D.95,V.1939, fl.75. *"Jewish Chronacle"*, dt.12,07,1935. Koncesionet e reja te dhanun italianve, dt.27.07.1935.
- AQSH,F.152,V1930,D.1352, Listë hebrenjsh nga Greqia të deklaruar si shqipëtarë,1930.

- AQSH,F.153,V.1943,D.386, fl. 264, IsakAroesti e Salomon Aroesti, Denunciatiperche tentativo fornirsi di dokumenti falsi d`identita con l'intervento dei nominati Bajram Dobruna, commerciante da Prishtina e LahSheh Dadi da Ferizaj, dt 30.05.1943.
- AQSH,F.153,V.1943,D.386, fl.201, proces Verbalmbideklarimet e David Samuel, dt. 30.6.1943.
- AQSH,F.153,V.1943,D.386, fl.201, Proces Verbal mbi deklarimet e David Samuel, dt. 30.6.1943.
- AQSH,F.153,V.1943,D.386,fl114,Albala jak di benvenuto e di Levi Rachele, nato a Monastir il 4.9.1925, domiciliato a Skopie, qui residente in Via DurrazzoVechia 17, Suddito bulgaro, ebreo, dt 26.6.1943. AQSH,F.153,V.1943,D.386,fl 191, Dichiarazione di Batta Romano nella Polizia, dt 14.6.1943.
- AQSH,F.153,V.1943,D.386,fl114, Albala Jak di benvenuto e di Levi Rachele, nato a Monastir il 4.9.1925, domiciliato a Skopie, qui residente in Via DurrazzoVechia 17,Suddito bulgaro, ebreo, dt 26.6.1943.
- AQSH,F.153,V.1943,D.386,fl 191, Dichiarazione di Batta Romano nella Polizia, dt 14.6.1943.
- AQSH,F.346,D.107,fl11,Mbi kartatturistike.
- AQSH,F.346,V.1939,D.107,fq.1.Vendim i Këshillittë Ministrave nr.118 më, dt. 28. 01. 1939.



MSc. Julvina GJERMENI

**MËSIMDHËNIA E GJUHËS
SË HUAJ NË KLASAT
MULTIKULTURORE**

"Do të të duhet i gjithë fisi për të mësuar një fëmijë."

Thënie afrikane

Prej shekujsh me radhë, vendet europiane kanë pakica të popullatës me kulturë dhe prejardhje të ndryshme dhe disa prej tyre hasin disavantazhe sociale dhe ekonomike. Për shkak të prejardhjes së tyre, diversitetit kulturor, traditave dhe rregullave etike apo morale, këto grupe ngurrojnë të integrohen në klasa apo të përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës së mësimit. Mësimdhënësi duhet të përftoj trajnimin përkatës në mënyrë që të jetë i aftë t'i aktivizoj studentët dhe të zotërojë metoda e teknika që lehtësojnë procesin e gjithëpërfshirjes së studentëve në arsim pavarësisht diversitetit multikulturor në klasa.

Qëllimi

Ky ministudim ka për qëllim të gjejë përgjigje për pyetjet:

1. Si të aktivizojmë të gjithë nxënësit në klasë pa dallim gjuhe apo prejardhjeje?
2. Cilat aktivitete apo metoda mësimdhënie do ta lehtësonin procesin e gjithëpërfshirjes së nxënësve në klasë në orën e gjuhës së huaj?

Objektivat

Punimi i paraqitur në këtë artikull ka si synim që:

- të analizojë sjelljen dhe
- përfshirjen e nxënësve në klasa me përbërje heterogjene.
- të testojë aktivitete apo metoda mësimdhënie që lehtësojnë procesin e gjithëpërfshirjes së nxënësve në klasë në orën e gjuhës së huaj?

Gjetjet

Nxënësit në shkollën "M. e T." në Tiranë, në orën e gjuhës së huaj (gjuhë angleze), vijnë nga shtete të ndryshme të Ballkanit

e Azisë, si dhe nga krahina të ndryshme të Shqipërisë. Për një bashkëjetesë të shëndetshme dhe edukim të sukseshëm duhet të përdoren metoda dhe teknika interaktive. Këto metoda lehtësojnë procesin e të nënit dhe mësimdhënies.

Nga ana tjetër, ato i japin mundësi studentëve të ndjehen të pranuar dhe të përfshirë në proces, të bashkëveprojnë dhe të vlerësojnë njëri-tjetrin për vlerat e tyre si individë dhe qenie sociale.

Kufizime

Gjetjet mund të jenë të ndryshme për një numër të ndryshëm nxënësish në një shkollë tjetër, apo sjellja e tyre mund të jetë e ndryshme në varësi të aktorëve pjesëmarrës, klimës në klasa dhe përbërja e klasaës. Gjithashtu, vëzhgimi është kryer në një afat kohor 1 (një) mujor. Ky rezultat mund të jetë variabël në kushte të tjera.

Sidoqoftë, është e nevojshme që nxënësve t'u jepet kohë e mjaftueshme që të kuptojnë aktivitetin e përbashkët dhe të familjarizohen me kërkesat apo punën në grup.

Metodologjia dhe Literatura

Për këtë ministudim u përdor metoda cilësore e përshkrimit dhe analizës. Gjatë këtij hulumtimi u përdorën burimet parësore të vëzhgimit dhe mbajtjes së shënimeve përpara, gjatë dhe pas aktiviteteve. Nëpërmjet tyre u bë e mundur analiza e të dhënave të përfutuara.

Gjithashtu, hulumtimi u bazua në burime dytësore për të ngritur pyetjet dhe për të krahasuar gjetjet.

Shqyrtimi i Literaturës

Çdo mësimdhënës duhet të identifikojë elementët kyç për edukimin multikulturor dhe sipas Zeichner-it janë 12 të tillë (Zeichner, 1995).

Sipas Kushner-it (Kushner, 1998) edukimi multikulturor (edukimi ndërkulturor) kërkon të kuptojmë diferencat dhe

ngjashmëritë kulturore në mënyrë që të bashkëpunojmë me të tjerët, kështu shoqëria pluraliste mund të jetë një mundësi si për grupet e pakicave ashtu dhe për shumicën.

Nga ana tjetër, mjaft broshura apo dokumenta (Advancing 2007; Goals 2009) nxjerrin në pah nevojën e mësimdhënësve për t'u trajnuar mbi mësimdhënien dhe edukimin ndërkulturor.

Sipas NAME - Shoqata Kombëtare e Edukimit Ndërkulturor në SHBA e përkufizon edukimin multikulturor si një proces që mundëson të gjitha aspektet e praktikave shkollore, politikat dhe organizatat duke i shndërruar në instrumenta të sigurimit të nivelit më të lartë të arritjeve akademike të studentëve.

Përfundime

Nga ky hulumtim rezulton se:

1. studentët përshtaten shumë mirë kur klasa ka klimë pozitive dhe sjellja nuk është diskriminuese ndaj ndryshimeve për shkak të prejardhjes së tyre ose elementëve të tjerë multikulturorë.
2. puna në grupe interaktive është një strategji shumë efektive për t'u përballur me diversitetin dhe për t'u ofruar mundësi dhe shanse të barabarta studentëve pavarësisht moshës së tyre.
3. aktivitetet dhe projektet interaktive inkurajojnë zhvillimin e të menduarit kritik dhe respektin ndaj diversitetit.
4. vlerësimi i çdo ore nga mësuesi, studenti apo udhëheqësi i grupit të studentëve, ndihmon matjen e ecurisë dhe integritetit të secilit prej studentëve.

Bibliografia

- Banks J. (1999). *An introduction to multicultural education*, Allyn & Bacon, Boston.
- Freire P. (1995), *Pedagogy of the Oppressed*, Continuum, New York.
- Gheorghe N., Liegeois J. P. 1995) , *Roma/Gypsies: A European Minority*, Minority Rights Group, UK, <http://www.edu.ro/index.php?>
- UNESCO (2005), *Guidelines for Inclusion: Ensuring Access to Education for All*, United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization, Paris, available at: <http://unesdoc.unesco.org/images/0014/001402/140224e.pdf>, July 2009.



Dr. MBA. MSc. Enriko CEKO
enrikoceko@yahoo.co.uk



**MANAXHIMI I CIKLEVE TË
BIZNESIT PËR PERIUDHËN
1993 - 2017.
RASTI I SHQIPËRISË**

Përmbledhje

Qëllimi i kërkimit: Ky kërkim ka si qëllim të vërtetojë hipotezën se ciklet e biznesit në Shqipëri për periudhën 1993 – 2017 kanë qenë rënie dhe të përcaktojnë arsyet e dukurisë së cikleve të biznesit në ekonominë shqiptare dhe parametrat me të cilat maten ciklet e biznesit në të tëra fazat e këtyre cikleve dhe të tregojë disa mënyra dhe mjete për të evituar apo reduktuar në të ardhmen impaktin e cikleve të biznesit në ekonominë shqiptare, duke i manaxhuar ato. Gjithashtu, në këtë studim synohet të përshkruhen në kushtet e ekonomisë shqiptare të katër llojet e cikleve të biznesit.

Metoda: Mbledhje të dhënash, shifrash, faktesh, informacioni, në lidhje me indikatorët e cikleve të biznesit (indikatorë paraprirës, që ecin paralel e që passhoqërojnë ciklet e biznesit), përpunim i tyre, bërje krahasimesh, bërje arsyetimesh deduktive e induktive, nxjerrje konkluzionesh dhe rekomandimesh.

Rezultatet: Ekonomia jonë është nën influencën e cikleve të biznesit. Kur ciklet e biznesit janë në rënie, vështirësia e ekonomisë shqiptare shfaqet në rritjen e nivelit të papunësisë, ndërsa në rastin kur ciklet e biznesit janë në rritje, parametrat makroekonomikë janë nën kontroll.

Konkluzion: Ekonomia shqiptare ka nevojë për rritje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë, duke manaxhuar ciklet e biznesit dhe jo thjesht një mirëmbajtje të parametrave makroekonomikë.

Fjalët çelës: ciklet e biznesit, ekonomia shqiptare, rritja ekonomike e qëndrueshme

BUSINESS CYCLES MANAGEMENT FOR PERIOD 1993 - 2017. CASE OF ALBANIA

Dr. MBA. MSc., Enriko CEKO

Abstract

Aim of investigation: This research aims to verify the hypothesis that business cycles in Albania are decreasing and to determine the reasons for the phenomenon of business cycles in the Albanian economy, which parameters should be measured during different phases of these cycles and to show some ways and means to avoid or reduce the future impact of business cycles in the Albanian economy, managing them. Also, this study aims to describe the Albanian economy in terms of four types of business cycles.

Method: Collection of data, figures, facts, information regarding indicators of business cycles (foregoing, parallel and post business cycles' indicators), processing them, making comparisons, using inductive and deductive reasoning, conclusions and recommendations extrusion.

Results: Our economy is under the influence of business cycles. When business cycles are decreasing, the difficulty of the Albanian economy displayed with an increasing unemployment, while, when business cycles are growing, macroeconomic parameters are under control.

Conclusion: Albanian economy needs a long term sustainable economic growth, managing business cycles and not a simple maintenance of macroeconomic parameters.

Key-words: business cycles, Albanian economy, sustainable economic growth

HYRJJE

Termi cikle biznesi i referohet luhatjeve që pëson veprimtaria e biznesit në përgjithësi, ekonomia e një vendi apo e disa vendeve së bashku apo edhe luhatjet e prodhimit në një kohë të caktuar. Këto luhatje duhen manaxhuar në mënyrë që ato të mos jenë të mëdha dhe të mos ndikojnë në ekonomi, në biznes dhe në jetën tonë të përditëshme. Luhatjet shfaqen përgjatë prirjes afatgjatë të ekonomisë për rritje dhe ndodhin midis periudhave të rritjes e zhvillimit ekonomik dhe stanjacionit, recesionit apo rënies së biznesit, ekonomisë e prodhimit. Një cikël biznesi është një sekuencë e aktivitetit ekonomik të bizneseve dhe ekonomisë së një vendi. Ecuria në kohë e cikleve të biznesit ndryshon dhe mund të jetë nga dy në dymbëdhjetë vite, me një kohëzgjatje mesatare rreth gjashtë vjeçare. Edhe pse emërtohen cikle, këto luhatje në aktivitetin ekonomik nuk ndjekin ndonjë mekanizëm apo mënyrë të parashikueshme veprimi dhe ndodhjeje, ngjasin kohë pas kohe, me intensitet të ndryshëm dhe për arsye nga më të ndryshmet. Rritja ekonomike dhe sidomos rritja ekonomike afatgjatë varet nga burimet dhe elementet e produktivitetit që janë: toka, puna, kapitali, shpirti sipërmarrës, avancimi teknologjik, etj, të cilat, në kohë të ndryshme përdoren në mënyra të ndryshme. Mënyrat e ndryshme të përdorimit të burimeve dhe elementeve të produktiviteti mendohet se janë një nga arsyet e përsëritjes së cikleve të biznesit. Ciklet e biznesit janë valë të alternuara të ekspansionit dhe kontraktimit të aktivitetit ekonomik dhe të biznesit. Ciklet ndodhin në mënyrë simultane përgjatë pjesës më të madhe të sektorëve të ekonomisë dhe biznesit. Dy cikle biznesi nuk janë njësoj. Në përgjithësi ciklet e biznesit nuk ngjasin në detaje me njëri tjetrin.

FAZAT E CIKLIT TË BIZNESIT

Cikli i biznesit karakterizohet nga katër faza që janë: Faza I: Rënia, Recesioni apo Kontraktimit, Faza II: Pika fundore e ciklit. Faza III: Ekspansioni ose rritja dhe Faza IV: Pika kulmore e rritjes.




Figura 1. Paraqitje grafike e cikleve të biznesit

Rënia ose recesioni është një periudhë e reduktimit të aktivitetit ekonomik në të cilin nivelet e blerjes, shitjes, prodhimit dhe punësimit zvogëlohen. Recesioni i zgjatur quhet depresion. Recesioni është kontraktim i biznesit dhe ecurisë ekonomike. Është faza që shënon mbarimin e fazës së pikut të ecurisë së mirë ekonomike. Në këtë fazë ka një rënie të nivelit të blerjeve konsumatore, prandaj firmat për reagim dhe si përgjigje ndaj tregut reduktojnë prodhimi. Në këtë fazë ka një rënie të GDP-së reale për një periudhë dy a më shumë tremujorë. Është karakteristike se në këtë fazë, kur rënia është e konsiderueshme, edhe vetë njerëzit e biznesit i reduktojnë shpenzimet e tyre personale. Meqënëse shitjet bien, bizneset bëjnë të tëra përpjekjet për të ulur shpenzimet. Reduktohen shpenzimet për punonjësit, blihen më pak makineri, bëhen më pak shpenzime për marketimin e produkteve dhe shtyhen planet për zgjerim aktiviteti. Meqënëse punonjësit marrin më pak, shpenzojnë më pak dhe për pasojë të ardhurat e biznesit në përgjithësi dhe fitimet në tërë ekonominë e vendit reduktohen. Bizneset vazhdojnë të shpenzojnë edhe më pak se më parë dhe kështu ekonomia shkon poshtë e më poshtë.

Pika fundore e ciklit të biznesit është një gjendje e ekonomisë ku papunësia shtohet me ritme të larta, ka një rënie të të ardhurave dhe rënie të prodhimit. Kjo është pika më e ulët e tërë ciklit të biznesit, dhe

vetëm pas kësaj faze fillon rritja e GDP-së. Kohëzgjatja e gjendjes së pikës më të ulët të ciklit të biznesit është në varësi të mjaft faktorëve, por kjo gjendje zgjat nga disa javë e muaj deri në disa vjet.

Rritja e ciklit të biznesit fillon me marrjen e kthesës nga rënia drejt rritjes ekonomike dhe është pika në të cilën objektivi është përmirësimi i gjendjes financiare. Kjo periudhë karakterizohet nga rritja reale e GDP-së dhe nga marrja e vebes pas periudhës së vështirë të recesionit. Sapo biznesi e kupton se është përmirësuar disa situata, ai fillon të marrë njerëz në punë dhe të shtojë porosinë për materiale e pajisje. Kjo bën që firmat të rritin prodhimin dhe të rimarrin edhe më shumë punonjës në punë në vazhdimësi. Në këtë fazë pothuajse çdo gjë që lidhet me ecurinë e bizneseve është në ekspansion.

Kulmi pozitiv i ciklit të biznesit është në esencë ekspansioni i qendrushëm ekonomik. Në këtë pikë rritet besueshmëria dhe konfidenca e konsumatorëve ndaj tregut dhe kjo do të thotë më shumë aktivitet biznesi. Meqënëse ekonomia tenton që të operojë me kapacitetin e saj të plotë, periudha e rritjes karakterizohet edhe nga një farë presioni inflacionist, sepse çmimet tentojnë të rriten disa për shkak se rritet edhe fuqia blerëse dhe e tërë kjo sipas ligjit të kërkesës dhe ofertës. Në këtë pikë GDP-ja stopon rritjen dhe ekspansioni i biznesit arrin pikën përtej së cilës nuk mund të ketë më ekspansion. Punësimi, shpenzimet konsumatore dhe prodhimi arrijnë nivelin më të mundshëm të lartë. Edhe kjo pikë kulmore mund të zgjasë nga disa javë e muaj deri në disa vite dhe kjo është në varësi të mjaft faktorëve. Kur pika kulmore arrin të mbahet e tillë për një kohë të gjatë, atëherë kemi të bëjmë me një periudhë prosperiteti. Rreziku kryesor i periudhës së kulmit pozitiv është inflacioni sepse çmimet tentojnë të rriten dhe vlera e parasë tenton të ulët. Ky është një kërcënim sepse ndikon më tej në uljen e punësimit dhe fitimeve.

SHKAQET DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË CIKLET E BIZNESIT

Për shumë kohë njerëzit dhe midis tyre edhe ekonomistët, politikanët, sociologët dhe të tjerë janë përpjekur që të kuptojnë dhe

mësojnë se përse ka ulje dhe ngritje në ekonominë kombëtare. Këtu, në këtë pikë dy janë pyetjet më të rëndësishme: 1). Në ç'farë faze të ciklit të biznesit ndodhet ekonomia? 2). Ku po shkon cikli i biznesit? Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve duhet që të zbulohen shkaqet dhe faktorët të cilët na sjellin ciklet e biznesit. Në lidhje me këto shkaqe dhe faktorë specialistët kanë rënë dakord se ato janë:

- a. Ndryshimet në shpenzimet kapitale dhe luhatja e nivelit të investimeve prodhuese. Kur ekonomia është e fortë bizneset presin që të rriten shitjet, prandaj ata investojnë në rritjen e kapitalit. Pas një farë kohe bizneset mendojnë se e kanë kaluar limitin e tyre në këtë drejtim dhe fillojnë të tërhiqen nga kryerja e investimeve, duke shkaktuar recesion. Rritja e investimeve sjell rritje të kërkesës agregate dhe të ekspansionit ekonomik dhe e kundërta.
- b. Sjellja konsumatore lidhet me atë se sa të çlirët e ndiejnë vehten qytetarët në lidhje me shpenzimet. Sjellja e shpenguar e njerëzve në lidhje me shpenzime rrit konfidencën e konsumatorëve dhe rritjen e shpenzimeve dhe e kundërta.
- c. Inovimet teknologjike dhe imitimet përfshijnë produktet e reja, shpikjet e reja apo janë një mënyrë e re e bërjes së punëve. Kur një biznes kryen një inovim ai është në krye sepse ul kostot apo shton shitjet krahasuar me konkurrentët. Ciladoqoftë arsyeja, fitimet e firmës shtohen dhe biznesi rritet. Nëse firmat e tjera të të njëjtit biznes vendosin të ndjekin të parin duhet të kopjojnë inovimin që është bërë (imitim) ose duhet të bëjnë një gjë tjetër edhe më të mirë (inovim). Zakonisht firmat që imitojnë investojnë shumë dhe kjo bën që të vazhdojë ritmi i investimeve edhe në biznese e sektorë të tjerë. Sapo inovimi përhapet edhe në industritë e tjera, situata ndryshon dhe investimet e mëtejshme janë të panevojshme kështu që aktiviteti ekonomik fillon e bie. Ky aktivitet inovimi dhe imitimi ndikon në mënyrë akute në ciklet e biznesit, në proceset e prodhimit dhe në vetë produktet. Rritja në investimë nuk ndodh në interval të rregullta. Variacionet në inovimet teknologjike sjellin fluktuacione në ekonomi dhe në ciklet e biznesit.

- d. Axhustimet dhe luhatjet në inventaret e firmave. Sapo shfaqen shenjat e para që ekonomia ka arritur kulmin e fillon të bjerë, disa biznese fillojnë e shkurtojnë inventaret dhe kjo vazhdon deri sa i pakësojnë inventaret në minimum me rënien e ciklit të biznesit në pikën e fundit të tij dhe, sapo fillon rritja apo ekspansioni ekonomik këto firma fillojnë dhe i rindërtojnë përsëri inventaret e tyre. Kjo shkakton fluktuacione të dobëta dhe të forta në GDP. Inventaret janë zakonisht stoqet e mallrave që firmat mbajnë në magazinë për të plotësuar kërkesën për produktet e tyre në treg. Por, nëse gjatë rënies firmat mbeten pa inventare, ato fillojnë të shtojnë nivelet e inventarit, duke prodhuar më shumë se sa kanë shitje. Kjo gjë të çon në një ekspansion ekonomik. Ky ekspansion vazhdon deri sa vazhdojnë shitjet. Por, kur shitjet fillojnë dhe bien, firmat shkurtojnë përsëri inventaret dhe kjo çon në një bllokim të ekonomisë.
- e. Ndryshimet në shpenzimet qeveritare dhe politikat fiskale janë një burim tjetër i luhatjeve të biznesit. Në përgjithësi besohet se ndërhyrjet qeveritare kryhen që të stabilizohet situata dhe jo të ketë luhatje, por në fakt është vërtetuar se shpenzimet qeveritare si formë ndërhyrjeje madhore në ekonomi dhe në treg sjellin luhatje në ciklet e biznesit dhe kjo për shkak të mos kapjes së situatës në kohë nga ana e qeverisjeve dhe për shkak të mungesës së fleksibilitetit në drejtim. Kur shtimi i barrës fiskale përkon me pikën fundore të ciklit të biznesit presioni ndaj biznesit shtohet dhe kjo shton riskun e bërjes së biznesit në një vend të caktuar, ndërsa në rastin e shtimit të barrës fiskale në periudhën e rritjes ekonomike ka shanse që kjo të shërbejë edhe si një faktor nxitës në bërjen e biznesit. Përdorimi i politikave fiskale dhe rritja e shpenzimeve qeveritare është mënyra më e përshtatshme për të ndikuar në kërkesën agregate, për të shkaktuar një ekspansion ekonomik. Por nga ana tjetër, vendimet që merr Ministria e Financave dhe Banka Kombëtare, institucione që kontrollojnë interesat mund të kenë një ndikim mjaft të madh në konfidencën e konsumatorëve dhe investitorëve. Politika fiskale përcaktohet nga degët legjislative dhe ekzekutive të qeverisjes dhe përfaqësohet

me ndryshimet në taksat dhe shpenzimet qeveritare. Një rënie e nivelit të taksave sjell një rritje të të ardhurave të disponueshme që do të thotë një rritje e GDP-së. Shenzimet qeveritare në mënyrë direkte afektojnë rritjen e GDP-së. Nëse ekonomia është në rënie, një kombinim i shkurtimeve të taksave me rritjen e shpenzimeve qeveritare me karakter prodhues mund të çojë në një situatë stimulimi të aktivitetit ekonomik.

- f. Ndërhyrjet politike. Pjesa më e madhe e ekonomistëve besojnë se ciklet e biznesit janë edhe një rezultat i drejtpërdrejtë i interesave të politikanëve të cilët kërkojnë të fitojnë apo të mbajnë pozitën drejtuese gjatë fushatave zgjedhore me një tendencë për të krijuar politika makroekonomike me tipare ekspansioni për të ndihmuar në rizgjedhjen e tyre. Por politikat vetëm makroekonomike nuk bëjnë gjë tjetër veçse ndikojnë në kërkesën dhe ofertën agregate, duke sjellë luhatjet në biznes dhe në ekonomi.
- g. Politikat monetare (kreditimi dhe kursimet). Kur në praktikat bankare në një vend të caktuar janë parësore politikat e "parasë së lehtë", interesat bankare janë të ulëta dhe kreditë janë më të lehta për t'u marrë. Kjo inkurajon sektorin privat për të marrë kredi dhe për të bërë investime. Kështu stimulohet ekonomia. Rritja e kërkesës për kredi pas një farë kohe shkakton rritjen e interesave. Kjo dekurajon bizneset që të vazhdojnë të marrin kredi. Meqënëse kreditimi bie, niveli i aktivitetit ekonomik bie. Ekonomia vazhdon të bjerë deri sa interesat bien. Në momentin kur interesat kanë rënë, atëherë biznesi dhe qytetarët kërkojnë të marrin përsëri kredi dhe kështu vazhdon cikli. Politikat monetare drejtohen nga banka qendrore e sejcilit vend. Banka qendrore mund të ulë dhe të rritë interesat për të ndryshuar klimën e investimeve të biznesit dhe konsumin.
- h. Luhatjet në aktivitetin eksport – import. Diferenca midis sasisë së eksporteve dhe importeve të një vendi është kërkesa neto për mallra dhe shërbime. Nëse predominojnë eksportet kjo diferencë është neto në favor të eksporteve dhe e kundërta. Meqënëse eksportet neto dhe importet neto janë një komponent i kërkesës agregate në ekonomi, ndryshimet në aktivitetin eksport

/ import ndikojnë në luhatjet e cikleve të biznesit. Ka shumë arsye që ndikojnë në luhatjet e aktivitetit eksport / import. Rritja e prodhimit të përgjithshëm kombëtar është elementi kryesor i shtimit të eksporteve në një vend, i reduktimit të importeve dhe i rritjes së të ardhurave të banorëve në një vend të caktuar. Por, nëse të ardhurat rriten në vazhdimësi atëherë banorët në një vend të caktuar rritin kërkesën për mallra vendase dhe mallra importi. Kjo në fund të fundit shkakton rritjen e eksporteve por këtu një rol të madh luan edhe kursi i këmbimit të monedhave.

- i. Faktorë të jashtëm të fortë si për shembull rritja e çmimeve të hidrokarbureve, luftërat dhe konfliktet ndërkombëtare, zbulime të burimeve natyrore, etj, kanë një ndikim shumë të madh në ciklet e biznesit. Ato ose e ulin ekonominë poshtë ose përmirësojnë ciklet e biznesit.
- j. Etj.

Studimi dhe mbikqyrja e shkaqeve dhe faktorëve që ndikojnë në ciklet e biznesit nuk mund të garantojnë se do të mund të jemi në gjendje të njohim dhe të parashikojmë ciklet e biznesit. Gjithashtu, treguesit ekonomikë si GDP-ja dhe inflacioni janë elemente që na tregojnë vetëm se ku ka qenë dhe se ku është ekonomia, por jo ekzaktësisht se ku do të shkojë ajo. Njohja e situatës ekonomike aktuale është një informacion i rëndësishëm për ekonomistët, por njohja e asaj se ku po shkohet është kritike. Për të bërë parashikime duhet që të studiohen dhe përcaktohen indikatorët e cikleve të biznesit, që janë indikatorë parardhës, koicidues dhe pasardhës.

INDIKATORËT E CIKLEVE TË BIZNESIT

Ka shumë teknika për të parashikuar ciklet e biznesit, por të tëra teknikat marrin parasysh disa indikatorë. Indikatorët kryesorë të ciklit të biznesit janë indikatorë udhëheqës (paraardhës, drejtues), koicidues (paralelë) dhe pasardhës (ndjekës, pasardhës) të cikleve të biznesit. Indikatorët parardhës përdoren për të bërë parashikime në pikat e kthesës së cikleve të biznesit, indikatorët koicidues për të

gjetur pikën e kthesës dhe indikatorët pasardhës për të konfirmuar kthesën ciklike në aktivitetin e biznesit.

Indikatorët kryesorë udhëheqës janë ata indikatorë që ndryshojnë më përpara se të ndryshojë GDP-ja. Në kushtet e vendit tonë indikatorë të rëndësishëm nëpërmjet të cilëve mund të bëjmë parashikime për ciklet e biznesit janë koha mesatare e punës reale për njësi kohe, niveli i papunësisë, porositë e reja në sektorin prodhues, formimi i bizneseve të reja, ecuria e bursës, porositë për pajisje dhe makineri të reja, etj.

Për indikatorin koha mesatare e punës reale për njësi kohe në Shqipëri nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta, por nëse e lidhim këtë indikator me produktivitetin, atëherë ky tregues shumë i rëndësishëm makroekonomik është ndër më të ulëtit në rajon dhe më gjerë.

Niveli i papunësisë është një indikator tjetër shumë i rëndësishëm, i cili sipas burimeve zyrtare është luhatur në rreth 17 - 18% gjatë viteve vitin 2013 - 2017 nga 9% që ishte në vitin 2006, ndërsa papunësia midis të rinjve është në shifrat rreth 34%.

Porositë e reja në sektorin prodhues, është një tjetër indikator që tregon ecurinë e biznesit, indikator për të cilin edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare, nëse e lidhim me ritmin e investimeve, del se është në rënie, sepse sipas Bankës së Shqipërisë që gjatë vitit 2009 dhe në vazhdim edhe gjatë muajve të fundit të vitit 2016 është vënë re një rënie e ritmit të investimeve vendase dhe të huaja prodhuese.

Formimi i bizneseve të reja, është i vetmi indikator udhëheqës që shënon rritje për muajt e parë të vitit 2017, por nga ana tjetër ka një prirje për të mbyllur bizneset e vogla (sipas Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve dhe QKR).

Ecuria e bursës që matet me ecurinë e çmimit të aksioneve është një tregues tjetër për të cilin në vend nuk ka të dhëna, sepse nuk ka bursë funksionale, por nëse bëjmë analogji me borxhin që merr qeveria nëpërmjet Bankës së Shqipërisë nga publiku (tregu i bonove të thesarit), përqindja e interesit në këtë treg ka qenë në rritje deri në vitin 2010 dhe më tej paraqitet me rënie dhe paqendrueshmëri dhe kështu që edhe ky indikator i tërthortë është në përkeqësim.

Konkretisht, pas një periudhe me interesa të qendrueshme të bonove të thesarit në rreth 7.5% për pothuajse tre vite (2007 – 2010), pas kësaj periudhe është vënë re një prirje për rritjen e interesave të bonove të thesarit në rreth 9% (2011) dhe më tej një rënie e tyre deri në rreth 2.5 - 3% gjatë vitit 2016. Në ankandet e fundit të Bankës së Shqipërisë Qeveria ka marrë borxh nga publiku miliarda lekë. Kjo pakëson investimet.

Porositë për pajisje dhe makineri të reja është një tjetër indikator udhëheqës që sipas INSTAT- it dhe Bankës së Shqipërisë, në këto gjashtë muaj është në rënie sepse bizneset vendase kanë bërë më pak porosi të tilla nga importi në vazhdimësi, duke filluar që nga viti 2009 dhe në vazhdim.

Indikatorët koicidues ndryshojnë në të njëjtën kohë me ndryshimin e rritjes ekonomike. Në kushtet e vendit tonë indikatorë koicidues të rëndësishëm që duhet të merren parasysh në studimin e cikleve të biznesit janë: pagat, prodhimi industrial, të ardhurat personale, shitjet dhe prodhimi në përgjithësi, lejet e ndërtimit, koha e lëvrimit të mallrave, inventaret, çmimet e materialeve dhe lëndëve të para, oferta për para, kreditimi konsumator dhe kreditimi i biznesit.

Pagat, ky indikator i rëndësishëm që shënjestron pozitën e GDP-së duhet që të ecë me ritme më të larta se sa inflacioni, në mënyrë që të nxitet konsumi dhe të përmirësohet realisht jeta e qytetarëve. Edhe pse janë bërë disa përpjekje për shtimin e pagave në sektorin publik dhe të pensioneve, pagat në sektorin privat nuk janë në rritje të dallueshme qartë. Edhe pse mendohet se puna me mall porositësi do ishte një biznes me fitim dhe për këtë u bënë edhe mjaft përmirësime në legjislacion për të nxitur këtë lloj biznesi (kontratat fason), pagat në këto lloj biznesesh ende nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim pozitiv. Bizneset, duke e parë rrezikun, tashmë kanë filluar që t'i paguajnë punonjësit mbi bazën e performancës dhe kjo është gjëja më e mirë që mund dhe duhet të bëjë sektori privat, që deri tani ka mbajtur në punë kushërinjtë e paaftë dhe ndonjë tip tjetër punonjësi të kësaj natyre parazite.

Prodhimi industrial në vend është një indikator që nuk ka ndonjë

vlerë të madhe për t'u marrë në konsideratë në rastin e cikleve të biznesit, sepse në Shqipëri, përveç prodhimit të kontratave me mall porositësi, nuk është se ka ndonjë prodhim të madh industrial që të ndikojë në ciklet ekonomike.

Të ardhurat personale të shqiptarëve, ky indikator i rëndësishëm koincidues, duket se ka mbetur në vend numëro. Vetë qeveria ka pranuar se GDP-ja ka rënë nga 6% në vitin 2008 në rreth 3% - 3.4% në vitin 2009 dhe sipas institucioneve ndërkombëtare për vitin 2014 GDP-ja ishte rreth 1.8% dhe ka një rritje të lehtë deri në 2.6%, ende e pakonfirmuafër statistikisht. Nga kjo del se të ardhurat reale personale nuk e përballojnë ritmin e rritjes së inflacionit.

Shitjet dhe prodhimi si indikator në mënyrë të tërthortë mund të maten me shifrën e afarizimit, që sipas INSTAT-it dhe Bankës së Shqipërisë është në rënie.

Një indikator tjetër koincidues shumë i rëndësishëm i ciklit të biznesit janë lejet e ndërtimit. Lejet e ndërtimit janë me pakicë kur frenohet GDP-ja dhe kjo është një dukuri ndërkombëtare, që ka logjikën e vet ekonomike, por në vendet ku ndërtimi është sektor kryesor dhe që sjell një sasi të konsiderueshme të produktit kombëtar, ky indikator kthehet në një tregues me rëndësi speciale, që duhet përmirësuar sa më shpejt sepse sektori i ndërtimit është pothuajse i paralizuar.

Koha e lëvrimit të mallrave është një tjetër indikator për të cilin nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta zyrtare, por nga informacioni që merret nga komuniteti i biznesit del se është zgjatur koha e lëvrimit të mallrave dhe koha e kryerjes së pagesave dhe kjo sepse bizneset janë në vështirësi për likuiditete dhe parà gjendje në bankë për të kryer veprimet e tyre të përditëshme.

Inventaret janë në pakësim. Firmat duke mos patur parà të mjaftueshme për të kryer pagesa, nxjerrin në shitje tërë gjendjen e tyre në inventare dhe nga ana tjetër, duke mos patur shumë mundësi financiare po përdorin tërë arsenalin e tyre të inventarit për të kryer punët e tyre të përditëshme dhe për të respektuar kontratat. Gjithashtu, inventaret po pakësohen sepse ato ç'ka kanë firmat në inventare shiten për të kryer pagesat e punonjësve edhe në rast se firmat nuk punojnë dhe kjo sepse ato nuk duan që t'u ikin punëtorët

e kualifikuar dhe të specializuar, sepse më vonë nuk kanë ku t'i gjejnë më ata.

Cmimet e materialeve dhe lëndëve të para, një tjetër indikator i rëndësishëm i ciklit të biznesit, janë rritur. Sipas INSTAT-it, cmimet e materialeve dhe lëndëve të para duke filluar që nga dy muajt e parë të vitit 2010 dhe në vazhdim janë rritur mesatarisht 1.3 % - 3.4% sipas llojit dhe sektorit ku përdoren dhe kjo ka ndodhur edhe në vazhdimësi.

Oferta për parà është rritur pasi edhe emigrantet që janë në vendet përreth me frikën nga kriza atje i sollën paratë në bankat shqiptare, të cilat rritin automatikisht ofertën për parà dhe bankat nuk po dinë se ku t'i japin si kredi për investime këto parà sepse investitorët e mëdhenj dhe bizneset e mëdha janë tërhequr nga dëshira për investime për shkak të situatës politike në vend.

Kreditimi konsumator, një tjetër indikator i rëndësishëm koicidues, është në rënie sepse bankat kanë frikë për këtë lloj kreditimi, i cili i bëri gropën ekonomisë shqiptare përgjatë viteve 2006 – 2009. Bankat e nivelit të dytë, duke dhënë shumë kredi konsumatore pothuajse të pakontrolluar gjatë tre viteve të fundit nuk kanë bërë gjë tjetër veçse kanë shtuar sasinë e kredive të këqija, duke shtuar riskun e tyre dhe duke ndikuar negativisht në gjendjen ekonomike në përgjithësi. Kreditë e këqija llogariten në rreth 25%, nga të cilat rreth 6% mendohet se nuk do të mund të kthehen më, edhe pse me anë të mekanizmit të pastrimit të llogarive të bankave të nivelit të dytë ky tregues u ul deri në 20 dhe mëtej u rrit përsëri në rreth 25%.

Kreditimi i biznesit nga ana tjetër është me pikatore. Bankat e nivelit të dytë nuk japin kredi prodhuese dhe kjo lidhet në një masë të konsiderueshme edhe me faktin se bizneset e vogla dhe të mesme nuk po paskërkan më ide për të punuar e investuar dhe kjo para së gjithash sepse niveli i pjesës më të madhe të atyre që e mbajnë vehten se janë pjesë e komunitetit të biznesit është mjaft i ulët. Sipas Bankës së Shqipërisë kreditimi i ekonomisë për vitin 2009 dhe për muajt e parë të vitit 2010 ka qenë në shifrat rreth 16% - 17%, që është niveli më i ulët që nga viti 2004, ndërsa në vitin 2016 kreditimi i biznesit ka qenë në përmirësim të lehtë.

Indikatorët pasardhës janë ata indikatorë që nuk ndryshojnë pa ndryshuar rritja ekonomike. Në kushtet e vendit tonë indikatorë pasardhës që duhen marrë në konsideratë janë: kosto e punës për njësi prodhimi, kohëzgjatja e periudhës së papunësisë së lartë, raporti inventare / ritmi i shitjeve, raporti kredit konsumator / ritmi i të ardhurat personale, kreditë tregtare, interesat bankare, etj.

Kosto e punës për njësi prodhimi është në rritje sepse janë rritur çmimet e materialeve dhe lëndëve të para dhe është rritur çmimi i energjisë.

Kohëzgjatja e periudhës së papunësisë së lartë është në rritje. Nëse më parë një i papunë strukturor e gjente një punë për afro tre muaj, tashmë e ka të vështirë të gjejë punë për të njëjtën periudhë kohore.

Raporti inventare prodhuese / ritmi i shitjeve është një tregues në përkeqësim dhe kjo sepse firmat vendase dhe të huaja kanë kryer investime dhe nuk po e shlyejnë dot investimin e kryer sepse kanë rënë shitjet pothuajse në tërë sektorët.

Raporti kredit konsumator / ritmi i të ardhurave personale është një raport i keq. Bankat që deri dje dhanë kredi konsumatore pa hesap, tani që duhet nxitur konsumi nuk japin kredi apo kanë shtuar interesat. Nga kjo qytetarët tërhiqen me frikën e krizës.

Kreditë tregtare janë në ditën e tyre më të keqe edhe për faktin se interesat bankare në Shqipëri janë ndër më të lartat në rajon dhe në rritje.

Përveç sa më lart, nëse bëjmë krahasime për të ardhurat nga tatimet dhe doganat midis periudhës 2007 – 2017 rezulton se të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat në vitin 2007 ishin rreth 4 mld, në vitin 2008 rreth 8 mld dhe në vitin 2009 8.3 mld lekë (krahasuar me 9.2 mld planifikim për vitin 2009, ose rreth 1.2 mld më pak, që është rreth 12.5% nën parashikimin dhe pothuesjee për të tëra vitet e mëpasme kjo dukuri ka qenë e njëjtë, mëpak para se sa planifikimi). Në lidhje me TVSH-në përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2009 dhe fillimit të vitit 2010 është vënë re një rritje e kontribuesve me rreth 6.6% për shkak të uljes së tavanit për pagesën e TVSH-së nga 8 milionë lekë në 5

milione lekë, por nga ana tjetër, është vënë re një ulje e të ardhurave nga biznesi i vogël me rreth 11.9% po për shkak të kësaj arsyeje. Gjithashtu, në 4 - mujorin e parë të vitit 2010 të ardhurat nga tatimet dhe doganat në tërësi kanë qenë 93.7% krahasuar me një periudhë të një viti më parë dhe dukuria ka vazhduar njësoj edhe në periudhën e mëpasme.

Në total, të ardhurat nga biznesi i vogël për muajin janar u realizuan në masën 4.2% më tepër sesa plani, ndërsa u shënua një rënie -4.6% krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël ishin 96.3% më pak sesa plani dhe 98.4% krahasuar me janarin e vitit të kaluar. Sipas planit të caktuar nga qeveria, nga taksa e biznesit të vogël, duhej të mbledheshin për Janarin 137 milionë lekë, por janë mbledhur vetëm 5 milionë lekë. Vetë shifra e planifikuar në vitin 2015 ishte rreth tri herë më e vogël sesa muaji Janar i vitit 2014, kur u mbledhën 304 milionë lekë. Në total, të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 540 milionë ose 290 milionë më pak se parashikimi. Këtu përfshihen edhe taksat lokale dhe taksa mbi pasuritë. Shuma e mbledhur nga taksa lokale zbriti me 31.2% nga planifikimi, megjithatë ka qëndruar me 0.6% më mirë sesa janari 2014. Por, e ardhura nga taksa mbi ndërtesat shënon rritje drastike me 26.6% në raport me janar 2014, megjithëse është më poshtë kundrejt planit me -5.4%.

Janë mbi 1 miliard lekë që tatimet nuk arritën t'i mbledhin gjatë vitit 2015 nga taksa mbi fitimin, ndërkohë që plani ishte 1.4 miliardë lekë. E shprehur në përqindje, e ardhura nga tatimi mbi fitimin është -73.6 për qind më pak se plani për periudhën. Krahasuar me Janarin 2014, tatimi mbi fitimin në 2016 ka sjellë 61% më pak të ardhura në arkën e shtetit. Tatimi mbi të ardhurat personale u mbledh në nivelin 31.5% më pak sesa plani për Janarin 2014, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ka ndodhur një rënie -25.3%. E përkthyer në vlerë, janë 881 milionë lekë më pak sesa plani. Në fakt, në këtë zë pritëshin më shumë të ardhura, sepse kjo taksë është rritur nga 10% në 15%. Mbledhja e taksës mbi mallrat e akcizës ka ecur shumë mirë, por plani ishte bërë më shumë sesa mund të mbanin shpatullat e Doganave. Të ardhurat gjithsej nga akciza për Janarin 2015 arritën

në rreth 1.8 miliardë lekë. Pra, ka rritje të vlerës në masën 10.1% për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014. Por, në raport më planin, ka një rënie me 19.9%, ose 441 milionë lekë më pak. Një shenjë jo e mirë, që flet për një dobësim të përgjithshëm të aktivitetit tregtar, është e ardhura e ulët nga taksa doganore. Krahasuar me planin, kjo taksë është 27.2% më pak, ndërsa në raport me janarin e vitit të kaluar, u mblodhën 10.1% të ardhura. Megjithëse qeveria i kishte planifikuar me ulje mbledhjen e kontributeve të sigurimeve për muajin janar, realizimi në fakt, është 15.9% më pak. Po ashtu, krahasuar me muajin janar 2014, mbledhja e sigurimeve shënon një rënie prej 10%. Përkundrazi, sigurimet shëndetësore janë mbledhur në masën 117% në raport me planin dhe 129.5% më tepër sesa janari i vitit të kaluar. Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar kanë kontribuar pozitivisht në vlerën totale të mbledhur për janarin. Sipas Financave, janë 4.1 miliardë lekë ose 39.4 për qind më shumë se plani. Krahasuar me një vit më parë, këto të ardhura janë rritur me 42.1 për qind (1.2 miliardë lekë më shumë). E njëjta gjë vihet re edhe te zëri "Taksat nacionale", nga të cilat janë mbledhur 1.2 miliardë lekë ose 308.5 për qind më shumë se plani. Edhe aktiviteti i ndërmarrjeve shtetërore nuk duket pozitiv, po të shohim se të ardhurat jotatimore, megjithëse u rritën këtë muaj me 47.9% në raport me planin, kanë rënë 9.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014. Përfundimisht të ardhurat nga institucionet buxhetore, që kanë rritje vjetore 18%, zërat e tjerë janë negativë. Kështu, tarifat e shërbimeve, dividendi, transferimi i fitimeve nga Banka e Shqipërisë, nuk janë realizuar ose janë në shifrën zero. Sipas Bankës së Shqipërisë investimet në 4 muajt e parë të vitit 2010 ranë në 64%, duke bërë që edhe ritmet e krijimit të vendeve të reja të punës të bien dhe që nga ky moment investimet kanë vazhduar me këtë ritëm. Edhe investimet publike e kanë ulur ritmin në fillim të vitit. Megjithëse Financat i kanë çelur fondet qysh më 6 janar 2015, regjistrohet një realizim 25.9% më pak sesa plani i shpenzimeve kapitale të kryera në janar 2015. Gjithsesi, në raport me janar 2014, punët publike kanë nisur më shpejt, sepse ka një rritje prej 133.6%, por viti 2016 u mbyll me mosrealizim rreth 9%. Zbatimi i projekteve të investimeve, është një detyrë që ndiqet

nga Ministria e Ekonomisë, ndërsa Financat kanë vënë në dukje rrezikun potencial që paraqet mosrealizimi në kohë i tyre. Sipas INSTAT-it gjatë katër muajve të parë të vitit 2010 vihet re një rritje e vlerës së importeve në përgjithësi kryesisht në zërat kryesore si ushqime, veshje, pije, duhan, tekstile, këpucë dhe lëndë djegëse, etj, por ajo që është më e rëndësishme vihet re një rënie e importeve të zërave shumë të rëndësishëm si makineri e pajisje, pjesë këmbimi, etj, që tregon se firmat private po kryejnë më pak investime prodhuese gjë që ndikon për keq në ekonominë e vendit në përgjithësi. Në vitin 2008, sipas FMN-së, në Shqipëri, deficitin i llogarisë korrente ishte në shifrën 15%, më përtej tërë parashikimeve, ndërsa në vitin 2014 u ul në shifrën rreth 9%, parametër ky që rrezikon hapsirën e investimeve private dhe qendrueshmërinë e borxhit. Sipas një raporteve të Bankës Botërore, Shqipëria renditet në vendet e fundit në botë për disponueshmërinë e teknologjisë së fundit, për absorbimin e teknologjisë në nivel firme, për inovimin dhe risitë, për cilësinë e institucioneve kërkimore shkencore, për shpenzimet e firmave për kërkim e zhvillim, për bashkëpunimi industri – universitete, për disponueshmërinë e shkencëtarëve dhe e inxhinierëve, etj. Po sipas këtij raporti, shumë pak firma shqiptare përdorin faqe internet dhe e-maile për komunikim, duke zënë vendin e fundit në Evropë për këto dy parametra. Në lidhje me të varfërit (1) pagesat e papunësisë u ulën për janarin në -16.4% në raport me planin dhe 47.8% krahasuar me një vit më parë, për shkak të shkurtimeve të përfituesve, (2) pagesat e ndihmës ekonomike u ulën me -13.9% më pak sesa plani dhe 75.9% më pak se janari 2014 dhe në këtë zë, qeveria pagoi për këtë muaj rreth 2 miliardë lekë më pak, ndërsa (3) pagesat e kompensimit për shtresat në nevojë janë -100% më pak sesa plani, ose 133 milionë lekë më pak. Edhe në raportin e FMN-së është kërkuar tavan për këtë shpenzim. Duke marrë në konsideratë këto shifra dhe të dhëna, duket se cikli i biznesit në Shqipëri është në fazën e rënies dhe tashmë është koha për të ndërhyrë e për të përmirësuar indikatorët udhëheqës, shoqëruar dh pasardhës me politika fiskale dhe monetare në bashkëveprim institucional midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë. Ndërhyrjet duhet të synojnë shtimin e shpenzimeve prodhuese

dhe nxitjen e konsumit, duke ngushtuar borxhin e brendshëm dhe deficitin me jashtë, si dhe duke përmirësuar bilancin tregtar. Këto masa duhen marrë në mënyrë urgjente, në mënyrë që cikli i biznesit të dalë sa më shpejt nga faza e rënies për të mos lejuar që të shkojë në pikën fundore të tij sepse në të kundërt cikli i biznesit do sillte një krizë të thellë ekonomike, nga e cila është shumë e vështirë për të dalë, duke marrë parasysh edhe vetë gjendjen e ekonomisë shqiptare dhe të parametrave të saj makroekonomikë, që mezi po mbahen në kufijtë e tyre të pranueshmërisë. Cikli i biznesit ndodh në tërë botën dhe dallohet ku më shumë e ku më pak dhe pranohet ashtu siç është, pa zbulurime, pa emocione. Tashmë në kushtet ku ndodhet ekonomia shqiptare dhe ajo rajonale, kemi shansin që t'a studiojmë këtë cikël biznesi dhe të gjejmë rrugët, mjetet dhe mënyrat për të dalë sa më shpejt nga kjo fazë e pikës më të ulët të ciklit të biznesit, për të kapur një rritje ekonomike sa më të madhe dhe për të konsoliduar ekonominë në fazën e rritjes së ciklit të biznesit me synim kalimin në fazën e kulmit të këtij cikli, për të qendruar për një periudhë sa më afatgjatë në këtë fazë, për të zhvilluar ekonominë dhe për të arritur vendet që kemi përpara në rrugën e zhvillimit. Përgjatë këtyre 25 viteve kemi hasur të paktën 3 cikle biznesi të dallueshme, por për mungesë përvoje dhe për arsye të tjera, specialistët e fushës nuk kanë patur shansin që të studiojnë në praktikë ndonjë prej këtyre cikleve të biznesit me tërë kuptimin e fjalës dhe në të tërë parametrat. Tashmë është shansi që të studiojmë këtë cikël biznesi që nga faza e pikës më të ulët të tij e deri në përsëritjen e ciklit. Nëse qeveria, opozita, komuniteti i biznesit dhe institucionet e ndryshme të interesuara brenda dhe jashtë vendit, në bashkëpunim me universitetet që kanë fakultete ekonomike, arrijnë që të krijojnë kushte që specialistët, përfshirë këtu edhe ata të pavarur, të studijojnë me detaje dhe në thellësi këtë cikël biznesi, në fazën që është dhe në vazhdim, ne do kemi shansin që të nxjerrim mësim me shumë vlerë për të ardhmen e afërt dhe të largët, për të patur një rritje sa më të madhe dhe sa më afatgjatë dhe për të përballuar më mirë ciklet e tjera të biznesit që do ndodhin në të ardhmen.



KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

1. Objektivat e politikës ekonomike janë të thjeshta: (1) Mirëmbajtje e GDPsë në një nivel relativisht konstant (Për shembull: 6% rritje ekonomike në vit), (2) Mbjajtje e nivelit të papunësisë të ulët (për shembull rreth 3%) dhe (3) Minimimizim i nivelit të inflacionit dhe mbajtja e tij në atë nivel (Optimalisht një ekonomi duhet të ketë një nivel inflacioni rreth 3% ose pak më poshtë).
2. Sipas principeve të politikës ekonomike ciklet e biznesit duhet të jenë të buta dhe me sa më pak ulje e ngritje. Është shumë e rëndësishme të dimë se ku po shkon ekonomia në të ardhmen. Nëse hapi është i padëshëruar, atëhere ndryshimet në ekonomi duhen bërë sot për të parandaluar hapin pa u realizuar ai. Për shembull nëse GDP-ja është 6% dhe mendohet se në të ardhmen ajo do bjerë, duhet të ndërhyhet me uljen e interesave të kredive për të stimuluar rritjen e ardhëshme ekonomike për të mirëmbajtur GDP-në reale edhe në të ardhmen në nivelin 6%.
3. Për të mbajtur nën kontroll ekonominë dhe indikatorët e cikleve të biznesit duhet që të mbahet nën kontroll niveli i papunësisë dhe indeksi i kostos së punës (1), përdorimi i kapaciteteve prodhuese, (2) çmimet e mallrave të konsumit, (3) ndryshimet në inventarin e bizneseve, (4) produktiviteti në përgjithësi dhe për fuqi punëtore në veçanti (5), kreditimi i ekonomisë dhe borxhi i brendshëm dhe i jashtëm (6), etj.
4. Për manaxhimin në mënyrë të suksesëshme të cikleve të biznesit është e nevojshme që bizneset e vogla dhe të mesme, që janë më të hapura ndaj riskut, sepse kanë më pak kapital dhe më pak mundësi për kreditime dhe manaxhim risku, të ndërmarrin disa hapa shumë të nevojshme që të mundësojnë në mënyrë të qartë nëse biznesi i tyre të dëmtohet sa më pak në kohë paqartësie ekonomike.
5. Kryesisht firmat duhet që të ndërmarrin hapa për aplikimin e teknikave moderne të manaxhimit të financave, marketingut, burimeve njerëzore, kapitalit, inventareve, prodhimit të gatshëm, mirëmbajtjes së klientëve, teknikat e përcaktimit të çimeve të produkteve dhe shërbimeve të tyre, aplikimin e sistemeve të



manaxhimit të cilësisë ku merr një rol të madh manaxhimi total i cilësisë dhe për ndërmarrjet e agrobiznesit teknika HACCP, që në fund të fundit garantojnë përkujdesjen ndaj klientit dhe mbajtjen e tij dhe sigurinë për cilësinë e proceseve dhe produktit, etj.

6. Këto masa duhen marrë përgjatë tërë kohës së ecurisë së biznesit, por ato kanë një rol të rëndësishëm kur cikli i biznesit mdodhet në pikën fundore të tij. Edhe pse nuk ka formula të gatshme për çdo firmë të vogël dhe të mesme, duhet që firmat të fokusohen si në objektivat afatgjata ashtu edhe në ato afatmesme dhe afatshkurtëra. Nëse firma është në ciklin e pikës fundore duhet të shqetësohet për objektivat afatshkurtëra dhe nëse jemi në fazën e kulmit të ciklit të biznesit, atëherë marrin prioritet objektivat afatmesme dhe afatgjata. Firmat duhet që të jenë fleksibile si një veti apo pjesë e planit të tyre të biznesit, që lejon për zhvillime dhe struktura financimi.
7. Në lidhje me planifikimin afatgjatë, kohët e fundit është vënë re se firmat më të suksesshme kanë qenë ato që kanë mbajtur një qendrim të moderuar në parashikimin afatgjatë. Vëmendja ndaj klientëve është një ndër faktorët kryesorë të suksesit për të dalë nga ekonomia e fazës së emergjencës. Qendrimi ngjitur me klientët është një disiplinë e vështirë për t'u mirëmbajtur edhe në kohë të mira biznesi dhe jo më në kohë të këqija dhe ulje të aktivitetit ekonomik. Është gjëja më e mirë që klientët të testohen sapo fillon të duket se cikli i biznesit po bie. Në këtë fazë firmat e vogla dhe të mesme arrijnë të kuptojnë se deri ku mund të mbajnë klientët dhe deri në ç'masë mund të shesin në kohë të vështira. Në këtë fazë të ciklit të biznesit arrihet të kuptohet nëse klientët do bëjnë blerje të mëdha apo jo.
8. Objektiviteti duhet të jetë në një nivel shumë të lartë midis drejtuesve të biznesit të vogël dhe të mesëm kur ecin përgjatë ciklit të biznesit me firmën që drejtojnë. Vendimet operacionale bazohen në shpresa dhe dëshira që në fund të fundit janë produkt i ekzaminimit të fakteve që mund të çenojnë biznesin dhe këto fakte nuk duhen mbledhur vetëm në periudhën e rënies ekonomike.



ANEKSE



Tabelat 1 dhe 2: Rritja e GDP (PPB) për periudhën e 25 viteve të fundit (1996 – 2010 - sipas INSTAT-it dhe Janar 2012 – Gusht 2014 sipas Trading economics.)



Tabelat 3 dhe 4: Borxhi Publik si Përqindje e GDP-së për periudhën 1996 – 2015 (për periudhën 1996 – 2010, ku vërehet një rritje në 61% krahasuar me rreth 52% në vitin 2008 të dhënat janë marrë nga INSTAT, ndërsa për periudhën 2012 – 2014 nga Trade economics.)



Tabelat 5 dhe 6: Normat e interesit të kreditimit për periudhën 1993 – 2015 (për periudhën 1993 – 2010 të dhënat janë marrë nga Banka e Shqipërisë, ku vërehet një rritje e qendrueshme në rreth 13% për vitet 2007 - 2010 krahasuar me 9% në vitin 2006 dhe për periudhën 2010 – 2015 nga Trade economics.)

LITERATURA - libra

- Arnold, Lutz G. *Business Cycle Theory*. Oxford University Press, 2002.
- Shister, Neil. "Global Trade and the 'Jobless Recovery'." *World Trade*. October 2004.
- Rabah Benkemoune. C.D. & the Emergence of the Idea of an Economic Cycle, *History of Political Economy*. 2009
- F. Milton, A. J. Schwartz. *A Monetary History of the United States, 1867-1960*. Princeton University Press. 1993
- Henryk Grossmann *Das Akkumulations- und Zusammenbruchsgesetz des kapitalistischen Systems (Zugleich eine Krisentheorie)*, Hirschfeld, Leipzig, 1929
- Knut Wicksell, *The New Palgrave Dictionary of Economics*, 2nd Edition, 2008:
- Hartwig, Robert P. "Riding the Economic Cycles: How Growth and Recession Affect Workers' Compensation." *Compensation and Benefits Review*. May/June 1997.
- Wilson, Robert A. "Where Were You When the Cycle Died?" *Pulp and Paper*. February 1997.
- Hayek, Friedrich A. *Prices and Production*. 2nd ed. New York: Augustus M. Kelley, Publishers, 1967.
- Mises, Ludwig von et al. *The Austrian Theory of the Trade Cycle and Other Essays*. Auburn. 1983.

LITERATURA - artikuj shkencorë dhe të shtypit të përditshëm

- Hall, Robert, and Martin Feldstein. *The NBER's Business-Cycle Dating Procedures*. National Bureau of Economic Research, 21 October 2003.
- Nardi Spiller, Christina. *The Dynamics of the Price Structure and the Business Cycle*. *Business & Economics*, August 2003.
- Walsh, Max. "Goldilocks and the Business Cycle." *The Bulletin with Newsweek*. 7 December
- "The Austrian Theory of the Business Cycle in the Light of Modern Macroeconomics," *Review of Austrian Economics*, vol. 3, 1989, pp. 3-29.
- "The Hayekian Trade Cycle Theory: A Reappraisal," *Cato Journal*, vol. 6, no. 2 (Fall), 1986, pp. 437-53.
- "Time and Money: The Universals of Macroeconomic Theorizing," *Journal of Macroeconomics*, vol. 6, no. 2 (Spring), 1984, pp. 197-213.
- E. Ceko. Ja ç'farë po ndodh me ciklet e biznesit. *Ekonomia*. 19 Qershor 2010
- E. Ceko. Ja ç'farë i duhet biznesit. *Ballkan*. 21 Qershor 2010

LITERATURA - faqe interneti të shfrytëzuara

- www.WealthDaily.com. 11 Economic Black Swans - These events could shake the world in 2010.
- www.FT.com. Economic - See How World Markets Are Reacting to the Developing Financial Crisis.
- www.nber.org/cycles.html. "US Business Cycle Expansions and Contractions"
- www.minneapolisfed.org
- www.jstor.com
- www.pearsonschool.com
- www.instat.gov.al
- www.bancofalbania.gov.al
- www.tradingeconomics.com/albania.



*MSc. Enri HERRI*⁸¹



MONITORIMI I KOMUNIKIMIT TË BANKËS QENDRORE - RASTI I BANKËS SË SHQIPËRISË

81 Student i Shkollës së Doktoraturës, Departamenti i Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, eherri@gmail.com

Abstrakt

Një nga gjërat më të rëndësishme në jetën njerëzore dhe jo vetëm është komunikimi. Në dekadat e fundit mjetet e komunikimit kanë pësuar një përparim të jashtëzakonshëm dhe afërsia e organizatave me publikun është rritur ndjeshëm duke zvogëluar në masë të konsiderueshme distancat që ekzistonin më parë. Rasti i bankave qendrore mund të konsiderohet një shembull tipik. Komunikimi është bërë kryefjala e veprimtarisë së bankave qendrore në dy dekadat e fundit dhe vendi që po zë në veprimtarinë e tyre sot konsiderohet si shumë i rëndësishëm madje dhe i pazëvendësueshëm. Në ditët e sotme komunikimi i bankave qendrore është kthyer në një instrument me shumë rëndësi i politikës monetare, gati gati i njëjtë me normën bazë të interesit. Një nga objektivat kryesore të një banke qendrore të përgjegjshme është pasja e një komunikimi të besueshëm me qëllim orientimin e pritshmërive në një mjedis ekonomik që ndryshon shumë shpejt. Komunikimi tashmë është bërë pjesë integrale dhe shumë e rëndësishme e politikës monetare moderne, që jo më kot Banka Qendrore Evropiane dhe shumë banka të tjera qendrore e cilësojnë si zemra e saj. Ky artikull synon të tregojë rëndësinë e komunikimit të bankave qendrore, komunikimin e politikës monetare të Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankës së Shqipërisë si dhe formën e monitorimit të komunikimit të Bankës së Shqipërisë lidhur me vendimin për normën bazë të interesit.

***Fjalë kyçe:** bankë qendrore, komunikim, politikë monetare, normë interesi*

I. Hyrje

Komunikimi është një ndër pjesët më të rëndësishme në jetën e përditshme të secilit prej nesh dhe jo vetëm. Institucionet publike, bizneset, organizatat, OJQ, etj...e shohin komunikimin si pjesën më të rëndësishme të aktivitetit të tyre të përditshëm. Komunikimi siç shprehet Wolton (2005) është gjithmonë kërkim i marrëdhënies

dhe përshkon të gjitha veprimtaritë: kohën e lirë, punën, edukimin, politikën dhe prek të gjitha mjediset shoqërore, klasat shoqërore, të gjitha moshat, kontinentet, të pasurit e të varfrit. Komunikimi ndër të tjera thotë Wolton është simbol i lirisë, demokracisë, hapjes, emancipimit dhe konsumit, shkurt i modernitetit.

Fjala komunikim rrjedh nga latinishtja, "*communis*" që do të thotë "e përbashkët" dhe "*communicare*" që do të thotë "bërja e diçkaje të përbashkët". Pra në këtë kuptim, komunikimi është procesi i ndarjes së informacionit, njohurive ose kuptimeve. Coffin dhe Shaw (1971) nga ana e tyre e shohin komunikimin si procesin e transferimit të kuptimit. Fuga (2014) nga ana e tij e sheh komunikimin në plan më të gjërë, si lloj marrëdhënieje, si një veprimtari që realizon transmetim vlerash, qofshin këto mallra, udhëtarë, mesazhe, shkëmbime vlerash, mendimesh, ndjenjash, etj...Komunikimi ndër të tjera është një proces përvetësimi. Duhet pranuar fakti se në dekadat e fundit mjetet e komunikimit kanë pësuar një përparim të jashtëzakonshëm dhe afërsia e organizatave me publikun është rritur ndjeshëm duke zvogëluar në masë të konsiderueshme distancat që ekzistonin më parë. Rasti i bankave qendrore mund të konsiderohet një shembull tipik dhe se kriza financiare botërore e vitit 2008 e dëshmoi më së miri këtë fakt.

Në vetvete komunikim do të thotë të shprehesh dhe të ndërtosh marrëdhënie (Wolton 2005). Në këndvështrimin e një banke qendrore, të shprehesh do të thotë të bësh të ditur objektivin, misionin, strategjinë, politikën, etj...ndërsa ndërtimi i marrëdhënieve lidhet me grupet e saj të interesit (aktorët e tregut financiar, publiku, qeveria, media, etj..). Por a i mjafton vetëm të shprehurit një banke qendrore apo kujt do institucioni/organizate? Natyrshëm përgjigja do të jetë jo nuk mjafton pasi duhet ditur nëse publiku të dëgjon dhe kupton dhe për ti ditur këto shërben ndërtimi i marrëdhënies me publikun ku thelbi i problemit është kthimi i informacionit ose siç njihet rëndom *feedback*-u. Sipas Mishkin (1997), në të gjithë botën, aktorët më të rëndësishëm në tregjet financiare janë bankat qendrore, ose siç njihen

ndryshe autoritetet monetare, të ngarkuara me detyrën e hartimit dhe zbatimit të politikës monetare me qëllim kontrollin e inflacionit. Veprimet e bankës qendrore ndikojnë normat e interesit, masën e kredisë, ofertën e parasë, të cilat të gjitha së bashku kanë ndikim direkt jo vetëm mbi tregjet financiare por edhe mbi prodhimin dhe inflacionin.

Në elementët përbërës të komunikimit marketing elementi që i përshtatet më shumë veprimtarisë, objektivit dhe që përdoret sot gjerësisht nga bankat qendrore janë marrëdhëniet me publikun. Si pjesë e rëndësishme e strategjisë së komunikimit marketing, marrëdhëniet me publikun shërbejnë për promovimin, mbrojtjen e imazhit të organizatës apo produkteve / shërbimeve të saj. Ndër të tjera, marrëdhëniet me publikun shërbejnë për ndërtimin e marrëdhënieve të mira midis organizatës dhe publikut, çka është dhe thelbi i ecurisë pozitive të biznesit (Kotler, Keller, Armstrong).

II. Komunikimi i bankave qendrore

Një herë e një kohë, sidomos para viteve '90, bankat qendrore nuk kishin komunikim me publikun. Ato punonin mbi supozimin se efektiviteti i politikës monetare është më i madh kur bankat qendrore sistematikisht surprizojnë tregjet financiare. Ky besim i vjetër bazohej mbi nocionin se banka qendrore e mat suksesin e veprimeve të saj nga masa me të cilën aktiviteti ekonomik mund të ngrihet dhe mbahet mbi potencialin e tij. Daljet mediatike ishin shumë të rralla dhe komunikimi i bankave qendrore zinte gjithnjë faqet e fundit të gazetave dhe revistave të kohës. Kështu, Montagu Norman, një nga Guvernatorët më jetëgjatë të Bankës së Anglisë (1920 - 1944)⁸² do të shprehej kështu lidhur me komunikimin e bankës qendrore: "*kurrë mos kërko falje, kurrë mos shpjego*"⁸³.

82 Burimi: <http://www.bankofengland.co.uk/archive/Pages/digitalcontent/archivedocs/mnorman.aspx>

83 Burimi: <http://www.bankofengland.co.uk/publications/Documents/speeches/2014/speech751.pdf>

Përshkrimi që Karl Brunner i bën bankës qendrore në vitin 1981, i cituar nga mjaft studiues të njohur në punimet e tyre, është ndër më të gjeturit. Sipas tij, bankingu qendror tradicionalisht është rrethuar nga një tis mistik. Ishin pikërisht sekreti dhe misticiteti parimet bazë të funksionimit të bankës qendrore. Brunner ndër të tjera e përshkruan bankingun qendror si një art të fshehtë dhe misterioz në të cilën aksesit dhe ekzekutimi është i kufizuar vetëm tek elita drejtuese e saj. Për më tepër, natyra e fshehtë dhe misterioze e këtij arti ka dalë në pah nga vetë bankat qendrore të cilat nuk kanë mundur të artikulojnë me fjalë të qarta dhe të kuptueshme mendimet e tyre. Në këtë linjë paraqitet edhe Bernanke në vitin 2004 teksa në një takim të organizuar nga Shoqata Ekonomike Amerikane në San Diego të Kalifornisë thekson se bankierët qendrorë besonin se një tis mistik i bashkëngjitej aktivitetëve të tyre që e bënin politikën monetare të ishte një art i fshehtë dhe misterioz i cili i duhej lënë vetëm elitës drejtuese të bankave. Përfshirja e publikut në diskutimet mbi veprimet e bankës qendrore do të uzurponte të drejtat dhe privilegjet e bankierëve dhe do të sillte një degradim të efektivitetit të politikës monetare. Që nga përcaktimet e Brunner-it deri më sot komunikimi dhe sjellja e bankës qendrore ndaj publikut ka ndryshuar dhe është transformuar rrënjësisht. Sot bankat qendrore punojnë shumë fort për ta bërë punën e tyre sa më të kuptueshme për publikun, kjo falë edhe filozofisë së re të zbatimit të politikës monetare. Komunikimi tashmë është bërë pjesë integrale dhe shumë e rëndësishme e politikës monetare moderne, që jo më kot BQE-ja dhe shumë banka të tjera qendrore e cilësojnë si zemra e saj.

Një numër i konsiderueshëm autorësh dhe personalitetesh të bankingut qendror (Amato, Blinder, Bernanke, Issing, Morris, Shin, Ehrmann, Fratzscher, Mishkin, Goodhart, Woodford, Trichet, Greenspan, etj...) rendisin disa arsye kryesore që kanë motivuar bankat qendrore të lëvizin nga tradita e pasjes çdo gjë sekret drejt hapjes së madhe ndaj publikut që lidhen me:

- **Efektivitetin e politikës monetare**

Një politikë monetare transparente e rrit së tepërmi kuptueshmërinë dhe parashikueshmërinë e saj si dhe shmang surprizat për ekonominë dhe tregjet financiare. Duke pasur një politikë monetare transparente rritet përgjegjshmëria dhe përmirësohet efektiviteti i politikës monetare pasi agjentët ekonomikë mund ti optimizojnë sjelljet e tyre nëse e kuptojnë mirë atë se çfarë banka qendrore do të bëjë. Tendenca drejt rritjes së transparencës dhe komunikimit më të mirë është orientuar edhe nga vetë politikëbërësit monetarë të cilët kanë pranuar se veprimet apo vendimet e tyre mund të bëhen më efektive në qoftë se tregu i kupton ata mirë. Jenkins (2001) i mëshon idesë se një komunikim i mirë e vendos bankën qendrore dhe tregjet financiare në njëjtën gjatësi vale, çka nënkupton se tregjet mund të bëjnë edhe parashikime sesa thjeshtë vetëm të reagojnë ndaj vendimit të normës së interesit⁸⁴.

- **Rritjen e nevojës për llogaridhënie**

Përgjithësisht, bankat qendrore gëzojnë një pavarësi të lartë nga autoritetet politike (qeveria) në përmbushjen e objektivave dhe detyrave të tyre, por si "shërbëtorë publik" siç i quan Bernanke, që me vendimet dhe veprimet e tyre ndikojnë dhe prekin jetën e përditshme të qytetarëve e kanë për detyrim shpjegimin e objektivave, parimeve, instrumenteve që përdorin si dhe arsyet që çojnë në marrjen e vendimeve të caktuara. Mishkin (2004) shkon më tej kur shprehet se sipas parimeve bazë të demokracisë bankat qendrore duhet të jenë të përgjegjshme për veprimet e tyre, çka nënkupton se publiku duhet ti kuptojë praktikat e saj.

84 Norma e interesit ose siç përdoret zyrtarisht nga bankat qendrore norma bazë e interesit është norma me të cilën banka qendrore i jep hua bankave tregtare në maturitet shumë të shkurtër. Kjo normë bazë ka një rëndësi të veçantë pasi është ajo që tenton të ndikojë të gjitha normat e tjera të interesit në ekonomi. Nëpërmjet normës bazë, bankat qendrore përpiqen të ndikojnë nivelin e përgjithshëm të aktivitetit të ekonomisë me qëllim mbajtjen e kërkesës dhe ofertës për mallra dhe shërbime në ekuilibër.

(<http://www.bankofengland.co.uk/monetarypolicy/Pages/how.aspx>;
<http://www.investopedia.com/terms/b/bankrate.asp>)

- **Adoptimin e rregjimit të inflacionit të shënjestruar**

Në dy dekadat e fundit, një numër i konsiderueshëm vendesh (duke filluar që nga Zelanda e Re në vitin 1990) kanë adoptuar shënjestrimin e inflacionit si rregjim të politikës monetare. Shënjestrim inflacioni, nga vetë emri nënkupton shpalljen / bërjen publike të objektivit të normës së inflacionit për një ose më shumë periudha kohore me supozimin se objektivi kryesor i politikës monetare është mbajtja e një inflacioni në nivele të ulta dhe të qëndrueshme.

Një veçori themelore e rregjimit të inflacionit të shënjestruar është komunikimi me publikun i planeve dhe objektivave të politikbërësve monetarë që me fjalë të tjera nënkupton rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së bankës qendrore për arritjen e këtyre objektivave. Në vitin 2003, në një kumtesë në Uashington, Bernanke thekson se një ndër elementët kryesorë të zbatimit në praktikë të rregjimit të inflacionit të shënjestruar është dhe strategjia e komunikimit pra procedurat e rregullta të komunikimit me autoritetet politike, tregjet financiare dhe publikun e gjerë. Pra, rritja e popullaritetit të rregjimit të inflacionit të shënjestruar ka ofruar një ndihmesë dhe nxitje drejt hapjes së bankave qendrore.

- **Manaxhimin e pritjeve të tregut**

Në shumë vende, rritja dhe zgjerimi i tregjeve financiare ka rritur së tepërmi rëndësinë e manaxhimit të pritjeve të tregut kjo pasi çmimet e tregut orientohen nga pritshmëritë e aktorëve që marrin pjesë në treg. Duke qenë një pjesë e rëndësishme e politikës monetare, formësimi dhe manaxhimi i pritjeve të tregut arrihen vetëm nëpërmjet një komunikimi efektiv midis bankës qendrore dhe tregut. Në këtë kuadër, Ehrmann dhe Fratzscher (2005) treguan me studimin e tyre se bankat qendrore kanë kontroll direkt vetëm tek norma bazë e interesit, përgjithësisht tek norma një ditore, ndërkohë që sukcesi për arritjen e objektivit të tyre kërkon që ato të jenë të afta të influencojnë çmimet e aseteve dhe normat e interesit për të gjitha maturitetet. Në një fjalim të mbajtur në 20 nëntor 2007 në Bruksel në kuadër të "*Financial market speech series*" të Bankës Qendrore Evropiane, ish

anëtari i Bordit Ekzekutiv Lorenzo Bini Smaghi e sheh komunikimin e bankës qendrore si një vlerë të shtuar në arritjen e objektivave. Për më tepër, sipas tij komunikimi i bankës qendrore mund të jetë aq i rëndësishëm dhe efektiv sa edhe instrumenti tradicional i politikës monetare që është norma bazë e interesit për shkak se pritjet inflacioniste janë faktor përcaktues i sjelljes së agjentëve ekonomikë në punësim, prodhim dhe tregjet kapitale. Duke ndikuar pritjet e agjentëve ekonomikë, nëpërmjet një komunikimi të përshtatshëm, banka qendrore mund të përforcojë madje mund të zëvendësojë ndërhyrjet nëpërmjet normës bazë të interesit. Komunikimi do të cilësohet si efektiv në qoftë se arrin të ndikojë pritjet e agjentëve ekonomik në kahun e dëshiruar.

- **Risitë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit**

Të gjithë jemi dëshmitarë të risive të shumta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që e gjithë bota po përjeton sidomos në dy dekadat e fundit. Pikërisht falë këtyre risive, ka ndodhur që shpejtësia dhe forma e komunikimit nga bankat qendrore gati gati të revolucionarizohet. Kështu, nga format tradicionale të komunikimit nëpërmjet gazetave apo televizioneve, transmetuesit e rinj të njoftimeve të bankave qendrore si faqja zyrtare e internetit apo dhe rrjetet sociale kanë zënë vend të rëndësishëm në praktikat e sotme të komunikimit të bankave qendrore. Thuajse të gjitha bankat qendrore zotërojnë dhe administrojnë faqe interneti ku publikojnë gjithçka rreth aktivitetit të tyre. Përveç hedhjes së informacionit në faqen e internetit me qëllim njoftimin në kohë reale dhe për të qënë sa më pranë tregut dhe publikut të interesuar, bankat qendrore shfrytëzojnë mundësitë që ofrojnë rrjetet sociale. Opsionet⁸⁵ si *RSS, twitter, facebook, youtube, google +, flickr, web-tv*, etj...përdoren nga shumë banka qendrore në shpërndarjen e informacioneve për veprimtarinë e tyre.

85 Shenjat dalluese të opsioneve të përmendura gjenden lehtësisht në faqen kryesore (në ballinë) të internetit të shumë bankave qendrore si Banka Qendrore Evropiane, Anglisë, Suedisë, Çekisë, Rezerva Federale, etj...

III. Komunikimi i politikës monetare të Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankës së Shqipërisë

Banka Qendrore Evropiane: E krijuar më 1 qershor 1998, Banka Qendrore Evropiane (BQE) është një ndër bankat më të reja qendrore. Objektivi kryesor i saj është ruajtja e stabilitetit të çmimeve me një normë inflacioni nën por afër nivelit 2% në periudhë afatmesme. Organi vendimmarrës për politikën monetare është Këshilli Qeverisës⁸⁶ i cili përbëhet nga 6 anëtarët e Bordit Ekzekutiv dhe 19 Guvernatorët e bankave qendrore të vendeve që kanë adoptuar euron. Një nga detyrat kryesore të Këshillit, i cili zakonisht mbledhet 2 herë në muaj, është hartimi i politikës monetare për vendet e eurozonës që përfshin edhe vendimet për objektivat monetarë dhe normën bazë të interesit. Këshilli, çdo 6 javë, vlerëson zhvillimet ekonomike dhe monetare dhe merr vendimin përkatës për politikën monetare. Kalendarari i plotë i mbledhjeve të Këshillit sipas tematikës gjendet i publikuar në faqen e internetit të BQE-së⁸⁷.

Në ditën e mbledhjes kur merret vendimi, në orën 13:35 shpallet në faqen e internetit vetëm vendimi për normën e interesit ndërsa në orën 14:30, Presidenti i shoqëruar nga Zv.Presidenti del në konferencë për shtyp, e cila përmban dhe një sesion pyetje/përgjigje me gazetarët e pranishëm, duke dhënë shpjegimet përkatëse (konferenca mund të ndiqet drejtpërsëdrejti edhe në faqen e internetit). Ky format ndiqet gjithmonë, pavarësisht vendimit që merret për normën e interesit (rritet, ulet apo mbahet e pandryshuar).

Deklarata e Presidentit të BQE-së ndjek rrjedhën si vijon: së pari, lexohet vendimi i marrë për politikën monetare, së dyti, bëhet një vlerësim me detaje duke filluar me analizën ekonomike, së treti, bëhet analiza monetare, së katërti, bëhet një konkluzion që konfirmon vendimin e marrë dhe thekson vendosmërinë për arritjen e objektivit

86 Burimi: <http://www.ecb.europa.eu/ecb/orga/decisions/govc/html/index.en.html>

87 Burimi: <http://www.ecb.europa.eu/events/calendar/mgchg/html/index.en.html>

të shpallur dhe së pesti jepen rekomandime për politikën fiskale dhe reformat që duhet të ndiqen në funksion të arritjes së objektivit dhe rritjes ekonomike. Pak orë pas konferencës publikohet transkripti i plotë në faqen e internetit.

Një nga risitë e fundit të BQE-së është se duke filluar nga janari 2015⁸⁸ ka nisur publikimin e minutave të mbledhjeve të Këshillit Qeverisës për politikën monetare, 4 javë pas zhvillimit të mbledhjes. Minutat e publikuara janë të organizuara në dy pjesë, pjesa e parë përmban informacion për zhvillimet financiare, ekonomike dhe monetare si dhe opsione të mundshme për politikën që duhet ndjekur ndërsa në pjesën e dytë përshkruhen diskutimet e Këshillit dhe vendimi i politikës monetare. Minutat nuk përmbajnë informacion për diskutimet dhe qëndrimin e votës individuale të anëtarëve. Një tjetër risi për vitin 2015 është dhe publikimi i Buletinit Ekonomik 2 javë pas çdo mbledhjeje të Këshillit me informacione të detajuara. BQE-ja është shumë e pranishme edhe në median sociale të tilla si twitter, google +, youtube, flickr, linkedin.

Banka e Shqipërisë: E krijuar si bankë qendrore moderne në vitin 1992, Banka e Shqipërisë (BSH) ka si objektiv kryesor arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve⁸⁹ që praktikisht do të thotë kontrollin e inflacionit. Në terma numerikë, Banka e Shqipërisë ka përcaktuar një nivel inflacioni prej 3%. Organi vendimmarrës për politikën monetare është Këshilli Mbikëqyrës i cili përbëhet nga 9 anëtarë. Një nga detyrat kryesore të Këshillit i cili mblidhet çdo muaj është hartimi, miratimi dhe zbatimi i politikës monetare të Republikës së Shqipërisë. Këshilli i kushton 8 mbledhje të posaçme politikës monetare gjatë të cilave merret dhe vendimi për normën bazë të interesit. Kalendari i plotë i mbledhjeve të Këshillit sipas tematikës gjendet i publikuar në faqen e internetit të BSH-së⁹⁰.

88 Burimi: <http://www.ecb.europa.eu/press/govcdec/otherdec/2014/html/gc141219.en.html>

89 Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar

90 https://www.bankofalbania.org/web/Kalendari_i_Mbledhjeve_te_Keshillit_Mbikqyres_5285_1.php

Në ditën e mbledhjes kur merret vendimi, në orën 16:00, Guvernatori i BSH-së del në konferencë shtypi, e cila përmban dhe një sesion pyetje/përgjigje me gazetarët e pranishëm, duke dhënë shpjegimet përkatëse. Ky format ndiqet gjithmonë, pavarësisht vendimit që merret për normën e interesit (rritet, ulet apo mbahet e pandryshuar).


Deklarata e Guvernatorit të BSH-së ndjek rrjedhën si vijon: së pari, lexohet vendimi i marrë për politikën monetare, së dyti, bëhet një vlerësim me detaje për vendimin e marrë dhe efektet që priten, së treti bëhet një parashikim për të ardhmen dhe së katërti jepen dhe rekomandime përkatëse në funksion të arritjes së objektivit dhe rritjes ekonomike. Deklarata e plotë publikohet menjëherë në faqen e internetit ndërsa disa orë më vonë publikohet edhe transkripti i seancës së pyetje / përgjigjeve. Konferenca mund të ndiqet drejtpërsëdrejti (*live*) në disa prej televizioneve informative kryesore në vend.

Në dallim nga BQE-ja, BSH-ja nuk i publikon minutat e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës si dhe nuk është e pranishme në rrjetet sociale.


IV. Forma e monitorimit të komunikimit të Bankës së Shqipërisë lidhur me vendimin për normën bazë të interesit

Komunikimi i vendimit të politikës monetare lidhur me normën bazë të interesit bëhet nëpërmjet një konference për shtyp të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë në praninë e medias e shoqëruar me një sesion pyetje / përgjigje. Për të monitoruar këtë komunikim ka dy mënyra, ose nëpërmjet ndjekjes së drejtpërdrejtë të konferencës për shtyp / leximit të njoftimit për shtyp ose duke u bazuar në raportimin mediatik. Në një anketim me 200 punonjës të sistemit bankar lidhur me monitorimin e komunikimit të Bankës së Shqipërisë për vendimin mbi normën bazë të interesit rezultoi se 115 të anketuar që përbëjnë dhe 58% të kampionit janë shprehur se ndjekin gjithmonë konferencën

për shtyp / lexojnë njoftimin për shtyp të BSh-së, 47 të anketuar ose 23% e ndjekin shpesh konferencën për shtyp / lexojnë njoftimin për shtyp, 26 të anketuar ose 13% e ndjekin ndonjëherë konferencën për shtyp / lexojnë njoftimin për shtyp dhe 12 të anketuar ose 6% nuk e ndjekin asnjëherë konferencën për shtyp / lexojnë njoftimin për shtyp. Edhe grafikisht, dallohet se interesi për vendimin e BSh-së lidhur me normën bazë të interesit është i lartë dhe monitorohet drejtpërsëdrejti duke ndjekur konferencën për shtyp / lexuar njoftimin për shtyp.



Në raportimin mediatik, bazohen gjithmonë 48 të anketuar ose 24%, shpesh 61 të anketuar ose 31%, ndonjëherë 68 të anketuar ose 34%, asnjëherë 9 të anketuar ose 4% dhe asnjëra nga përgjigjet 14 të anketuar ose 7% (shih grafikun më poshtë)



Gjithsesi pavarësisht këtij rezultati duhet bërë shumë kujdes në monitorimin e medias në mënyrën se si e përcjell / transmeton lajmin dhe argumentat që shoqërojnë vendimin për normën bazë të interesit.

V. Konkluzione

Komunikimi është një ndër pjesët më të rëndësishme në jetën e përditshme të secilit prej nesh dhe jo vetëm. Institucionet publike, bizneset, organizatat, OJQ, etj...e shohin komunikimin si pjesën më të rëndësishme të aktivitetit të tyre të përditshëm. Komunikimi ndër të tjera është një proces përvetësimi. Në dekadat e fundit mjetet e komunikimit kanë pësuar një përparim të jashtëzakonshëm dhe afërsia e organizatave me publikun është rritur ndjeshëm duke zvogëluar në masë të konsiderueshme distancat që ekzistonin më parë. Në elementët përbërës të komunikimit marketing elementi që i përshtatet më shumë veprimtarisë, objektivit dhe që përdoret sot gjerësisht nga bankat qendrore janë marrëdhëniet me publikun të cilat shërbejnë për promovimin, mbrojtjen e imazhit të organizatës apo produkteve / shërbimeve të saj si dhe ndërtimit të marrëdhënieve të mira me publikun.

Që nga përcaktimet e Brunner-it deri më sot komunikimi dhe sjellja e bankës qendrore ndaj publikut ka ndryshuar dhe është transformuar rrënjësisht. Sot bankat qendrore punojnë shumë fort për ta bërë punën e tyre sa më të kuptueshme për publikun, kjo falë edhe filozofisë së re të zbatimit të politikës monetare. Komunikimi tashmë është bërë pjesë integrale dhe shumë e rëndësishme e politikës monetare moderne, që jo më kot BQE-ja dhe shumë banka të tjera qendrore e cilësojnë si zemra e saj. Arsyet kryesore që kanë motivuar bankat qendrore të lëvizin nga tradita e pasjes çdo gjë sekret drejt hapjes së madhe ndaj publikut lidhen me: efektivitetin e politikës monetare, rritjen e nevojës për llogaridhënie, adoptimin e rregjimit të inflacionit të shënjestruar, manaxhimin e pritjeve të tregut si dhe risitë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Nga anketimi i zhvilluar u vu re se

komunikimi i Bankës së Shqipërisë lidhur me vendimin për normën bazë të interesit më së shumti vetmonitorohej nga bankat tregtare, megjithatë duhet bërë shumë kujdes në monitorimin e medias në mënyrën se si e përcjell / transmeton lajmin dhe argumentat që shoqërojnë vendimin për normën bazë të interesit.

Bibliografia

- Bernanke B, Mishkin F S (1997): "Inflation targeting: A new framework for monetary policy?", NBER Working Paper No. 5893
- <http://www.nber.org/papers/w5893>
-
- Bernanke, B S (2003): "A Perspective on Inflation Targeting", remarks at the Annual Washington Policy Conference of the National Association of Business Economists, Washington, D.C., March 25, 2003
- <http://www.federalreserve.gov/boarddocs/speeches/2003/20030325/default.htm#f8>
-
- Bernanke, B S (2004): "Fedspeak", remarks at the Meetings of the American Economic Association, San Diego, California, January 3, 2004
- <http://www.federalreserve.gov/Boarddocs/Speeches/2004/200401032/default.htm>
-
- Blinder, A.S., Goodhart, C., Hildebrand, P., Lipton, D., Wyplosz, C., (2001): "How Do Central Banks Talk?", Geneva Reports on the World Economy 3, Geneva/London: ICMB/CEPR.
-
- Blinder, A.S., Ehrmann, M., Fratzscher, M., De Haan, J., Jansen, D.J., (2008): "Central Bank Communication and Monetary Policy: A Survey of Theory and Evidence", CEPS Working Paper No. 161
-
- Bini Smaghi, L (2007): "The value of central bank communication", Financial market speech series, Landesbank Hessen-Thüringen permanent representation of Hessen in Brussels, Brussels, 20 November 2007,
- https://www.ecb.europa.eu/press/key/date/2007/html/sp071120_2.en.html#ftn.fnid2
-
- Brunner, K (1981): "The art of central banking", Centre for Research in Government Policy and Business, University of Rochester, Working Paper GBP 81-6
-
- Coffin, R., Shaw, M., (1971), Effective Communication of Employee Benefits, American Management Association, 1971
-
- Ehrmann, M., Fratzscher, M (2005): "How should central banks

- communicate", ECB working paper series no. 557 / November 2005
- <http://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/scpwps/ecbwp557.pdf>
-
- Fischer, S (2015): "Monetary Policy Lessons and the Way Ahead", speech at the Economic Club of New York, New York, New York, March 23, 2015
- <http://www.federalreserve.gov/newsevents/speech/fischer20150323a.htm>
-
- Fuga, A. (2014), Komunikimi në shoqërinë masive, Botimet Papirus
-
- Haldane, A.G (2014), Halfway up the stairs, Published in Central Banking Journal on 5 August 2014
- <http://www.bankofengland.co.uk/publications/Documents/speeches/2014/speech751.pdf>
-
- Jenkins, P (2001): "Communicating Canadian Monetary Policy: Towards Greater Transparency," Bank of Canada Review, (Summer): 45-50.
-
- Koxhaj, A., Tomini, F. (2003), Manaxhimi i Komunikimit (botimi i parë), Tiranë, prill 2003
-
- Kotler, P (2003): "Marketing Management" 11th ed. Prentice hall
-
- Kotler, P., Armstrong, G., (2012): "Principles of marketing" 14th ed. Prentice hall
-
- Kotler P., Keller P L (2012): "Marketing Management", 14th ed. Prentice hall
-
- Mishkin, F S (1997): "The economics of Money, Banking, and Financial Markets", 5th ed. Addison-Wesley
-
- Mishkin, F S (2004): "Can central bank transparency go too far", NBER Working Paper No. 10829
- <http://www.nber.org/papers/w10829>
-
- Wolton, D (2005): "Të shpëtojmë komunikimin - Sauver la communication", Flammarion, Paris (Përkthimi dhe botimi shqip: Papirus 2009)
-
- Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar

Abstract

One of the most important things in human life but not only is communication. Over the last decades the communication tools have undergone a tremendous progress while the proximity of public organizations with the public has increased substantially thus reducing significantly the distances that existed before. The case of the central banks can be considered as a typical example. Communication has become the top word of the central banks activity in the last two decades while the place that is taking in their activity today is considered even more important and irreplaceable. Nowadays the communication of the central banks has become a very important instrument of the monetary policy, almost the same as the interest rate. One of the main objectives of an accountable central bank is to have a reliable communication in order to orientate the expectations in an economic environment that changes rapidly. Communication has now become an integral and important part of the modern monetary policy and it is considered from the ECB and many other central banks all over the world as its heart. This article aims to provide the importance of the central bank communication, the communication of the ECB's and BoA's monetary policy as well as the monitoring of the Bank of Albania's communication regarding the decision on interest rate.

Keywords: *central bank, communication, monetary policy, interest rate.*



Msc. Flavia KENAJ
Kolegji Universitar "Wisdom",
Fakulteti i Drejtësisë.
flaviakenaj@gmail.com



**SIGURIA MJEDISORE DHE
INTERPRETIMET NGA SHKOLLAT E
NDRYSHME TË MENDIMIT.**

**ENVIRONMENTAL SAFETY AND
INTERPRETATIONS FROM DIFFERENT
SCHOOLS OF THOUGHT.**

Abstrakt.

Gjatë këtij punimi do të synohet që të arrihet përshkrimi, analizimi si dhe shpjegimi i faktit se si siguria ambientale ka çuar në thellimin dhe zgjerimin e studimeve të sigurisë dhe çështjeve që lidhen me të. Do të kushtohet rëndësi hulumtimit të koncepteve të ndryshme ndaj problemeve që lidhen me sigurinë mjedisore, mënyrat se si ndryshimet në ambient shndërrohen në rreziqe për sigurinë kombëtare dhe në gjenerimin e konflikteve të dhunshme, mënyrën nëpërmjet të cilës degradimi mjedisor jo vetëm shkakton luftë por edhe se si lufta ndikon negativisht në mjedis. Mandej do të shqyrtohet fakti se si të gjithë këta elementë konvergojnë në rreziqe reale ndaj sigurisë njerëzore. Duke u nisur nga një qëndrim deri diku pozitivist mund të themi se kërcënimet më sinjifikante që do të rrezikojnë qënësinë e shoqërisë njerëzore do të jenë ato të lidhura me mjedisin dhe efektet e tij. Vlerësimet dhe kërkimet bashkëkohore kanë mundësuar një sërë të dhënash që tregojnë se rreth një e treta e vdekjeve që ndodhin sot në botë rezultojnë si pasojë e shkaqeve mjedisore që verifikojnë edhe rëndësinë e madha që duhet të ketë një sektor i tillë. Duke u bazuar edhe në kërkimet shkencore substanciale dhe gjithëpërfshirëse një skenar i tillë ka pritshmëri për tu përshkallëzuar në të ardhmen çka e shton interesin tonë në realizimin e një tematike të tillë.

Abstarct.

During this work it will aim to reach description, analysis and explanation of the fact how environmental security has led to the deepening and widening of security studies and issues related to it. We will pay attention to research different concepts to problems related to environmental safety, ways how changes in the environment become threats to national security and to generate violent conflict, the manner by which environmental degradation not only causes war but also how the war affects the environment adversely. Then it will be considered as a fact that all these elements converge to real risks to human safety. Starting from a positivist attitude to some extent we can say that the most significant threats that endanger the essence of human society will be those related to the environment and its effects. Estimates and contemporary research has enabled a series of data showing that about a third of the deaths occurring

in the world today result as a consequence of environmental changes. By relying on substantial research and comprehensively such a scenario has expectations to escalate in the future which increases our interest in the realization of such a theme.

Fjalët Kyçe: siguri, ndryshime mjedisore, traktate ndërkombëtare etj.

Hyrje.

Në shqyrtim të kësaj çështje do të na duhet të evidentojmë analizojmë dhe krahasojmë qasjet dhe interpretimet e ndryshme që kanë të bëjnë më sigurinë mjedisore si një prej elementeve në ditët e sotme më të rëndësishëm të çdo hartimi të strategjive kombëtare të sigurisë dhe të mbrojtjes.

Kërkimi shkencor i bërë në këtë fushë së pari nxjerr në dritë dy interpretime nga më kryesore që dominojnë dhe nga ana tjetër formësojnë rolin që mjedisi në mënyrë të konsiderueshme luan mbi marrëdhëniet dhe arenën ndërkombëtare në përgjithësi.⁹¹ Mendimi dhe analiza e parë që shtron qasja e parë interpretative e këtyre variablave, ose më saktë rolit që edhe më lartë e theksuam, lidhet me faktin se dimension i mjedis dhe ai i sigurisë apo pasigurisë i ka zgjeruar në mënyrë të ndjeshme qëllimet dhe fushat, gjithashtu edhe arsyet e studimeve të sigurisë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky lloj interpretimi që i bëhet sigurisë, i kaluar edhe në diskutimin e mësipërm, vuri në dukje se si ndryshimet në arenën ndërkombëtare, ndryshimi i kontekstit dhe i rrethanave, ndryshimi i mendësive nga ana e politikbërësve e nga ana tjetër edhe reagimet e natyrës e bënë të domosdoshme një rishikim të çështjeve të sigurisë. U braktis edhe pse jo plotësisht, mënyra e të menduarit vetëm në aspektin ushtarak e lidhur me përdorimin dhe konkurrencën mbi fuqinë. Debati u shtrua brënda një kuadri të ri jomilitar që çoi në marrjen në konsideratë edhe të një sërë variablash të rinj duke përfshirë aspektin social, ekonomik, politik dhe më

91 Ndryshimet klimatike shihen në këtë argument si një variabël ndihmës i degradimit mjedisorë, SWAC 2010

me rëndësi atë mjedisor. Për sa i përket qasjes së dytë, mjedisi është një faktor që i dha një këndvështrim dhe një rrotullim me 360 gradë konceptit tradicional të të parit të çështjeve ekonomike dhe politike duke i konsideruar të gjithë variablat e mundshëm që klasifikohen burime shumë të rrezikshme për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kjo mënyrë e të menduarit është bazuar në premisën se për shkak të një shkalle të lartë graviteti që burimet apo problemet e tjera mjedisore mund të sjellin, kanë mundësinë më pas për tu shndërruar në kërcënime reale ndaj sigurisë. Kjo e fundit mund të preket në një shkallë të ndryshme në varësi të problemeve që edhe këto variojnë nga problemet klimatike që më pas sjellin trazira sociale, destabilitet politik, vështirësi të shumta ekonomike, kërcënim ndaj integritetit territorial, tensione të ndryshme diplomatike apo deri në konfrontime të armatosura. Këto studime janë në këtë mënyrë më së shumti të interesuara në dimensionin "konflikt" që rregullon marrëdhëniet midis shteteve duke qënë se ato rrjedhimisht prej tensioneve që përmendëm, përfundojnë në përpjekje në një politikë të përpashkët politike, ekonomike, diplomatike apo ushtarake të shkaktuar në kuadrin e një antagonizmi në lidhje me ambjentin, qoftë ky i një natyre lokale, rajonale apo globale.⁹² Në këtë mënyrë u prezantua në qoftë se mund ta quajmë kështu edhe koncepti i sigurisë mjedisore. Në këtë pikë mund të gjejmë edhe disa arsye që na ndihmojnë për të kuptuar edhe premisën e të dyja këtyre qasjeve dhe njëkohësisht për të kuptuar edhe arsyet se pse politikat dhe çështjet mjedisore u bënë ngushtësisht të lidhura dhe ndihmuan në evoluimin e konceptit të sigurisë mjedisore. Ndër këto arsye mund të përmendim së pari faktin se një numër i lartë studimesh dhe debatesh identifikohen me kushtet socio-politike, specifikisht me varfërinë, nën-zhvillimin skarciteti i burimeve financiare që fshihen pas shqetësimeve të hershme që lidhen me shpyllëzimin, shkretëtimin e tokave apo erozionin e larte.⁹³ Nga kjo mund të

92 Frederick, "La securite enviromentale: Elements de definition", Etudes Internationales, Vol.24, NO.4,

93 <http://id.erudit.org/iderudit/703239ar>

kuptojmë se transformimet në ambjentin tonë të përbashkët natyror, (të konsideruara këto si shqetësimet e hershme mbi mjedisin dhe pasigurinë që e vinte prej fenomeneve negative të lidhura me të) thelluan dhe zgjeruan bindjet dhe konceptualizimin ndaj çështjeve të sigurisë mjedisore. Megjithatë për tu theksuar është edhe fakti se edhe më parë përpjekjet për të qartësuar marrëdhëniet ndërmjet këtyre faktorëve, ndërveprimi që ekziston mes tyre, pra në mes të të gjithë variablave mjedisore dhe midis faktorëve mjedisore dhe atyre socio-politik ende sot premtojnë të jenë kompleks dhe multidimensional. Për më tepër si një arsye të dytë mund të analizojmë faktin që lidhet me përfundimin e përbashkët të dy blloqeve kundërshtarë botërore, pra përfundimin e luftes së ftohtë dhe me këtë rast dhënien fund të frikës për një shkatërrim reciprok të të dyja kampeve kjo si një fakt që lidhet në mënyrë të hapur me sigurinë ushtarake. E gjithë kjo situatë e zhvilluar në kontekstin socio-politik në të cilin kualiteti i jetës shihej si pjesë e sigurisë kombëtare dhe duke i dhënë një shtytje vetë shteteve për të trajtuar problemet mjedisore si çështje të sigurisë.⁹⁴

Koncepti i sigurisë i prezantuar në këtë këndvështrim është tejet nacional. Një shpjegim i mundshëm mund të jetë se pavarësisht se përfitimet mund të jenë internacionale, mekanizmat për menaxhimin e problemeve mjedisore i përkasin akoma në mënyrë primare shtetit duke qënë se jemi në kushtet e mungesës së një mekanizmi apo autoriteti mbikombëtar që të ndërhyjë si një rregullator në zgjidhjen e këtyre problemeve. Kjo në një farë mënyre i shton elementin e pasigurisë sistemit ndërkombëtar duke i detyruar shtetet që të monitorojnë vetëm interesat apo sigurinë vetjake. Si rezultat i këtyre rrethanave është e logjikshme që shtetet të operojnë duke u fokusuar vetëm në siguirinë e tyre kombëtare duke e vlerësuar impaktin e problemeve mjedisore në bazë të sjelljes së qeverive të cilat veprojnë në përmirësimin ose në të kundërt në përshkallëzimin e pasigurisë ambientale. Nën një interpretim të tillë koncepti i sigurisë mjedisore përmbledh aq rëndësi sa shtetet kërkojnë dhe duan ti japin atij. Megjithatë

94 <http://id.erudit.org/iderudit/703239ar>

është i vërtetë fakti se konsideratat mbi problematikat ambientale i tejkalojnë kufijtë teritorialë të një shteti. Për shëmbull migrimet që mund të ndodhin në shtete të ndryshme si në shtetin e Seulit për shkak të ndryshimeve mjedisore mundet që në diskursin politik të shndërrohen në çështje të shteteve OECD. Ky shëmbull tenton të tregojë në kohëzgjatje afatshkurtër se emigrime relativisht të lokalizuara përgjatë periudhave të thatësirës e zëmë reflektojnë në adaptimin e strategjive të emigrimit në varësi të ndryshimeve në klimë.⁹⁵ Gjithsesi studimet kuantitative dhe kualitative janë akoma të pakta ndër kohë që rastet e veçanta të marra në studim duke konsideruar skenarët e ndryshëm si dhe kundraargumentat ndaj tyre sigurojnë veprime të paramenduara shtetërore pa i injoruar frikërat e shprehura.

Duke iu referuar këtyre dy qasjeve që shtjelluam më lartë, mund të themi se siguria mjedisore ka mundësinë të shndërrohet në një variabël të varur (nga një pikpamje globaliste për ndervartësinë midis shteteve) ose një variabël i pavarur dhe në një rast të tillë siguria e shtetit do të jetë variabli i varur.⁹⁶

Më së shumti duke iu referuar më shumë qasjes së dytë, Frederick evidentoi dy tipe lidhjesh për sa i përket analizës tonë. E para i shef problemet mjedisore si faktorët kryesorë të pasigurisë. Hipotezat janë të bazuara dhe në konfrontimet në rritje si konfliktet ekologjike rajonale apo lokale që lidhet me popullsinë ndërkufitare apo keqpërdorimi i burimeve të përbashkëta, duke bërë që të ndodhin transformime në marrëdhëniet e fuqisë brënda një rajoni apo midis rajoneve të ndryshme si rezultat i një numri të madh perturbacionesh mjedisore (ndryshime klimatike, shkretëtimi i tokave, katasastrofat ekologjike dhe të tjera si këto). Një trajtim tjetër që i bëhet degradimit mjedisorë dhe pasojave që lidhen me të është ajo që ato mund të shihen si ndihmëse të faktorit pasiguri. Në raste të trilla antagonizmi mjedisor trajtohet jo direkt në sigurinë

95 Fridley.S.E."Does drought increase migration? A study of migration from rural Mali during the 1983-1985 drought", The centre for migration studies of NY, International Migration Review, Vol.28, NO.3

96 Homer-Dixon, "Environmental scarcity and violence" Princeton, Princeton University Press, fq.50,1999

kombëtare të shteteve duke përkeqësuar tensionin para ekzistues politik, ekonomik, sociale ushtarake apo edhe mbi konfliktet duke i shtuar atyre një dimension krejt të ri.⁹⁷ Të marra së bashku të dyja këto interpretime të ofruara prezantojnë me ndryshime të dukshme lidhjet shkakore që ekzistojnë ndërmjet klimës mjedisit dhe faktorëve apo elementëve të tjerë të sigurisë.

Në qoftë se mundohemi ti kanalizojmë mendimet e ndryshme që ekzistojnë në lidhje me sigurinë dhe mjedisin, atëherë do të mund të përfitonim dy tipe ideale analize. Pikërisht këtu do të mund të përmëdnim dy teori që janë munduar ti japin shpjegim këtyre çështjeve. Ato mund ti grupojmë në torinë e Neo-Maltunianizmit dhe në atë të Kornukopianizmit. (të ekonomistëve optimist).

Degradimi mjedisor ka një inpakt komulutativ social, të tilla si lëvizjet e popullsisë, rënie dhe kolapse ekonomike, dobësim të shtetit. Kjo mund të çojë në përhapjen dhe përshkallëzimin e mëtejshëm të konflikteve ndërshtërre.

Numri i këtyre konflikteve do të vi duke u rritur duke qënë se degradimi vazhdon përparimin e tij të vazhdueshëm.⁹⁸ Në vitet 1990 neo-maltuzianizmi që i përket shkollës së skarcitetit të burimeve, i dha një zhvillim duke përfshirë aspekte që lidhen drejtëpërsëdrejti me shpërndarjen e burimeve dhe duke shpikur termin degradim dhe skarcitet mjedisor.⁹⁹ Brënda këtyre termave të rinj të përdorur përfshihen edhe tri koncepte kryesore që janë; furnizimi, kërkesa dhe struktura të fokusuara këto tek skarciteti sigurisht.¹⁰⁰

Skarciteti i detyruar prej furnizimit i referohet aftësisë fizike të mjedisit për ripërtëritjen e burimeve natyrore. Neo-Maltusianët argumentojnë se marrëdhëniet kazuale pa një sistem ambjental që të jetë i ashpër ndaj një zhvillimi jo-linear për sa i përket

97 Holst, J.J." *Security and the environment: A preliminary Exploration*", Bulletin of Peace Proposals, Vol.20,no.2, fq.123-128,1989

98 Homer - Dixon, "*Environmental scarcity and violent conflict: Evidence from cases*", International security, Vol.19.NO.1, 1994

99 Urdal.H." *People vs Malthus: Population Pressure, Enviromental Degradation, and armed conflict revised*", Journal of Peace Reseach, Vol.42. fq.417-434, 2007

100-<http://docs.google.com/viewer?a=v&q=cache:D9fZl3b65UwJ:gupea.ub.gu.se/bitstream/2077/17856/1/>

funksioneve matematikore që ai përfshin, atëherë sistemi mjedisor mund të përgjigjet në mënyrë të ngadaltë ndaj ndërhyrjes njerëzore për një kohë të gjatë e mandej papritmas mund të ndryshojë karakter.¹⁰¹ Faktorë të rëndësishëm mjedisorë janë për shembull ngjarje ekstreme të tilla si ngrohja globale që mund të pasohet nga pasoja shkatërrimtare, degëzimi i karakterit të degradimit dhe skarciteteve në sistemin mjedisor si dhe ndërveprimi i vazhdueshëm njerëzorë që ka edhe ky inpaktin e vet mbi sistemin (për shembull mbinxjerrja dhe shumëpërdorimi i një lloji të caktuar burimi në një zonë të caktuar mund të ndikojë mbi ekosistemin që e rrethon dhe mund të ketë pasoja sinergjitike). Neo-Maltusianët argumentojnë se sistemi i mbështetjes së jetës së qyteatarëve të gjithë botës duke u shtyrë deri në limitet e tij duke e bërë të pazjistueshëm edhe dëmin mjedisor të shkaktuar. Kjo më tej reflektohet në shkatërrimin e tokave pjellore, të pyjeve, ujrave dhe botës bimre dhe shtazore në përgjithësi.¹⁰²

Skarciteti i shkaktuar prej kërkesës si faktori i dytë i skarcitetit dhe i pasigurisë gjithashtu, shihet në bazë të kësaj teorie si një variabël kyç që ndikon në degradimin mjedisor dhe në implikimet që kjo më tej sjell në lidhje me sigurinë. Ky faktor i referohet më së shumti përmasave të popullsisive dhe kërkesës për frymë ndaj burimeve që ekzistojnë realisht. Kështu një rritje e madhe dhe e menjëhershme e kërkesës për burime të caktuara sjell si pasojë skarcitetin dhe e ul në mënyrë të ndjeshme aftësinë ripërtëritëse të resurseve natyrorë dhe çfarë është më e rëndësishmja në gjenerim të konflikteve të armatosura.¹⁰³

Ndërkohë që faktori i tretë i përmendur nga analiza neo-maltusiane ka të bëjë me skarcitetin struktural që i referohet aksesit relativ ndaj burimeve prej grupeve të ndryshme shoqërore dhe

101 Homer-Dixon "On the threshold: Enviromental changes as a causes of acute conflict", International Security, Vol.16, fq.2

102 Erlich,P,Erlick.A,"Betrayal of science and reason", Washington DC;, Island Press, fq.45,1998

103 Dimond,J.M,,"Collapse: How societies choose to fail or succeed", London, Pinguin Uk, fq.187 ,2006

një ndarjeje jo të barabartë të këtyre burimeve duke favorizuar ndjeshëm disa nga këto grupe. Këto të fundit që kanë një aftësi të tillë do të kenë mundësi nëpërmjet këtyre mjeteve për tu pasuruar dhe për të krijuar një mjedis më cilësor për veten duke qënë se rrisin nivelin e mirëqënies në krahasim me pjesën tjetër që do të ngelet në varfëri dhe ku rreziku prej kërcënimeve mjedisore por jovetëm do të jetë një rrezik permanent dhe i një niveli të lartë.

Këto tre komponentë që analizuam që i referohen degradimit veçmas ose në mënyrë të kombinuar kanë mundësinë për të prodhuar efekte tejet negative sociale (produktivitet të limituar agrokultural, ekonomik, emigrime masive, rënie dhe dobësim të qeverive dhe institucioneve, konflikte dhe përçarje etnike) dhe natyrore të cilat mund të kenë implikime në sigurinë kombëtare dhe globale duke shkaktuar konflikt të armatosur. Shkolla e Torontos, pra aty ku janë formësuar këto ide, kanë pritshmërinë se degradimi mjedisor ka një influencë gjithmonë e më të madhe duke e bërë ekosistemin akoma edhe më të brishtë duke qënë se popullsia vjen duke u rritur dhe konsumi bashkë me të.¹⁰⁴

Teoria e dytë që është objekt studimi i temës tonë dhe që analizon edhe kjo implikimet e mjedist mbi sigurionë është ajo e quajtur Kornukopianizmi. Do të ketë gjithmonë dhe në mënyrë ciklike probleme që lidhen me burimet natyrore dhe me mjedisin në prani të grindjeve, gabimeve politike apo katastrofave natyrore- që ndodhin gjithkund aty ku janë njerëzit. Por, nga ana tjetër, bota natyrore lejon ashtu sikundër bota e zhvilluar promovon përmes tregtisë një përgjgje ndaj nevojave njerëzore dhe mungesave që ato paraqesin.¹⁰⁵ Sipas kësaj teorie që gjen një mbështetje të madhe tek ekonomistët neo-klasik, argumentohet se mjedisi natyror, nuk paraqet burime të limituara në terma të popullsisë apo të konsumizmit. Në kontrast ky lloj interpretimi që i bëhet çështjes së sigurisë mjedisore ka besimin te mirëfunksionimi i tregut (për

104 Homer-Dixon, "Environmental scarcity and violence" Princeton, Princeton University Press, fq.67

105 Julian.S.L." The ultimate resource,2", Princeton New Jersey, Princeton University Press, fq.98,1981

shembull me mekanizmin veteregullues të çmimeve, inkurajimin e mbrojtjes së mjedisit, resurset e ripërtëritshme apo inovacionet në teknologji.)¹⁰⁶ Të tillë faktorë të çojnë në besimin se skarciteti i burimeve natyrore zgjon një rritje të zgjuarsisë dhe trendin e inovacioneve për të çarmatosur në këtë mënyrë konceptet negative në lidhje me efektet e degradimit dhe pasigurisë.¹⁰⁷ Përgjatë historisë, mjetet dhe njohuritë e reja kanë bërë që burimet natyrore të jenë më lehtë të zotërueshme. Në një periudhë afatgjatë nuk ka pse të ekzistojë rreziku për limite praktike për të ngadalësuar hapin e shoqërisë për t'u përmirësuar dhe më shumë në të ardhmen. Megjithatë në periudha afatshkurtra ata argumentojnë se burimet natyrore që formojnë mjedisin natyror në tërësi janë të limituara gjë që më pas do të reflektohet në presione mbi furnizimin çmime të larta dhe në konflikte të dhunshme.¹⁰⁸ Nëse njerëzit konfliktuon për resurse natyrore kjo sipas asaj që thonë kornukopinistët do të thotë se është për shkak të ndërhyrjeve politike duke u munduar që të shmangin skarcitetin lokal. Ata argumentojnë se resurset natyrore janë në një transformin të përhershëm madje dhe të vlefshëm përkundër idesë se skarcitetit. Kjo shtyn në kërkimin dhe gjetjen e zgjidhjeve të reja për të shpëtuar shoqërinë prej problemeve të tilla. Po sipas kësaj teorie mjetet dhe zgjidhjet e reja janë gjetur dhe duke qënë se sot kemi më shumë mëndje e rrjedhimisht më shumë njohuri si pasojë e rritjes së popullsisë kemi ide të reja për të shmangur pasigurinë. Në terma afatgjatë pra njerëzit nuk do të konsiderohen më si faktorë për degradimin mjedisor.

Në këtë mënyrë morëm dy përqasje krejt të ndryshme në argumentime për sa i përket ambjentit dhe ndikimit të tij në siguri dhe mënyrat se si ndikojnë ato tek njëri tjetri dhe për më tepër a mund të gjejmë implikime të vlefshme apo jo. Ato nuk puqen me

106 Gleditch.N.P.“ *Armed Conflict and the enviroment: A critique of the literature*“ Journal of Peace Research, Vol.35(3), Special issue on enviromental conflict, Sage Publication,Ltd, Fq.381-400,1998

107 Mathew. ,R.”*Resource scarcity: Responding to the scarcity challenge*”,Internatinal Peace Institute,fq.34,2008

108 Ayres.R. “*Cowboys,cornucopians and sustainability*”, Ecological Economics, Vol.8, Amsterdam, Elsevier Science Publisher, fq.187

njera tjetrën për sa i përket faktit se ndryshimet që pëson mjedisi i sotëm natyrorë ka efekt të ndjeshëm mbi sigurinë lokale rajonale apo globale. Sipas të parëve limitet që mjedisi paraqet gjeneron mangësi për popullsinë në të gjithë botën edhe pse kjo ndodh në mënyrë të diferencuar në shkallë pasurore. Vulnerabiliteti i njerëzve në këto raste është i lartë duke u bërë pre i rreziqeve të shumta si katastrofave ashtu edhe konflikteve.

Kritika e kornukopianistëve thekson se ndryshimet në ambient janë konstruktive dhe pozitive duke i detyruar njerëzit që të gjejnë mënyra të reja për t'u përshtatur mjedisit dhe vetë njerëzit do të jenë burim dhe nuk do të ketë aspak rezik për konflikte të armatosura.

Marreveshjet, aktet dhe traktatet kryesore shumepaleshe ne lidhje me mjedisin te nenshkruara nder vite

Marrëveshjet në mbështetje të mjedisit sidomos ato të nënshkruara para viteve 1990, janë shumëfishuar dhe kanë marrë një rëndësi të veçantë. Ato kanë ndihmuar në intensifikimin e marrëdhënieve midis shteteve duke iu referuar këtyre çështjeve, duke i dhënë një dimension legal dhe të detyrueshëm aksioneve të përbashkëta të ndërmara në mënyrë vullneatre dhe të ndërgjegjshme prej tyre.

Samiti i Tokës, i vitit 1992 në Stokholm ishte një angazhim paraprirës.¹⁰⁹ Nga ai, një traktat i veçantë nisi një marrëveshje mirëkuptimi për ruajtjen e biodiversitetit në të gjithë botën. Ai bëri që qeveritë e shteteve të nxirrnin strategji për ruajtjen e habitateve, mbrojtjen e specieve të rrezikuara, të zgjeronin zonat e mbrojtura dhe të ripunonin ato të dëmtuarat. Qysh atëherë, bota është përpjekur të bashkëpunojë nëpërmjet përpjekjeve në rritje të përqënduara në arritjen e marrëveshjeve dhe për ti mbështetur ato me traktate të ratifikuara për mbrojtjen e bashkësisë mbështetëse globale.

Traktati i biodiversitetit u pasua nga përpjekje të tjera ndërkombëtare që kanë të bëjnë me problematikat mjedisore me anë të marrëveshjeve globaliste. Një shembull i madh ishte

109 United Nations Conference on Environment and Development. "Agenda 21: Table of Contents. Earth Summit, 1992". Habitat.igc.org. Retrieved 4 August 2014.

Protokolli i Kiotos i vitit 2005 në të cilin 156 vende që llogariten se lëshojnë së paku 55 për qind të gazit serë global, u zotuan të ulnin lëshimin e gazrave që ndikojnë në ngrohjen globale poshtë nivelit të vitit 1990, deri në vitin 2012¹¹⁰. Vetëm Shtetet e Bashkura refuzuan të bashkëpunonin. Por edhe kjo rezistencë ka gjasa të ndryshojë. Në vitin 2007 Gjykata supreme e SHBA-së paraqiti një vendim që dënonte indiferencën e presidentit Bush ndaj rreziqeve të lëshimit të karbonit në atmosferë dhe ngrohjen globale. I detyruar të rishikonte pozitën e tij, Bushi pa dëshirën e tij, ra dakord për ta konsideruar seriozisht rrezikun e ngrohjes globale dhe ndotjes së madhe të botës. Shtetet e bashkuara premtuan se do të bënin ndryshime për të ndaluar rreziqet para se të ishte shumë vonë. Në dhjetor të 2007-ës, 190 vënde u takuan në Bali të Indonezisë dhe ranë dakord të negocionin në 2009 një traktat të ri për të luftuar ngrohjen globale. Ky hap tentues frymëzoi shpresën se duheshin krijuar të tjerë traktate të mbrojtjes globale dhe provoi se ishte po aq i sukseshëm sa ç'doli të ishte traktati i Protokollit të Montrealit mbi Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit.

Përfundime

Duke pasur parasysh kërcënimet në rritje të mjedisit, përgjigja kolektive është e kuptueshme. Siç dokumentohet, ka prova të bollshme për t'u mobilizuar për veprim kolektiv pasi ka arsye të forta për të besuar se burimet natyrore po shterojnë. Ndotja e botës vazhdon të rritet në norma që kërcënojnë të lënë gjithmonë e më pak ushqim për njerëzit. Pyjet po shkatërohen dhe rezervat e peshkut po zhduken. Ajri dhe uji i planetit po bëhen gjithnjë e më të ndotura dhe ngrohja globale keqëson të gjitha këto prirje alarmuese.

Pyetja me të cilën përballet bota sot është nëse përgjigja e deritanishme është ajo e duhura. Traktatet ndërkombëtare mjedisore janë rritur në mënyrë eksponenciale në njëqind e tridhjetë vitet e fundit. Megjithatë, shumë skeptikë kanë frikë se këto përpjekje janë

110 <https://unfccc.int/resource/docs/convkp/kpeng.pdf>

shumë pak, shumë të vonuara dhe është bërë jo i mjaftueshëm për të shpëtuar bashkësinë globale për brezat e ardhshëm. Për t'u parë në një periudhë afatgjatë është mjedisi ekologjik global në rrezik. Shumë dyshojnë mbi aftësinë e traktateve të sotme ekzistuese për të manaxhuar rreziqet mjedisore me të cilat po përballemi. Disa janë të dobët dhe paraqesin shqetësim pa urdhëruar ndryshimet e domosdoshme për politika për rregullimin e problemeve të ndryshme që ata indentifikojnë. Një shqetësim i veçantë është përkrahja mosdashëse e superfuqive të globit si Shtetet e Bashkuara për shembull. Nga tridhjetë e një marrëveshjet globale mbi mjedisin të kombeve të bashkuara, Shtetet e Bashkuara kanë ratifikuar vetëm dhjetë prej tyre.

Ajo që druhen edhe aktivistët po edhe ata që merren me studimet e sigurisë në mbrojtje të mjedisit shqetësohen se nëse vetë Amerika refuzon të udhëheqë, perspektivat për fuqizimin e rregullave të regjimit të ruajtjes mjedisore do të jenë të dobta.

Bibliografia.

- Ayres.R. "Cowboys, cornucopians and sustainability", Ecological Economics, Vol.8, Amsterdam, Elsevier Science Publisher.
- Dimond, J.M., "Collapse: How societies choose to fail or succeed", London, Pinguin Uk, 2006
- Erlich.P, Erlick.A., "Betrayal of science and reason", Washington DC; Island Pres, 1998
- Frederick, "La securite enviromentale: Elements de definition", Etudes Internationales, Vol.24, NO.4,
- Fridley.S.E. "Does drought increase migration? A study of migration from rural Mali during the 1983-1985 drought", The centre for migration studies of NY, International Migration Review, Vol.28, NO.3
- Gleditch.N.P. "Armed Conflict and the enviroment: A critique of the literature" Journal of Peace Research, Vol.35(3), Special issue on enviromental conflict, Sage Publication, Ltd, 1998
- Holst, J.J. "Security and the environment: A preliminary Exploration", Bulletin of Peace Proposals, Vol.20, no.2, 1989
- Homer- Dixon "On the threshold: Enviromental changes as a causes of acute conflict", International Security, Vol.16.
- Homer- Dixon, "Environmental scarcity and violent conflict: Evidence from cases", International security, Vol.19.NO.1, 1994
- Homer-Dixon, "Environmental scarcity and violence" Princeton, Princeton University Press, 1999
- Julian.S.L. "The ultimate resource, 2", Princeton New Jersey, Princeton University Press, 1981
- Mathew. ,R. "Resource scarcity: Responding to the scarcity challenge", Internatinal Peace Institute, 2008
- United Nations Conference on Environment and Development. "Agenda 21: Table of Contents. Earth Summit, 1992". Habitat.igc.org. Retrieved 4 August 2014.
- Urdal.H. "People vs Malthus: Population Pressure, Enviromental Degradation, and armed conlct revised", Journal of Peace Reseach, Vol.42., 2007.



Dr. Edit BREGU
Kolegji Universitar "Wisdom",
Fakulteti i Drejtësisë.
edit_kane@yahoo.com

**KONGRESI I VJENËS 1815,
DIPLOMACIA E PAQES SË
QËNDRUESHME NË SISTEMIN
EVROPIAN DHE BALLKANIK TË
EKUILIBRIT TË FORCAVE**

Abstrakti

Që nga fundi i Shek. XVIII, Parisi, Londra, Vjena dhe Shën Peterburgu kishin përgatitur dhe mbanin gati plane të posaçme operative për trajtimin e problemeve në Lindje. Ndërkohë, Franca e, sidomos Britania, ishin përgatitur të përdornin metoda diplomatike dhe ushtarake për ta mbajtur më këmbë Perandorinë Osmane, "e tronditur tashmë nga themelet".

Nga ana e tyre Rusia dhe Austro-Hungaria anonin nga idea e ndarjes së plaçkës osmane. Megjithatë, duhet theksuar se, edhe pse planet lëviznin sa herë që erërat në marrëdhëniet ndërkombëtare ndryshonin në mënyrë të paparashikuar, ato rrallë mernin parasysh aspiratat e popujve që banonin në këto rajone.

Ishte krejt e natyrshme në atë periudhë të historisë së politikës botërore që, për hir të interesave të tyre të çastit, Fuqitë e Mëdha të votonin pro planeve të cilat sillnin si rezultat që etni të ndryshme të përfshiheshin herë brenda territorit të një shteti, e herë në atë të një shteti tjetër. Tek e fundit ishte popullsia e thjeshtë që do të pësonte në kurriz të saj luftëra të përgjakshme, dëbime masive, genocid e të tjera si këto.

Në këtë prirje, sipas shumë studiuesve dhe për gjykime sa më reale, duhen parë njëkohësisht ndikimi dhe ecuria e mëtejshme në Ballkan, me ndryshimet në gjeopolitikën e re në Kontinentin Evropian, të paktën që me fillimet e Shek. XIX. Kështu, dihet që, pothuajse gjatë këtij shekulli, në kontinent nuk ka patur luftëra të mëdha. Dhe merita për këtë i përket pikërisht Koncertit Evropian të vitit 1815.

Fjalë kyçe: *Diplomaci, Fuqitë e Mëdha, Ballkan, Perandoria Osmane, Kongresi i Vjenës.*

Në këndvështrimin lidhur me origjinën e luftërave ballkanike, duhet theksuar se situata e kohës së zhvillimit të këtyre luftërave dhe, sidomos, ajo pas tyre, përgjan shumë me kushtet që ekzistonin para

se të vinin turqit në Evropë. Në atë kohë, si gjatë Luftërave Ballkanike e më pas, shtetet e krishtera luftonin vazhdimisht kundër njëri tjetrit për hegjemoni në gadishull. Gjithsesi, gjatë pushtimit turk, megjithse edhe popullsitë u përzier dhe u fundosën, ndërjegjia kombëtare nuk u shua tërësisht.

Njëherëshi është bërë e njohur ecuria e rritjes së frymës kombëtare në Ballkan, duke filluar që nga hershmëria e ditëve të pushtimit turk. Autorë të ndryshëm pohojnë se, Fuqitë e Mëdha e kishin parashikuar shpërbërjen e Perandorisë Osmane gati një shekull para Krizës së Madhe Lindore.

Lidhur me këtë parashikim, historiani Misha Gleni (Mischa Glenny), i vlerësuar shumë për studimet mbi Ballkanin, ka shkruar: *"Viktima të despotizmit e të dhunës në vendet e veta, ata (emigrantët polakë e hungarezë, që shërbenin në ushtrinë osmane në Bosnje), u bënë vegël, me të cilën Sulltani shtypte të gjitha lëvizjet dhe trazirat në Turqi, pavarësisht nga idetë, aspiratat dhe shkaqet e tyre; shërbenin e vdisnin në fushata ushtarake që, në të vërtetë, vetëm sa e përshpejtonin ngarendjen e pamëshirshme drejt shembjes së kësaj perandorie të mplakur e të parathënë për të vdekur, për të cilën nuk gjendej më ilaç që ta shëronte. Sepse të dyja bashkë, ilaçi dhe sëmundja, ishin njëloj vdekjeprurëse për të!"¹¹¹*

Që nga fundi i Shek. XVIII, Parisi, Londra, Vjena dhe Shën Peterburgu kishin përgatitur dhe mbanin gati plane të posaçme operative për trajtimin e problemeve në Lindje. Ndërkohë, Franca e, sidomos Britania, ishin përgatitur të përdornin metoda diplomatike dhe ushtarake për ta mbajtur më këmbë Perandorinë Osmane, "e tronditur tashmë nga themelet".

Nga ana e tyre Rusia dhe Austro-Hungaria anonin nga idea e ndarjes së plaçkës osmane. Megjithatë, duhet theksuar se, edhe pse planet lëviznin sa herë që erërat në marrëdhëniet ndërkombëtare

111 Misha Glenny, *Histori e Ballkanit 1804-1999*, (Tiranë: TOENA, 2007), 73.

ndryshonin në mënyrë të paparashikuar, ato rrallë mernin parasysht aspiratat e popujve që banonin në këto rajone.

Ishte krejt e natyrshme në atë periudhë të historisë së politikës botërore që, për hir të interesave të tyre të çastit, Fuqitë e Mëdha të votonin pro planeve të cilat sillnin si rezultat që etni të ndryshme të përfshiheshin herë brenda territorit të një shteti, e herë në atë të një shteti tjetër. Tek e fundit ishte popullsia e thjeshtë që do të pësonte në kurriz të saj luftëra të përgjakshme, dëbime masive, genocid e të tjera si këto.

Në këtë prirje, sipas shumë studiuesve dhe për gjykime sa më reale, duhen parë njëkohësisht ndikimi dhe ecuria e mëtejshme në Ballkan, me ndryshimet në gjeopolitikën e re në Kontinentin Evropian, të paktën që me fillimet e Shek. XIX. Kështu, dihet që, pothuajse gjatë këtij shekulli, në kontinent nuk ka patur luftëra të mëdha. Dhe merita për këtë i përket pikërisht Koncertit Evropian të vitit 1815.

Në vitin 1815, në Evropën e vjetër, ndodhi një ngjarje historike, rëndësia dhe aktualiteti i vendimeve të së cilës i kapërçen shekujt dhe e ruan vlerën edhe për Evropën e sotme. "*Kongresi i Vjenës futi një filozofi të re dhe një koncept të ri mbi vetëvendosjen në drejtimin e pushtetit. Kjo periudhë përfundon rreth viteve 1917-1918*".¹¹²

Kongresi i Vjenës i dha fund parimit të kombësisë, dhe vendosi ekuilibrin e forcës të bazuar mbi legjitimitetin dinastik aristokratik, i cili në ato vite, ishte në rend të ditës sidomos pas humbjes së Napoleon Bonapartit në Vaterlo. E thënë ndryshe territore të ndryshme të banuara nga popullsi të ndryshme mund të këmbeshin ndërmjet shteteve vetëm për hir të vendosjes dhe ruajtjes së ekuilibrit të forcës.

Zbatimi i këtij parimi në ndarjet territoriale, duke qenë se nuk merrte parasysht mendimet e popullsive që banonin në to, do të sillte probleme të pariparueshme. Sa herë kishte përpjekje opozitare për të

112 Enver Hasani, *Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti i Jugosllavisë*, (Prishtinë: Gjon Buzuku, 2010), 59.

ndryshuar diçka ato u shtypën në kohë rrufe vetëm për hir të ruajtjes së ekuilibrit të forcës, momethënë, interesave të Fuqive të Mëdha evropiane.

Kjo ishte filozofia që do të sundonte deri në vitin 1918, kur do të hynin në lojë të tjera mekanizma të rregullimit të pushtetit dhe ekuilibrit në marrëdhëniet ndërkombëtare, mekanizmat liberale Willsoniane.

Por, *"Gjithsesi pati edhe përjashtime, si psh. në lidhje me shkëputjen e plotë, njohjen e pavarësisë së një popullsie të caktuar, si shprehje e vullnetit të saj. Mes këtyre përjashtimeve, një nga më të dukshmit ishin rastet e pavarësisë së Greqisë (njohja e pavarësisë së Greqisë më 3 shkurt 1830 shënoi ndryshimin e parë kryesor në hartën e Evropës që nga viti 1815) dhe të Belgjikës, revolucionet e viteve 1840, plebishitet italiane, që çuan në unifikimin e Italisë dhe më në fund aktet gjermane dhe italiane të unifikimit, bashkimi i Gjermanisë në vitin 1871 në Pallatin e Pasqyrave në Versajë të Parisit, pas Luftërave Franko-Prusiane si dhe Bashkimi i Italisë në vitin 1861".*¹¹³

Meterniku i Austrisë, Fon Hardenberg i Prusisë, Kestëllrag i Britanisë, car Aleksandri i Parë i Ruisë, Talejrani si përfaqësues i Luigjit të 18-të, të porsa restauruar të Francës, ishin lojtarët e këtij koncerti. Këta pesë burra shteti arritën atë që kishin menduar.

Pas Koncertit të Vjenës të vitit 1815, Evropa e "Vjetër", e karakterizuar nga luftëra të përhershme për sundim e pushtet, përjetoi periudhën më të gjatë të paqes që kishte përjetuar ndonjëherë. Për dyzetë vite nuk u zhvilluan luftëra midis Fuqive të Mëdha. Pas konfliktit në Krime, në vitin 1854, nuk pati luftë të përgjithshme edhe për 60 vite të tjerë.

Pikërisht kjo dukuri i dedikohet një ekuilibri të fortë, që propozonte dhe "garantonte" ekzistencën e Francës, Gjermanisë, Austro-Hungarisë dhe Ruisë si elementë mbizotërues mbështetur fort nga

113 Hasani, *Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti i Jugosllavisë*, 60.

Britania e cila, me flotën mbretërore vijonte të ruante të palëkundur pozicionin e saj të hegjemonit apo "mbretëreshës së detrave".

Interesante është konsiderata që që fuqitë e mëdha europiane kanë ndaj Perandorisë Osmane, në këtë periudhë të rëndësishme historike. Studiuesi dhe historiani turk M. Sükrü Hanioglu mendonte se ashtu si dhe shumë studiues të tjerë se regullat e reja të diplomacisë europiane pas vitit 1815, vendosën një standart të ri në stabilitetin dhe ekuilibrin në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Sipas tij: *"Për të qenë të qartë, ruajtja e status-quo-së, nuk nënkuptonte aplikimin e këtij parimi në Perandorinë Osmane, shtet i cili as nuk ishte pjesë e shteteve që firmosën ndonjë prej traktateve më të rëndësishme në fund të epokës napoleoniane dhe as nuk mori pjesë në koalicionet që rrëzuan dhe mundën Napoleonin. Gjithësesi në praktikë, nuk kishte dyshime se Perandoria Osmane ishte në axhendën europiane, të paktën për aq kohë sa Europës nuk është se i interesonte se çfarë ndodhte në territoret osmane"*¹¹⁴. Më tej ai vazhonte analizën: *"Në kuptimin e ekuilibrit të forcave në Europë, Perandoria Osmane kishte vetëm kuptim negativ, megjithëse perandoria otomane vetë nuk mund të përbënte për një kohë të gjatë rrezik për asnjërin prej fuqive europiane, mbetet fakti se një kapitullim i mundshëm i saj ndaj ndonjëres prej fuqive të mëdha mund të kthehej në rrezik dhe kërcënim për të tjerat"*¹¹⁵.

Në këtë strukturë të ndërlikuar mbështetej jo vetëm Evropa, por, edhe sigurimi i SHBA-së. Politikani dhe diplomati i shquar i Shek. XX, Henri Kissinger do të shkruante lidhur me këtë fakt se: *"Një paqe ndëshkuese mban peng rendin ndërkombëtar, sepse u ngarkon fituesve të lodhur nga lufta detyrën për të mbajtur nën kontroll një vend, që është i vendosur të prishë zgjidhjen e arritur"*¹¹⁶ Kjo e keqe do të ishte Traktati i

114 M. Sükrü Hanioglu, *A brief history of the Late Ottoman Empire*, (New Jersey: Princeton University Press, 2008), 207.

115 M. Sükrü Hanioglu, *A brief history of the Late Ottoman Empire*, 207.

116 Henry Kissinger, *Diplomacia*, (Tiranë: Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1999), 81.

Versajës, i mbajtur pas përmbylljes së Luftës së Parë Botërore.

Fituesit e Kongresit të Vjenës, ashtu si fituesit e Luftës së Dytë Botërore kishin mundur të shmangnin pikërisht këtë gabim. Nuk ishte e lehtë të tregoheshë i duruar dhe zemërgjerë ndaj Francës, e cila ishte përpjekur të nënshtronte dhe sundonte Evropën.

Por burrat e shtetit në Vjenë, arritën në përfundimin se Evropa do të ishte më e sigurt nëse Franca do të ishte më shumë e kënaqur, sesa e fyer dhe jomiqësore. Franca u privua nga pushtimet e saj, por asaj ju dhanë kufijtë e saj "të vjetër", domethënë të pararevolucionit, megjithse ato përfaqësonin një territor mjaft më të gjerë nga ai që kishte drejtuar më parë Risheljeja i famshëm.

Në se bëhet një vëzhgim kronologjik i ngjarjeve përpara se të niste Kriza Lindore, Luftërat Ballkanike dhe më pas Lufta e Parë Botërore, do të vërehet se bota pati përjetuar paqe, për gati gjysmë shekulli. Por, çfarë ndodhi më pas?! Në Koncertin e Evropës, u ndeshën burra shteti dhe diplomatë me eksperiencë, ku secili prej tyre zotëronte aftësi të spikatura udhëheqëse dhe negociuese.

Në këtë larmi figurash pa diskutim do të shfaqeshin diplomacia e "hollë" aristokrate e Meternikut, zgjuarsia dhe dinakëria e Talejranit, logjika e "ftohtë" britanike e Lordit Kestëllrag. Rezultatet e kësaj tabloje personazhesh dhe karakteresh karizmatikë, u dukën në atë çfarë i ofroi diplomacia e Koncertit European historisë politike dhe njerëzore të atyre viteve. Por, menjëherë pas kësaj periudhe situata e forcave ushtarake dhe ekonomike kishte ndryshuar shumë.

Nga njëra anë, në skenën e fuqive dhe interesave, paraqitet një aktor si perandoria multinacionale osmane, tashmë tejet e dobësuar ekonomikisht dhe ushtarakisht, gjë që do të sillte shtimin e veprimtarisë dhe përpjekjen e Fuqive të Mëdha sidomos të Rusisë, për të marë pjesën, kur të zhvillohej Lufta Ruso-Turke.

Nga ana tjetër në vitin 1871, realizohet një ngjarje e rëndësishme në historinë e popullit gjerman dhe, siç do të tregonin faktet më vonë për

të gjithë historinë botërore, bëhet Unifikimi i Gjermanisë nën drejtimin e kancelarit Oto fon Bismark (Otto Von Bismarck). Gjermania e atyre viteve po përjetonte një zhvillim ekonomik dhe ushtarak tejet të ndjeshëm, duke ndryshuar kështu raportin e shpërndarjes së fuqisë në kontinent.

Por, Bismarku nuk ishte i përjetshëm dhe, pasuesve të tij për fat të keq do t'u mungonte një nga elementet bazë në bërjen e një politike të sukseshme, matura. Analistë të ndryshëm kanë arritur në përfundim se, Kongresi i Vjenës, pos të tjerash, mënjanoi nacionalizmin në favor të ruajtjes së paqes. Nacionalizmi shihej nga udhëheqësit dhe diplomatët e asaj kohe si shkak i revolucioneve, të cilët përbënin një kërcënim serioz që mund të minonte ekzistencën e monarkive tradicionale europiane.

Në një farë mënyre revolucionet, të lidhura ngushtë me nacionalizmin, ishin sfidë e vendimeve të Kongresit të Vjenës. *"Revolucionet e vitit 1848 ishin dy llojesh: Liberale dhe Kombëtare"*.¹¹⁷ Sipas parimeve të ekuilibrit të forcës të Koncertit Evropian, për paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar, kërcënim më të madh përbënin "... revolucionet kombëtare në Perandorinë e Habsburgëve, si Bohemia, Hungaria dhe Italia dhe ato që zhvilloheshin në dukatet e Shlezvig-Holshtajnit".¹¹⁸

Ndërkaq, revolucionet si, ato në Francë apo Prusi ishin të parrezikshëm për ekuilibrin e forcës dhe, madje, mund të konsideroheshin të një natyre liberale sepse ata synonin ndryshimin e rendit kushtetues dhe qeverisës brenda vendit të tyre. Kështu që, për momentin, ato nuk përbënin rrezik për Fuqitë e Mëdha evropiane. Mirëpo koha do të tregonte se, megjithë përpjekjet e Meternikut për ndalimin e lëvizjeve revolucionare, ato nuk do të ndalonin. Madje, dhe vetë Meterniku do të largohej nga skena politike.

Sipas studiuesit Misha Gleni (Mischa Glenny), *"Sistemi i Vjenës, i*

117 Hasani, *Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti i Jugosllavisë*, 60.

118 Po aty.

projektuar për të mbrojtur absolutizmin dhe ekulibrin e forcave, kishte marrë fund, kurse arkitekti i saj, princi Meternich, mërgoi si Lui Filipi. Aleanca e Shenjtë që lidhte Prusinë dhe Austrinë në kryqëzatën e tyre kundër liberalizmit ishte paralizuar"¹¹⁹.

Për rrjedhojë, pas Koncertit, Gjermania dhe Italia u lanë si shtete të ndara, por historia vërtetoi se lëvizjet e forta nacionaliste dhe revolucionet çuan në bashkimin e Italisë më 1861 dhe të Gjermanisë më 1871. Ndërkohë, si rezultat i Luftës Franko-Prusiane, Francës i u shkëput dhe e humbi Alsas Lorenën, e cila i u dha Gjermanisë, prandaj revanshi mbeti objekt kryesor, i përhershëm i francezëve. Ndërkaq, nacionalizmi shkaktoi probleme edhe për Austro-Hungarinë dhe vendet e Ballkanit, zona të përfshira në shumë konflikte të grupeve nacionale etj. Entuziazmi mbarësllav i gadishmërisë sllave dhe Ruse për të mbështetur sllavizmin u konfliktuan me pangjermanizmin Austro-Hungarez.

Në realitet, Austria nuk ishte më fuqi e madhe dhe Evropa dukej se po rrëshqiste tanimë drejt rrymave të reja dhe pas dëbimit nga Gjermania, Perandoria e re Austro-Hungareze nuk kishte ku të shtrihej tjetër, përveç Ballkanit. Dhe, me një politikë të tillë konflikti me Rusinë kjo situatë ishte e natyrshme.

Megjithëse, Gjermania nuk kishte interesa në Ballkan, gjithsesi ajo kishte një interes të madh në ruajtjen e pozitave të Perandorisë Austro-Hungareze.

Njëherazi, disfata që pësoi Franca nga Prusia në vitin 1871, i dha rastin Rusisë të hidhte poshtë nenet e Traktatit të Parisit të vitit 1856, që e ndalonte të armatosej në Detin e Zi etj. Rusia po dilte nga poshtërimi, që kishte pësuar në Luftën e Krimesë prej britanikëve, francezëve dhe osmanëve dhe, ideja e vjetër e pansllavizmit ishte pararojë e kësaj ringritjeje.

Thellësisht antiperëndimore, Rusia dilte në këtë mënyrë me

119 Glenny, *Histori e Ballkanit 1804-1999*, 256.

parrullën e mbrojtjes së popujve të krishterë ortodoksë. Një gjë e tillë nënkuptonte, sigurisht, çlirimin e popujve të Ballkanit nën udhëheqjen e Rosisë.

Ndërkohë Italia, pas bashkimit politik, filloi të aktivizohej në drejtim të gadishullit Ballkanik dhe të detit Egje. "Gjithsesi qëndrimi i vjetër disashekullor në marrëdhëniet e jashtme mbeti i njëjtë edhe në vitet që i paraprinë Luftërat Ballkanike (1912-1913) dhe Luftën e Parë Botërore (1914-1918)".¹²⁰ Siç vëren në analizën e tij studiuesi dhe autori i njohur A. Puto, "...në fillimin e shekullit XX ishte një situatë krejt tjetër nga ajo e shekullit para tij. Ai shkruan se: "Koncerti i të gjashtëve", edicioni i fundit i "Koncertit evropian", është një dështim i plotë. Ekuilibrat dhe harmonitë e vjetra nuk funksionojnë"¹²¹.

Zhvillimet, veçanërisht në rajonin e Ballkanit, sidomos në situatën e vështirë në të cilën gjendej Perandoria Osmane, nuk mund të administroheshin me metodat e vjetra. Autori e përmbyll argumentimin e tij duke cituar diplomatin e shquar amerikan H. Kissinger i cili, lidhur me këtë ka shkruar: "Një sistem ndërkombëtar që nuk konsiderohet i drejtë, herët a vonë vihet në rrezik. Ai sistem nuk konsiderohet "i drejtë", jo vetëm nga Fuqitë, por edhe "nga poshtë". Ka ardhur koha që ky sistem të bjerë"¹²².

Sidomos në rajonin e Ballkanit kjo lloj diplomacie i parapriu Luftës së Parë Botërore dhe, njëkohësisht, injorimit të respektimit të parimit të kombësisë. Pas thyerjes së Perandorisë Osmane nga Aleatët Ballkanikë, territoret që dikur kishin qenë pjesë e saj nuk u ndanë sipas ndarjes administrative që kishte bërë Porta e Lartë. Rregulli që mbizotëroi ishte ai i kënaqjes së fituesve dhe interesave të Fuqive të

120 Andreas Osiander, *Re-regarding Early Twentieth Century IR Theory: Idealism revisited*, (International Studies Quarterly, vëllimi 42, nr. 3, 1998), 409-432, cituar në Enver Hasani, *Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti i Jugosllavisë*, 65.

121 Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, (Tiranë: TOENA, 2009), 58.

122 Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, 58.

Mëdha, që qëndronin pas tyre.

Kjo do të bëhej shkak për destabilizim, urrejtje etnike, pretendime territoriale shpesh herë të argumentuara dhe nga pseudohistorianë dhe pseudoargumente historike, si dhe gjenocidi që do të vazhdonte për vite me radhë mes popujve ballkanas. "Këto aspekte dhe jo përbërja kombëtare e një territori të caktuar u konsideruan të favorshme për paqen dhe stabilitetin në Ballkan dhe më gjerë".¹²³ I njëjti parim do të ndiqej edhe pas shpërbërjes së Perandorisë Austro-Hungareze në vitin 1918, në të njëjtën mënyrë do të injorohej parimi i kombësisë në përcaktimin e kufijve!

123 Norman Dwight Harris, *The effect of the Balcan Wars on European Alleances and the future of the Otoman Empire*, (Proceedings of the American Political Science Association-Tenth Annual Meeting, 1913), 105-116; Arthur W. Spencer, *The Balcan Question-The Key to a Permanent Peace*, 569-570; Michel Roux, *Les Albanaïs en Yougoslavie. Minorite national, territoire et developpement*, 175-191. cituar në Enver Hasani, *Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti i Jugosllavisë*, 66.

Bibliografia

- Misha Glenny, "Histori e Ballkanit 1804-1999". Tiranë: TOENA, 2007.
- Hasani Enver, "Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti i Jugosllavisë". Prishtinë: Gjon Buzuku, 2010.
- M. Sükrü Hanioglu, 'A brief history of the Late Ottoman Empire'. New Jersey: Princeton University Press, 2008.
- Henry Kissinger, "Diplomacia", Tiranë: Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1999.
- Andreas Osiander, "Re-regarding Early Twentieth Century IR Theory: Idealism revisited". International Studies Quarterly, vëllimi 42, nr. 3, 1998.
- Arben Puto, "Shqipëria politike 1912-1939", Tiranë: TOENA, 2009.
- Norman Dwight Harris, "The effect of the Balcan Wars on European Alleances and the future of the Otoman Empire", Proceedings of the American Political Science Association-Tenth Annual Meeting, 1913.
- Arthur W. Spencer, "The Balcan Question-The Key to a Permanent Peace". Proceedings of the American Political Science Association-Tenth Annual Meeting, 1913.
- Michel Roux, "Les Albanais en Yougoslavie. Minorite national, territoire et developpement". Proceedings of the American Political Science Association-Tenth Annual Meeting, 1913.
- Clayer Nathalie, Një fillimet e nacionalizmit shqiptar. Tiranë: Përpyekja, 2009.
- CARDINI Franco, "Europa e Islam: Storia di un malintesa", Rome: Editori Laterza, 1999.
- Castellan George, Historia e Ballkanit, (Përkthim), Tiranë: ÇABEJ, 1991.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Wisdom University

Revista Shkencore Periodike Numer 4:

Tiranë, 12 maj 2017: proceedings / Wisdom
Universiteti "Wisdom". - Tiranë: Wisdom press, 2017
202 f. ; 23 x 16cm.

Bibliogr.

ISSN 2410-8472